

**KONFERENCA KOMBËTARE  
2005**

**“TË GJITHË SË BASHKU NË MBROJTJE  
TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”**

Organizuar nga  
**AVOKATI I POPULLIT**  
në bashkëpunim me  
**SAVE THE CHILDREN - SHQIPËRI**  
**UNICEF - SHQIPËRI**  
15 Dhjetor 2005

## PASQYRA E LENDES

1	Fjala e hapjes <b>Z. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit</b> .....	4
2	Fjala përshëndetëse Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë <b>Znj. Jozefina Topalli</b> .....	7
3	Fjala përshëndetëse e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta <b>Z. Koço Barka</b> .....	9
4	Fjala përshëndetëse e Zv.Ministrit të Arsimit dhe Shkencës <b>Z. Halit Shamata</b> .....	11
5	Fjala përshëndetëse e Përfaqësueses së UNICEF në Shqipëri <b>Zj. Carrie Auer</b> .....	13
6	Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Save the Children-Shqipëri <b>Z. Steve Ashby</b> .....	16
7	Fjala përshëndetëse e <b>Zj. Margarida Barroso</b> .....	19
8	“Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve” <b>Z. Riza Poda</b> , Komisioner i Zyrës së Avokatit të Popullit .....	20
9	“Politikat sociale për fëmijë, reformimi i shërbimeve të përkujdesit për fëmijë, tipologjia e re e shërbimeve” <b>Zj. Marjeta Zaçe</b> , Zëvendësministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta .....	24
10	“Mbrojtja e shëndetit dhe zhvillimi i fëmijëve, prioritet për shëndetësinë shqiptare” <b>Zj. Nedime Ceka</b> , Specialiste pranë Ministrisë së Shëndetësisë .....	35
11	“Arsim cilësor dhe masiv për të garantuar zhvillimin bashkëkohor të fëmijëve” <b>Zj. Pranvera Kamani</b> , Specialiste në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës .....	46
12	“Fëmijët në institucione” <b>Zj. Elda Kalaja</b> , Koordinatore Kombëtare e Aleancës për Fëmijë .....	51
13	“Ne do të mbrojmë të drejtat e fëmijëve, pavarësisht shtetësisë dhe vendit të origjinës” <b>Z. George Moschos</b> , Zv.Ombudsman i Greqisë .....	56
14	“Rrugë për të ngritur urat e bashkëpunimit” <b>Zj. Thëllëza Arifi</b> , Në emër të Ombudspersonit të Kosovës .....	58
15	“Kushtet për realizimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve” <b>Zj. Nevenka Krusharovska</b> , Zëvendëse e Avokatit të Popullit të Maqedonisë ....	59
16	“Shoqata në Mbështetje të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar” <b>Z. Jean-Luc Nicollier</b> , Drejtori i ASED me qendër në Gjenevë .....	63
17	“Administrimi i Drejtësisë për të Miturit” <b>Zj. Anola Shala</b> , Specialiste në Ministrinë e Drejtësisë .....	66

18	“Sistemi i Drejtësisë për të Mitur nën këndvështrimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit” <b>Prof. As. Dr. Vasilika Hysi</b> , Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit <b>Zj. Etilda Saliu</b> , Përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit .....	73
19	“Kriminaliteti nga dhe ndaj fëmijëve, dukuritë, tiparet e tij dhe mbrojtja e të drejtave të tyre nga Policia” <b>Z. Luan Mullaj</b> , Shef i Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtoria kundër Akteve Terroriste dhe Krimeve të hapura, Ministria e Brendshme .....	79
20	“Roli i pushtetit vendor në mbrojtje të të Drejtave të Fëmijëve” <b>Zj. Oltta Demi</b> , Specialiste pranë Bashkisë, Tiranë .....	89
21	“Fëmijët e trafikuar. Aspekti kombëtar dhe ndërkombëtar” <b>Zj. Lida Leskaj</b> , Koalicioni Shqiptar “Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve” .....	93
22	“Përqasja e legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit Evropian, në fushën e të drejtave të njeriut” <b>Z. Edvin Dule</b> , Specialist pranë Ministrisë së Integritimit Evropian .....	98
23	“Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje” <b>Zj. Etleva Sheshi</b> , Specialiste pranë Drejtorisë së Rinisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve .....	101
24	“Fëmijët e abuzuar” <b>Z. Altin Hazizaj</b> , përfaqësues i CRCA-Qendra Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve .....	104
25	“Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, - domosdoshmëri dhe standard për një shtet demokratik” <b>Zj. Holta Kotherja</b> , Klinika Ligjore për të Miturit .....	106
26	<b>Rekomandimet e Konferencës</b> .....	109

# FJALA E HAPJES SE AVOKATIT TE POPULLIT

## Z. Ermir DOBJANI

Avokat i Popullit

**E nderuara Znj.Kryetare e Kuvendit te Shqiperise  
Te nderuar zoterinj Ministra, deputete, anetare te Trupit  
Diplomatik, te ftuar nga Kosova, Maqedonia dhe Greqia.  
Te nderuar bashkeorganizatore, Zyra e UNICEF-it, Save the  
Children dhe pjesemarres ne kete konference.**

### **Zonja dhe Zoterinj,**

Perballe realitetit te gjendjes se shumices se femijeve ne bote, fjalia hyrese e "Deklarates se te drejtave te Femijes" shpallur nga Asambleja e Organizates se Kombeve te Bashkuara ne vitin 1959 *"Njerezimi duhet t'u jape femijeve ate ç'ka ai ka me te mire"*, vleresohet si e pa realizuar. Po ashtu edhe parimi i Konventes se OKB-se "Mbi te drejtat e Femijeve" se eshte Interesi me i larte i femijes ai qe duhet patur parasysh mbi te gjitha. Neni 54 i Kushtetutes sone garanton te drejten e femijeve te kene nje mbrojtje te vecante nga shteti. Si rrjedhoje te gjitha institucionet publike, te mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoritetet administrative ne vendimet e tyre duhet te kene parasysh gjithmone si interesin me te larte ate te femijes.

Shqiperia e ka ratifikuar Konventen e OKB-se me 28 Shkurt te vitit 1992. Qe atehere shume sfida kane rezultuar per Parlamentin, Qeverine, Institucionet e tjera shqiptare dhe shoqerine civile sepse femijet kane nevoja te posaçme dhe si rrjedhoje si individe ata kane statusin e tyre. Ata nuk jane produkt i shtetit apo per gjithçka nuk jane vetem ne posedim te prinderve te tyre. Per kete arsye, ne e kemi per detyre qe t'i njohim kerkesat dhe te drejtat e tyre, si te drejta te individeve te veçante. Femijet e fillojne jeten ne varesi dhe shkojne drejt pavaresise me ndihmen e te rriturve. Pikerisht kjo lloj varesie i ben ata me te ndjeshem, me te ndikuar se te rriturit nga kushtet ne te cilat jetojne, sidomos kur ne vend qe t'u ofrohet kujdes, ushqim i mjaftueshem, edukim dhe perkedheli, u ofrohet varferi, ndotje ambjenti, pune e detyruar apo çdo lloj tjetër privacioni. Femijet i ndjejne me shume, si per mire, ashtu dhe per keq, pasojat e veprimeve ose mosveprimeve te qeverisjes. Pothuajse çdo ligj apo çdo vendim i qeverise, ne cdo fushe, ndikon tek femijet ne menyre direkte apo indirekte. Me siguri mund te themi se gjendja e femijeve, e edukimit dhe shendetit te tyre eshte nje barometer mates i sakte i ndryshimeve social ekonomike ne çdo shtet.

### **Te nderuar zonja dhe zoterinj,**

Ndryshimet e ndodhura ne vendin tone ne vitet e tranzicionit, kane rritur ne menyre te dukshme rreziket me te cilat ballafaqohen femijet dhe familjet e tyre. Nen ndikimin e dukurive sociale te tilla si emigracioni, urbanizimi i pakontrolluar, varferia dhe papunesia, dezintegrimi i familjes dhe divorcet, etj, konstatohet tendenca e rritjes se numrit te shkeljeve te te drejtave te femijeve. Keqtrajtimi i femijeve eshte sot nje nder problemet me te mprehta me te cilat

ballafaqohet shoqeria shqiptare. Gjithnje e me teper po behet i pranishem realiteti i hidhur i keqtrajtimit te femijeve ne forma te ndryshme brenda dhe jashte familjes, duke filluar nga rrahjet deri tek vrasjet apo vetvrasjet.

Eshte e pranishme nje forme e ashper diskriminimi per shkak te prinderve, vrasjet per shkak te gjakmarrjes dhe hakmarrjes, te cilat sjellin si pasoje, perveç te tjerash ngujimin e shume femijeve ne “burgun shtepiak” dhe braktisjen e shkolles. Gjendja siç dihet paraqitet e veshtire ne rrethet e veriut te vendit. S’ka rendesi ne se numri i tyre ulet apo rritet, sipas interesit te OJQ-ve qe i numerojne. E rendesishme eshte se shteti shqiptar, te gjithë ne, nuk nderohemi dhe nuk duhet te na zere gjumi derisa edhe nje femije i vetem do te vazhdoje te mos shkoje ne shkolle per shkak te ngujimit. Ne kemi bere mire qe kemi ngritur zerin per zbardhjen e fatit te rreth 500 femijeve qe jane “zhdukur” nga Qendra Agia Varvara e Athines; qe çdo dite e me teper po forcojme kufirin per te luftuar dhe parandaluar çdo trafik ne pergjithesi dhe trafikun e femijeve ne veçanti. Por te gjithë ne duhet te shohim “brenda kufirit”, tek Ura e Lanes apo para vete hotelit ku po bejme konferencen, ku femijet lypin, lajne xhamat e makinave apo detyrohen nga trafikante apo tutore, qe mund te jene edhe familjare te tyre, qe te shtrihen per te lypur ne trotualet me uje apo te dalin lakuriq. Avokati i Popullit, policia, organizatat jo qeveritare, nuk duhet te hezitojne te veprojne, t’i mbledhin, t’i evidentojne, t’i hiqet e drejta prinderore cilitdo qe e keqperdoron dhe, femije te tille te sistemohen ne shtepi kujdesi apo ne jetimore. Nuk mund te leme pa permendur ketu rastet, kur teksa femija pret te takohet me njerin nga prinderit e divorcuar, vihet perballe nje ekzekutimi te detyrueshem, ku pozitat e policit dhe te permbaruesit nuk dallohen. Reforma e Drejtesise per te miturit ne Shqiperi qe ka filluar Ministria e Drejtesise ne bashkepunim me Komisionin Europian, Unicefin dhe Siden eshte nje projekt qe pritet te jape mjaft efekte pozitive. Nese shpejt do arrihet te ndertohet nje burg i posaçem dhe qender e veçante riedukimi per te miturit qe kryejne vepra penale, them se kjo Reforme eshte e plote.

I bejme thirrje gjithë Mediave, te cilat kane nje merite te madhe per thellimin e nivelit te demokracise ne Shqiperi, qe ta shohin me sy kritik pasqyrimin e femijeve ne “kroniken e zeze”. Nje femije psikologjikisht i dobet mund te shkaktoje vetvrasje “edhe per t’u bere i njohur”, ashtu si viktimat femije te pasqyruara me mjaft publicitet ne Mediat tona. Ne inspektimin qe bera para nje jave, ne oret e vona te nates, ne dy qendrat e fshatit SOS ku jane sistemuar adoleshente dhe te rinj deri 18 vjeç, ata m’u ankuan pse Media para dy javesh kishte pasqyruar identitetet e tyre per ngjarje te ndodhura nje vit me pare, gje qe kishte demtuar imazhin dhe marredheniet e tyre me shoket dhe shoqet e shkolles.

Te ndjeshem nga kjo situatë ne mbrojtje te drejtave te femijeve, Institucioni i Avokatit te Popullit, se pari, falenderon Parlamentin per ndryshimin e Ligjit nr.8454 date 04.02.1999 “Per Avokatin e Popullit” ne drejtim te inisiatives per hetimin e çeshtjeve qe kane te bejne me femijet, apo te dhenies te se drejtes se inspektimit ne çdo kohe per te verifikuar respektimin e te drejtave te femijeve ne çdo shtepi femije apo ne çdo institucion tjetër ku ekziston mundësia e shkeljes se te drejtave te tyre. Ne te njejten kohe prane zyres sone funksionon Nenseksioni per te drejtat e femijeve, krijimi i te cilit eshte ediventuar si fakt mjaft i rendesishem, pas raportimit te pare te shtetit shqiptar lidhur me zbatimin e Konventes se OKB-se “Per te drejtat e femijes”. Ne

falenderojme Agjensine Norvegjeze per Zhvillim (SIDA), si dhe Save the Children per projektin 3-vjeçar, ne perfundim te te cilit do te krijohet infrastruktura e nevojshme ligjore e materiale si dhe burimet njerezore, per te konkluduar nga Parlamenti ne se do te krijohet nje Ombudsman i veçante per femijet apo do te vazhdoje puna per mbrojtjen e femijeve brenda Institucionit te Avokatit te Popullit.

### **Te nderuar pjesemarrës,**

Synimi i kesaj konference nuk eshte thjesht pasqyrimi i arritjeve te organeve shtetore apo arritjeve te OJF-ve ne realizimin e synimit final te mbrojtjes se te drejtave te femijeve. Si drejtues i nje institucioni ne fokusin e veprimtarise te te cilit eshte mbrojtja e te drejtave te njeriut, deklaroj bindjen se te drejtat e femijeve duhet te qendrojne mbi interesat partiake dhe politikat e dites. Prandaj mendojme se Strategjia kombetare per te drejtat e femijeve, miratuar nga Qeveria Nano ne maj 2005 mund te ndryshohet apo te pasurohet, por ajo duhet te implementohet nga Qeveria Demokrate dhe te perfshihet ne perparesite e saj. Politika me e mire per femijet eshte mospolitizimi i tyre. Prandaj sipas Rekomandimit tone ne ndryshimet e pritshme te Kodit Zgjedhor duhet te sanksionohet ndalimi i pjesemarrjes dhe aktivizimit te femijeve ne fushatat zgjedhore. Mosdiskriminimi, interesi me i larte i femijes, e drejta per mbijetese dhe zhvillim, pjesemarrja e femijeve ne vendimet per jeten e tyre, duhet te jene guida udherrefyese ne veprimtarine e gjithsecilit prej nesh.

Disa nga drejtimet konkrete ku konferenca do te perqendrohet jane: politikat qeveritare ne drejtim te mbrojtjes se te drejtave te femijeve, problemet e punes se ndaluar te femijeve, e trafikimit te femijeve, te arsimit fillor te detyrueshem, etj; roli i OJF-ve per mbrojtjen e te drejtave te femijeve si dhe pervoja e Ombudmaneve te tjere ne mbrojtje te te drejtave te femijeve.

Per keto tema do te flitet ne tre sesionet nga perfaqesuesit e te gjithë partnereve te pranishem. Ju falenderoj per kontributet qe ju do te jepni ne kete Konferenca dhe shpreh besimin se do te vazhdojme te punojme bashke per realizimin e rekomandimeve dhe perfundimeve qe do te dalin nga Konferenca.

Se fundmi, me lejoni te shpreh vendosmerine e Institucionit te Avokatit te Popullit ne mbrojtje te te drejtave te femijeve. Te gjithë ne kemi se çfare te reflektojme dhe te bashkepunojme per ndryshime cilesore ne drejtim te mbrojtjes se te drejtave te femijeve.

Faleminderit dhe suksese te perbashketa!

# **FJALA PERSHENDETESE E KRYETARES SE KUVENDIT TE SHQIPERISE**

## **Zj. Jozefina TOPALLI**

Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Te nderuar pjesemarrës të kësaj Konference,

Kam kenaqesine që marr pjesë dhe nderin e veçantë të pershendes në emer të Kuvendit të Shqipërisë punimet e kësaj Konference Kombëtare me një problematike tepër të rëndësishme. Se pari dua të falenderoj organizatorët e saj, Avokatin e Popullit, UNICEF dhe Save the Children.

Institucioni i Avokatit të Popullit po hedh hapa të sigurtë në misionin e tij që të rëndësishëm duke nxitur kështu procesin e mirëqeverisjes dhe garantuesit të të drejtave të të gjitha shtresave të popullsisë, ku një vend të rëndësishëm zënë edhe fëmijet. Ngritja dhe konsolidimi i këtij Institucioni mund të konsiderohen si nder arritjet më të spikatura në konsolidimin e demokracisë së re shqiptare, në forcimin e shtetit të së drejtës.

Qëllimi i kësaj Konference përben njëkohësisht dhe një nga objektivat e shpalosura nga Qeveria e re Demokratike.

Bej thirrje nga kjo Konference, që askush në çfarëdo pozicioni qoftë, nuk duhet të lejojë dhunimin a shkeljen e të drejtave të fëmijëve, apo të pengojë me veprimet apo mosveprimet e tij apo të institucionit që përfaqëson dhe të bëjë që të drejtat e ligjshme të fëmijëve të mbeten vetëm iluzione.

Vlerësoj faktin se legjislacioni shqiptar në këto fushe ka pësuar zhvillime e përmirësime të vazhdueshme, në përputhje me standartet ndërkombëtare, por gjithsesi në punën për fëmijet mbetet shumë për tu bërë.

Nisur nga pozitën jo vetëm të një politikaneje, por mbi të gjitha të një prindi, them me bindje të plotë që të gjithë duhet të kemi ndjeshmerinë dhe kujdesin e duhur në mënyrë që për të siguruar një të ardhme të sigurt për vendin, se pari duhet të mirëkujdesemi për shtresën e fëmijëve.

Nuk mund të le pa përmendur që të gjithëve na ka ndodhur të shohim fëmijë që kërkojnë lëmoshë në rrugë, të tjerë që kanë braktisur shkollat nga frika e gjakmarrjes, fëmijë mbi të cilët abuzohet duke i trafikuar, e kështu me rrugë. Mbrojtja e posaçme me ligj e fëmijëve, sanksionohet qartë dhe kuptueshëm në shumë akte ligjore kombëtare e ndërkombëtare. Konventa e OKB mbi të drejtat e fëmijëve, përben një instrument unik që përmbledh së bashku të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale e kulturore, duke u nisur nga realiteti unitar i të drejtave njerezore dhe duke urdheruar një pamje unike të mbrojtjes së këtyre të drejtave. Por jo gjithmone reagohet në mënyrën e duhur për garantimin e këtyre të drejtave.

E gjithë administrata duhet të specializohet me synimin e garantimit, në shërbimet të veta, të interesit më të lartë të fëmijëve. Dhe këtu një kontribut të veçantë ze përdyshim dhe puna e Avokatit të Popullit, i cili e ka vlerësuar punën për të drejtat e fëmijëve, duke krijuar një Nenseksionin të posaçëm për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Në themel të politikave të mbrojtjes sociale të vendit duhet të vihen fëmijet, të cilët për shkak të veçorive të moshës, mungesës së pjekurisë fizike dhe

intelektuale, kane nevojen e nje mbrojtjeje dhe vemendjeje te veçante, nga familja dhe institucionet shteterore. Dhe kujdes i veçante i takon sidomos femijeve me aftesi te kufizuara duke i krijuar ndihme dhe lehtesira per shkollim e edukim, moslejimi te shfrytezimit te punes se femijeve te mitur. Shkolla perben faktorin me te rendesishem qe percakton cilesine intelektuale te nje vendi, eshte garanci e se ardhmes.

Ata duhen mbrojtur jo vetem nga neglizhenca apo abuzimi, por edhe nga pergjegjesite qe kalojne tej aftesive te tyre.

Mbrojtja e te drejtave te femijeve duhet te perbeje nje prioritet per te gjitha forcat politike.

Ata jane qytetaret e ardhshem dhe le t'i edukojme ata te jene sa me te denje per Shqiperine. Nuk duhet te harrojme qe investimi i shoqerise per ta, eshte investim per te ardhmen e vendit. Ndaj cilesia dhe sasia e te ardhurave publike qe shkojne ne favor te shkollimit, kontrolli ne menyre te vazhdueshme i shendetit fizik e mendor te femijeve, sigurimi i hapësirave publike te nevojshme per argetimin e femijeve, bashkerendimi i punes shkolle-familje, mbrojtja e femijeve nga dhuna fizike e psikologjike e te rriturve, jane disa nga shembujt ku mund te drejtohet veprimi politik ne favor te femijeve. Femijet duhet te perbejne vizionin e se ardhmes sone.

Ne kete kontekst shpreh bindjen per rolin e rendesishem te deputeteve dhe te Kuvendit te Shqiperise ne mbeshtetje te çdo nisme per permiresimin e legjislacionit qe ka lidhje me femijet, te drejtat e interesat e tyre.

Duke ju uruar suksese ne punimet e konferences dhe duke pershendetur organizatoret per nismen e ndermarre, si dhe gjithe pjesemarresit per kontributin e tyre ne kete aktivitet teper te rendesishem, njekohesisht perfitoj t'ju falenderoj per vemendjen.



# **FJALA PERSHENDETSE E MINISTRIT TE PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA**

## **Koço BARKA. DOC**

Minister i Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta

E nderuar Kryetare e Kuvendit te Shqiperise,  
znj. Jozefina Topalli

I nderuar Avokati i Popullit, Z. Dobjani

Te nderuar pjesemarres,

Te nderuar organizatore,

Me lejoni te shpreh vleresimin e qeverise dhe timin persnal per kete Konferencë qe organizon Avokati i Popullit per femijet, si nje nder problemet me madhore dhe me delikate te shoqerise shqiptare, per te sotmen dhe te ardhmen e vendit.

Do te deshiroja shume ta vazhdoja kete pershendetje me fjalet qe tradicionalisht jane thene, thuhen e do te vazhdojne te thuhen ne raste te tilla. Por nje ngjarje e rende e diteve te fundit, ashtu si te te gjithë ju, ka lene gjurme dhe pershtypje te thella edhe ne vetedijen time qytetare, njerezore dhe politike. Nje ngjarje qe te gjithë e keni degjuar: para pak ditesh shtypi raportoi se nje adoleshent ekzekutoi ne menyre mizore dhe gjakftohte nje te afermin e vet, me qellim vjedhjeje. Kjo ngjarje me beri qe ta ndryshoj teresisht linjen e kesaj pershendetjeje dhe ta nis ate me pohimin e pyetjen tronditese: Cfare po ndodh ne shoqerine shqiptare? Cfare e motivon brezin e ri dhe e nxit ate drejt nje jete te ashper e nje sjelljeje te inkriminuar? Cfare e transformon doren e njome te adoleshentit shqiptar ne dore vrastare?

Nuk mund te flasim per mbrojtjen e femijeve, pa i dhene nje pergjigje te drejtperdrejte dhe pa ekuivoke ketyre pyetjeve. Tema e mbrojtjes se femijeve eshte nje teme mjaft e rrahur ne shoqerine e sotme shqiptare, ne debatet publike e politike, ne shtyp dhe mass-media, ne komunitet dhe mjediset e shoqerise civile. Natyrisht, asnje prej jush nuk ka ardhur ne kete salle per te degjuar retoriken time ministrore se ne programin e Qeverise, mirerritja e femijeve, ulja e mortalitetit infantil, shkollimi, ofrimi i sherbimeve shendetesore dhe sociale, dhe kujdesi i gjithanshem per mbrojtjen e tyre nga trafikimi, punesimi, droga etj. jane percaktuar si prioritete te punes se saj. Kete ju e dini. Por une jam i bindur se ne te gjithë kerkojme me realizem e pergjegjesi politike, qytetare dhe kombetare pergjigjen e pyetjes: Si do ta shpetojme brezin e ri nga futja ne rrugen e inkriminimit?

Ne shoqerine moderne flitet per dy rruge te socializmit te brezit te ri: socializimi konsumistik dhe socializimi prodhues. Socializimi konsumistik, sic kane vene ne dukje ekspertet dhe studjuesit, presupozon rritjen dhe edukimin e brezit te ri nepermjet perdorimit te te mirave materiale e shpirtore qe ka krijuar per ta shoqeria. Ne kete menyre brezi i ri eshte, pra, nje konsumator i vlerave dhe produkteve te krijuar nga brezat paraardhes ose i atyre qe krijohen rishtaz nga shoqeria. Ky eshte nje proces pasiv dhe brezi i ri e pranon ate si rrugen me te pelqyeshme dhe me te shpejte te socializimit.

Ky proces ndodh ne nje kohe qe, sic konstatojne studjuesit, ne shoqerine bashkekohore po zgjatet periudha e adoleshences. Kjo zgjatje ndodh jo vetem ne kuptimin social, por edhe ne kuptimin fizik. Kufijte e adoleshences po shtyhen pertej kufijve tradicionale te pranuar nga shkenca e biologjise, sociologjise dhe psikologjise. Kjo ndodh paralelisht me zgjatjen e periudhes se shkollimit dhe vonesen e hyrjes ne jete per shkak te krijimit dhe shtimit te kushteve e rrethanave jetesore qe e mundesojne kete. Por shikoni: Sa me shume qe shoqeria rrit kujdesin dhe permireson kushtet e jeteses, edukimit dhe socializimit te brezit te ri, aq me delikat dhe aq me i prirur behet ky brez drejt devijimit nga pergjegjesite individuale, familjare dhe shoqerore.

Ndersa socializimi prodhues presupozon procesin e rritjes dhe edukimit te brezit te ri nepermjet pjesemarrjes se drejtperdrejt ne jeten ekonomike, veprimtarine prodhuese dhe krijimin e produkteve dhe sherbimeve. Une mendoj se brezi i ri ne Shqiperi, per arsye edhe te rrethanave ekonomike e shoqerore qe po perjeton vendi gjate dekadave te fundit, po i nenshtrohet, per fat te keq, me shume ketij lloji te socializimit. Ne e kemi te qarte se nje pjese e konsiderueshme e femijeve punojne me ose pa deshiren e tyre. Familjet i perfshijne ata ne procesin e prodhimit e te sherbimeve per shkak te nevojës ekonomike, por ne mjaft raste edhe jo per kete shkak. Punedhenesit e pranojne sherbimin dhe vlerat e krijuara nga femijet, shpesh te punesuar ne forma e menyra informale e ilegale, pa e vrare mendjen se cfare i ofrojne shoqerise me biznesin dhe fitimet e tyre, te ngritura mbi gjakun, djersen dhe mundimet e te miturve.

Por kam pertshtypjen se socializimi i femijeve ne shoqerine shqiptare, jo vetem qe devijon nga tendenca bashkekohore e socializimit konsumistik drejt atij prodhues, por po shenon edhe nje tipar origjinal: prirjen drejt socializimit devijant dhe te inkriminuar. Femijet rrethohen nga nje ambient i ashper dhe vulgar, nga nje shoqeri ku vlerat dhe antivlerat veshtire te dallohen nga njera-tjetra; ata jetojne ne nje familje ku konsensusi, mirekuptimi dhe solidariteti po kercenohen nga kriza e marredhenieve, identitetit dhe dhuna shpirtore ose fizike; femijet behen target i nje informacioni, opinioni dhe materie mediatike, te cilat shpesh i terheqin ne boten e horrorit e te kimit.

Ne jemi te vetedijshem per keto dukuri, per keto realitete, por pak kemi bere e po bejme per parandalimin e tyre. Ndaj befasohemi e tronditemi kur degjojme per ngjarje te dhunshme, me protagoniste femijet e adoleshentet, delinkuenca dhe dhuna e te cileve ndodh qe drejtiohet kunder vete rrethit familjear e shoqeror.

Ndoshta isha pak i ashper ne keto arsyetime dhe ndoshta shkova pertej caqeve me te cilat jemi mesuar ne nje diskutim publik. Por le te jene keto meditime personale nje ftese per diskutim per te gjithë ne. Le te ndalemi e te reflektojme me realizem mbi keto dukuri, me mire sesa te flasim ne menyre rutinore e me fjale te zgjedhura standarte mbi strategjite, dokumentat dhe programet qe kemi miratuar. Ato kane vleren e tyre, por nuk jane gjithshka.

Ju faleminderit!

# **FJALA PERSHENDETESE E ZV. MINISTRIT TE ARSIMIT DHE SHKENCES**

## **Z. Halit SHAMATA**

Zevendes Minister i Arsimit dhe Shkences

I nderuar Z. Dobjani,  
Te nderuar pjesemarrres,

Organizmi i Konferences Kombetare “Te gjithë se bashku ne mbrojtje te te drejtave te femijeve”, me nje pjesemarrje shume te gjere te te gjithë aktoreve pergjegjes te institucioneve shteterore dhe te shoqerise civile, me mbeshtetjen e UNICEF-it dhe Save the Children, (mbeshtetje kjo qe na ka shoqeruar ne shume projekte te zhvilluara ne mbrojtje te femijeve), eshte nje rast shume i mire per te analizuar dhe evidentuar arritjet dhe problemet qe kane instuticionet dhe shoqeria shqiptare ne promovimin dhe mbrojtjen e te drejtave te femijeve, pas 13 vjetesh te nenshkrimmit te Konventes se Mbrojtjes se te Drejtave te femijeve.

Padyshim ne keto 13 vjete jane hedhur hapa konkrete ne institucionalizimin e mbrojtjes se te drejtave te femijeve. Por a eshte bere ajo qe ne te gjithë desherojme? Ndoshta kjo eshte pyetja qe gjithkush i bene vetes dhe institucionit qe perfaqeson. Koha nuk pret dhe, per femijet, eshte gjithmone vone. Me te drejte shumkush thote femijet jane e ardhmja dhe e ardhmja eshte borxhi qe ne u kemi femijeve tane. Por, para se te jene e ardhmja, ata jane e sotmja dhe, per te sotmen e tyre, te gjithë ne jemi pergjegjes.

Shnderrimet e 15 viteve te fundit e kane vene shkollen dhe gjithë sistemin arsimor perpara sfidave te vazhdueshme. Cili duhet te jete qytetari i ri qe do te perballoje me sukses sfidat e ndryshimit demokratik te shoqerise? Çfare njohuri, vlera dhe moral te qendryeshem duhet te ofroje shkolla? Ne pergjigje te ketyre problemeve ka rrjedhur ecuria e transformimeve dhe zhvillimeve te sistemit tone arsimor dhe te kurrikules mesimore ku, padyshim, edukimit qytetar i nxenesit ne respektimin dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe te femijeve vleresohet si shume i rendesishem.

Gjithashtu keto shnderrime reflektohen ne strategjine afatgjate te MASH, ku mbeshtetet zhvillimi i ardhshem i arsimit shqiptar si dhe ne pjesen e arsimit te “Strategjise Kombetare per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve” per vitet 2005 - 2010. Keto perpjekje reflektohen ne ndryshimet kurrikulare te sistemit te arsimit parauniversitar, ne veprimtari dhe projekte te shumta rajonale dhe kombetare te zhvilluara ne shkolle per mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

Duke theksuar rendesine e edukimit qytetar demokratik, ne politiken e saj, MASH ka vene theksin ne “Edukimin per mbrojtjen e te drejtave te njeriut si element i rendesishem i edukimit qytetar dhe si faktor per rritjen e pergjegjesise sociale dhe zhvillimin e paqes. Po ne kuadrin e edukimit dhe zhvillimit te qytetarise demokratike ne shkolle, MASH vlereson edukimin me te drejtat e njeriut ne planin e nje kurrikule dhe praktike te re te funksionimit te shkolles qe do te promovojë dhe do te edukoje tek çdo femije:

- \* vlera te qendrueshme;
- \* besimin ne vete dhe pergjegjesine per ate qe ndodh ne Shkolle dhe jashte saj;
- \* te qenit i dobishem ne jeten e shkolles, komunitetit , vendit dhe me gjere;
- \* aftesine e te menduarit kritik, me frymen e debatit konsatrktiv, tolerances dhe pranimi te te menduarit ndryshe.

Ne kemi besim qe ne kete rruge shkolla do te kryeje misionin e saj sot, per t'iu pershtatur nje shoqerie ne ndryshim.

Duke vleresuar kontributin e gjitheseccilit ne kete dite, i uroj Konferences pune te mbare.

## FJALA PERSHENDETESE E PERFAQESUESES SE UNICEF NE SHQIPERI

**Zj. Carrie AUER**

Unicef - Shqiperi

Miremengjes, Z. Dobjani, Zj. Topalli, Ministri Barka, Ministri Olldashi, Ministri Bumçi, te nderuar te Ftuar, Zonja dhe Zoterinj, eshte nje kenaqesi qe jam sot ketu per te marre pjese ne Konferencen Kombetare te Institucionit te Avokatit te Popullit. Jam e gezuar qe tema e ketij viti fokusohet mbi te drejtat e femijeve.

Konventa mbi te Drejtat e Femijes u miratua nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve te Bashkuara me 1989, duke simbolizuar keshtu vendosmerine mbareboterore per te punuar ne te mire te femijeve. Ne realitet sot kjo Konvente eshte ratifikuar nga 191 shtete nga e gjithe bota, perfshire dhe Shqiperine. Konventa Mbi te Drejtat e Femijes eshte konventa me e ratifikuar ne te gjithe boten e cila perben piken me te gjere te references ligjore dhe politike, te ceshtjes te te drejtave te femijes per te gjitha vendet e botes.me gjeresisht

Nje nga **most striking features** te Konventes eshte perceprimi demokratik i femijes, sipas te cilit vizioni i femijes eshte nje objekt kujdesi dhe mbrojtjeje-siç pervijohet ne Shtetin e Mireqenies Sociale-duke perfshire ne brendesi dhe nje dimension te ri e dinamik - **Femija si nje qytetar dhe subjekt te drejtash.**

Komiteti i te Drejtave te Femijes qe eshte nje organizem i krijuar ne baze te vete Konventes per te monitoruar progresin nepermjet implementimit te Konventes mbi te Drejtat e Femijeve ka inkurajuar vazhdimisht Shtetet qe te respektojne Parimet e Pergjithshme Baze te Konventes dukepercaktuar masa per zbatimin e saj. Kater parimet baze jane:

1. Mosdiskriminimi (Neni 2)
2. Interesi me i larte i femijes (Neni 3)
3. E drejta e Jetes, Mbijeteses dhe Zhvillimit (Neni 6)
4. E drejta e Pjesemarrjes (Neni 12)

Shtetet ne procesin e implementimit te Konventes, kane nxejrrre ne pah jo vetem nevojën per ligje dhe politika te reja, por kane nevojë dhe per mekanizma, struktura dhe veprimtari per te promovuar **nje prioritet te ri per femijet.**

Ekzistojne dhe dy kerkesa kyçe mjaft te rendesishme per implementimin e Konventes mbi te Drejtat e Femijes. E para eshte ngritja e nje mekanizmi per koordinimin e politikave per femijet brenda shtetit. Keshtu nje mekanizem koordinues - **Njesia e te Drejtave te Femijeve** ne Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta ne Shqiperi, duhet te kete perberje nga ente te ndryshme kompetente ne nivel shteteror. Ky mekanizem koordinues ne kete menyre siguron nje **approach** multidisiplinore dhe globale per implementimin e Konventes dhe promovimin e **the interaction complementarities** e veprimtarive te zhvilluara. Sidoqofte, lehteson **the gathering** e informacioneve perkatese, mundeson nje vleresim sistematik

dhe te kujdeshem te realitetit dhe **paves** rrugen per perpunimin e strategjive te reja.

Kerkesa e dyte eshte nevoja e nje procesi vleresimi te vazhdueshem dhe real per implementimin e Konventes mbi te Drejtat e Femijes. Sidoqofte, rekomandohet ngritja e institucioneve te pavarura kombetare me mandatin e monitoruesit te zbatimit te Konventes, siç mund te jete nje **ombudsman apo komisioner per femijet**. Nje numer ne rritje i Shteteve te Evropes po tregojne vullnetin e tyre per zbatimin e te drejtave te femijeve duke krijuar institucione te pavarura per te drejtat e femijeve.

Raporti i pare i Shqiperise ne Komitetin e te Drejtave te Femijeve u shqyrtua ne Janar te ketij viti. Komiteti mirepriti krijimin e nenseksionit mbi te Drejtat e Femijeve tek Institucioni i Avokatit te Popullit, dhe verejti qe ka plane per zgjerimin e funksioneve te tij. Komiteti rekomandoi qe nenseksioni duhet jete sa me veprues sa me shpejt te jete e mundur. Ne **commend** Qeverine Shqiptare qe te ndermarre veprime mbi rekomandimet qe i sherbejne aftesive te Zyres se Avokatit te Popullit per te monitoruar, promovuar dhe mbrojtur te drejtat e femijeve.

### **Por perse vihet theksi ne te drejtat e femijeve?**

Le te mos harrojme qe te drejtat e njeriut fillojne me te drejtat e femijeve. Nje shoqeri qe respekton te drejtat njerezore te femijeve, brenda nje gjenerate e me tej, mund te behet nje shoqeri qe respekton te drejtat e njeriut. Fatkeqesisht femijet nuk jane vetem vulnerable, por dhe mjaft te padukshem ne mjaft shoqeri; ata nuk votojne, ata nuk kane ze, ata nuk kane shume menyra per t'i kerkuar te drejtat e tyre.

Femijeve u nevojitet nje force qe te shumfishoje zerat, ne menyre qe kerkesat dhe interesat e tyre te paraqiten ne menyre efektive tek qeveria dhe shoqeria si nje e tere. Kjo nen frymen e Nenit 12 te Konventes mbi te Drejtat e Femijeve-mbi te drejten e pjesemarrjes.

Per shtetet ku ekziston nje kulture per zhvillimin e te drejtave te njeriut ne pergjithesi, zhvillimi i institucioneve kombetare e te pavarura te te drejtave te njeriut, siç eshte Avokati i Popullit qe fokusohet mbi te drejtat e femijeve, mund te jete nje hap themelor ne kete drejtim. Dhe ne rrugen per zbatimin e plote te Konventes, ai mund te luaje nje rol strategjik per:

- \* Promovimin e nje prioriteti sa me te larte dhe nje vizioni mbi problemet e femijeve.
- \* Permiresimi i qendrimeve publike lidhur me femijet.
- \* Ndikimi ne ligje, politika dhe praktika duke ju drejtuar me propozime te tjera per ndryshime Qeverise.
- \* Promovim i koordinimit te mekanizmave qeveritare per femijet ne te gjitha nivelet.
- \* Nxitje e perdorimit efektiv te burimeve per femijet.
- \* Nxitje e inkurajim i te drejtes se shprehjes se opinioneve te femijeve dhe inkurajim i qeverive dhe te publikut qe t'i kushtoje atyre vemendjen e duhur.
- \* Rishikim i pjesemarrjes se femijeve, dhe mbi efektivitetin e sistemit te advokacise dhe sistemit te ankesave, duke perfshire institucionet, shkollat, gjykatat.
- \* Pergjigje per problemet individuale dhe ankesat e femijeve, dhe kur eshte nevoja, te inicioje apo te mbeshtese me ndihme ligjore femijet.

UNICEF ne rajon po i mbeshtet keto institucione te pavarura, ne menyre qe te behen "garantuese" te zbatimit te Konventes se te Drejtave te Femijes dhe te veproje per te promovuar te drejtat e Femijeve tek qeveria dhe shoqeria civile, duke ndikuar ne politikat, duke krijuar forume ku te degjohet zeri i femijeve, duke ripare aksesin e femijeve ne sistemin e ankimit dhe per t'ju pergjigjur ankesave individuale.

Ne te gjitha besojme qe mireqenia e te gjitha shoqerive mund te sigurohet me veprime politike per t'i dhene prioritet te drejtave te femijeve me perpjekje te vazhdueshme nga te gjitha shtetet dhe organizmat, nepermjet bashkepunimit kombetar e nderkombetar.

Zonja e Zoterinj, femijet nuk mund te presin!

Faleminderit!

## **FJALA PERSHENDETESE E DREJTORIT TE SAVE THE CHILDREN NE SHQIPERI**

### **Z. Steve ASHBY**

Save the Children - Shqiperi

Ne nivel te gjere, instucionet qeveritare dhe Ministrite, po bejne progres ne politikat e sektoreve te vecante dhe ne programet, si dhe ne strukturat qe kane lidhje me monitorimin e te drejtave te femijeve. Per t'u theksuar eshte ketu puna e Zyres se Avokatit te Popullit si dhe e Grupit Nderministerial oer te Drejtat e Femijeve.

Strategjia Kombetare per Femijet qe u hartua nga Komiteti per Mundesite e Barabarta u zbatua per t'ju pergjigjur ceshtjeve si miratimi i Kodit te Familjes; pergatitja e projektligjit Mbi Statusin e Nepunesit Civil dhe amendimet e Kodit te Procedures Penale.

Sidoqofte, legjislacioni ekzistues ne Shqiperi ka nevojte per nje pasqyrim me te mire te Konventes Mbi te Drejtat e Femijeve dhe ne mjaft raste "*child blind*". Kjo krijon mjaft situata ku dhunimet e te drejtave nuk ndeshkohen.

Kjo nenvizon nevojten immediate per mekanizma te nje monitorimi te gjithanshem te te drejtave te femijeve dhe te nderhyrjes sa me efektive ne te tilla raste. Nenseksioni i te Drejtave te Femijeve brenda Zyres se Avokatit te Popullit dhe Komiteti Nderministerial mbi te Drejtat e Femijeve mund te quhen si partnere strategjike kyce ne referimin e mjaft rasteve te abuzimit te te drejtave te femijeve.

Zyra e Avokatit te Popullit ka krijuar nje reputacion te mire ndershmerie, paanshmerie politike dhe mbrojtjeje kurajoze per problemet te ngritura nga qytetaret. Ankesat e shqyrtuara nga Zyra e Avokatit te Popullit perfshijne mjaft ceshtje sensitive politike.

Projekti i ri organizativ i bashkepunimit ndermjet Save the Children dhe Zyres se Avokatit te Popullit i mbeshtetur nga SIDA tashme ka filluar.

Veprimtarite per zbatimin e ketij projekti do te pershijne nje kombinim te zhvillimit te burimeve njerezore, te asistences teknike dhe keshilluese, mbeshtetejes infrastrukture dhe te kerkimeve.

Nje program i ri ambicioz 3 vjecar per te mbeshtetur sistemin e Drejtesise per te Miturit tashme eshte lançuar si bashkepunim ndermjet UNICEF-it, Ministrise se Drejtesise, SIDA-s Suedeze dhe Komisionit Evropian dhe do te kete mjaft mundesi bashkepunimi lidhur me kete program te rendesishem.

Shoqeria Civile Shqiptare eshte zhvilluar mjaft ne vitet e tranzicionit. Organizatat e Shoqerise Civile Kombetare jane shtuar ne te gjithet sektoret.



Ka patur rritje ne rrjetin e shoqerise civile duke synuar veprimtari me te gjere ne fushen e advokacise dhe ne çeshtje te veçanta qe kane lidhje me te drejtat e femijeve.

Perfaqesues nga disa prej ketyre rrjeteve perfshire dhe Aleancen Shqiptare per Femijet dhe Koalicionin Te gjithe se bashku kunder Trafikimit te Femijeve jane dhe sot pjesemarrës ne kete Konference.

Partnershipi ne vijim me UNICEF-in, PLAN International dhe Aleances Shqiptare per Femijet, ka per synim ngritjen e nje koalicioni te forte dhe mbeshtetes per agjensite kombetare ne kontekstin e Konventes Mbi te Drejtat e Femijeve, duke mbuluar te gjithe vendin.

Prioritetet strategjike te programit Save the Children ne Shqiperi, se pari reflektojne keto objektiva:

- Edukimi me te drejtat e femijeve
- Te drejtat e femijeve per tu mbrojtur ndaj dhunes dhe abuzimit seksual,
- Fuqizimi i zbatimit dhe monitorimi i te drejtave te femijeve.

Qe prej vitit 2004 Save the Children ne Shqiperi ka implementuar Projektin per nje Edukim Cilesor brenda kuadrit te bashkepunimit me Ministrine e Arsimit dhe te Shkences.

Projekti ka nje shtrirje kombetare dhe bazohet ne trajnimin e mesuesve dhe te shkollave per nje pjesemarrje active te femijeve ne aktivitetet.

Qeveria Shqiptare ka bere progress duke parashikuar politika te cilat do te ndihmojne e mbeshtetin ne procesin e edukimit.

Qeveria Shqiptare ka bere perpjekje per te parandaluar trafikimin e femijeve, rritjen e ndergjegjesimit dhe asistimin e viktimave. Qeveria pergatiti rruget qe luftojne trafikimin ne nivel politikash duke ratifikuar konventat dhe protokollet nderkombetare, dhe duke nenshkruar marreveshjet institucionale dhe strukturat, qofshin lokale, kombetare apo nderkombetare per kete qellim.

Ne Dhjetor 2004 qeveria Shqiptare pergatiti nje Strategji Kuader dhe nje Plan Kombetar per te Luftuar Trafikimin. Ndryshimi i vetem i ketij Plani Veprimi eshte zbatimi i tij.

USAID-i eshte nje aktor strategjik dhe partner ne nje projekt qe do zbatohet nga Terres Des Hommes si dhe nga Programi Kordinues kunder trafikimit Njerezor.

Agjensi te tjera per luften ndaj trafikimit te femijeve jane dhe OSBE, Organizata Nderkombetare per Migrimin (IOM), UNICEF dhe ILO/IPEC.

Kane dale dhe mundesi te tjera per permiresimin e niveleve te pjesemarrjes se femijeve nepermjet iniciativave siç mund te jene ngritja e qeverive te nxenesve ne shkolla, klubet e femijeve, dhe parlamenti studentor. Ne duhet te

perpiqemi te gjithë te mbështesim me mundësi me te medha femijet ne menyre qe te realizojne te drejtat e tyre qytetare dhe te pjesëmarrjes.

Mbi bazen e këtyre refleksioneve mbi iniciativat për te adresuar te drejtat e femijeve qe kane lidhje teresisht apo pjeserisht me punen tone, mundësite për nje bashkëpunim me te madh ndermjet aktoreve duke përfshire dhe femijet ekzistojne.

Edhe tema e kesaj konference eshte mjaft sinjifikante. Ne do ta perdorim kete mundësi jo vetem për te shkëmbyer eksperiencen dhe observimet, por dhe për ta perforcuar lidhjet tona për bashkëpunim, koordinim dhe mbështetje te ndërsjellte. Ky do te perbeje dhe nje faktor baze ne zhvillimin e aftësive kolektive për nje adresim me te mire te te drejtave te femijeve ne Shqiperi.

## **FJALA PERSHENDETESE E**

**Zj. Margarida BARROSO**

Bruksel, 5 dhjetor 2005

Z. Ermir Dobjani,  
Ombudsmani Parlamentar  
i Republikës së Shqiperise

I dashur Z. Dobjani,

Ishte kenaqesi qe ju takova ne Zvicer dhe ju jam mirenjohese per ftesen per te marre pjese ne Konferencen tuaj Kombetare "Te gjithë se bashku ne mbrojtje te te drejtave te femijeve" qe do te zhvillohet ne Tirane me 15 dhjetor 2005.

Me vjen keq qe me duhet t'ju them se fatkeqesisht une nuk do te jem ne gjendje te jem me ju ne kete konference per shkak te angazhimeve te mia te paravendosura qe tashme eshte e pamundur ti riprogramoj. Ju lutem me shfajesoni per kete njoftim te vone por une deritani kisha shpresuar te mundesoja pjesemarrjen time.

Sikurse dhe mund ta kuptoni jam thellesisht e shqetesuar per situaten e pasigurt dhe te rrezikshme qe ende ndeshin nje numer kaq alarmues femijesh ne Europe dhe ne bote. Shume kohe me pare kam vendosur qe vec obligimeve te mia personale me femijet dhe familjen time, t'ia perkushtoj kohen dhe kapacitetet e mia punes per nje kuptimi me te mire te asaj cfare nje femije eshte ne te vertete dhe per njohjen sic duhet te te drejtave te tyre, kudo dhe kurdohere qe kjo njohje te drejtash mungon. Une besoj se ne kemi nevojte te mobilizojme te gjithë shoqerine tone dhe se na duhen perpjekjet e te gjithëve per te siguruar qe nje femije mund te jetoje i sigurt dhe ne nje mjedis te dashur qe respekton integritetin e tyre fizik dhe psikologjik. Vetem atehere ata mund te zhvillojne potencialin e tyre emocional dhe intelektual dhe te rriten te shendetshem dhe te respektueshem. Eshte besimi im i thelle se eshte kjo rruga qe ne duhet te ndjekim drejt endres per nje bote me te mire.

Ju lutem te jeni te sigurt qe une e ndjek situaten politike dhe sociale ne vendin tuaj me shume interes.

Shpresoj se Konferenca do te jete nje hap i rendesishem drejt promovimit dhe mbrojtjes se te drejtave te femijeve dhe se ju se shpejti do te jeni krenar per arritjet tuaja ne kete fushe te rendesishme.

Me urimet e mia me te mira drejt suksesit per vendin tuaj

# VIZIONI DHE VEPRIMTARIA E AVOKATIT TE POPULLIT NE MBROJTJE TE TE DREJTAVE TE FEMIJEVE

## Riza PODA

Komisioner prane Avokatit te Popullit

### **Te nderuar pjesmarres,**

Ne reference te Konventes per te Drejtat e Femijeve, vleresuar si produkt i perpjekjeve te komunitetit nderkombetar per te arritur standartet e kerkuara edhe nga vendet e tjera lidhur me statusin e femijes, edhe kjo konference kombetare e organizuar nga Avokati i Popullit nuk mund te jete gje tjeter, perveçse nje tregues qe institucionet e shtetit shqiptar dhe shoqeria civile, tashme me kahje te percaktuar qarte drejt realizimit te standarteve te larta qe synojme te vendosim per lirite themelore te individit-femije, mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna, abuzimi, neglizhenca dhe shfrytezimi.

Gjithe sa me siper jane te drejta negative qe individi – femije i gezon per nga vete natyra. Por jane pikerisht nderhyrjet brutale te egocentrizmit global dhe lokal, ato qe kushtezojne si kunderpeshe edhe disa te drejta pozitive, pra veprimin e shtetit per te ndermarre masa qe shkelja e te drejtave te mesiperme te neutralizohet permes riintegrimit te femijeve ne familje, sigurimit te kujdesit prinderor, aksesit te femijeve ne kujdesin shendetsor, sigurimet shoqerore, edukim dhe mbi te gjitha ne kohen e lire, pasi nje femije eshte i tille dhe mund te ndihet femije vetem ne kohen e lire.

### **Te nderuar zoterinj,**

Ndonese ka kaluar nje periudhe relativisht e shkurter nga krijimi i Institucionit te Avokatit te Popullit, mund te themi se jane bere hapa konkrete dhe efektive ne drejtim te mbrojtjes se te drejtave te femijeve. Kjo, jo vetem ne plotesimin e kuadrit ligjor, por edhe ne praktiken e perditeshme, nepermjet vezhgimeve investigimeve, nderhyrjeve, rekomandimeve dhe berjeve publike te cfaredo rasti qe ka cenuar apo vene ne dyshim te drejtat e femijeve.

Qe ne fillim te veprimtarise se tij ne vitin 2000, Avokati i Popullit trajtoi me nismen e tij nje rast te bere publik nga media, qe kishte te bente me keqtrajtimin e te miturit Erges Shele, ne Shtepine e Femijes Sarande. Pa u ndalur gjate ne pershkrimin e rastit, mund te themi se fale nderhyrjes se Avokatit te Popullit, u ndeshkua me largim nga puna dhe denim penal punonjesi i policise, qe beri keqtrajtimin. Madje mund te themi se rasti ne fjale ka bere edhe xhiron e botes, pasi nuk ka mbetur raport nderkombetar pa e referuar, qe nga ai i Departamentit Amerikan te Shtetit, e deri tek ai i Amnesty International. E themi kete, pasi, ne fund te fundit, qellimi i Avokatit te Popullit nuk eshte thjesht ndeshkimi i fajtorit. Kete e beri gjykata. Qellimi i Avokatit te Popullit eshte qe me precedentin e krijuar per ndeshkueshmerine e atyre qe keqtrajtojne femijet, t'u jepet ndihme e terthorte qindra e qindra femijeve te tjere, te cilet ndoshta nuk do tu duhet te trokasin kurre tek dera e Avokatit te Popullit.

Pas viteve 90-te vihet re nje praktike gjyqesore qe deri diku i pergjigjet maksimalisht interesit me te larte te te miturit. Kjo sidomos ne rastet e divorceve kur femija ose femijet i lihen per rritje dhe edukim nje ose te dy

prinderve, ku disa here shihen me teper interesat e prinderve se sa te femijeve, ose ne rastet e detyrimit ushqimorm ku shpesh here femijet nuk marrin shumen e nevojshme per edukimin, arsimimin, dh emirerritjen e tyre.

Ndryshe eshte rasti i te mitures Jonada Dervishi nga Berati, e cila ne daten 4 mars 1999, kur ishte vetem shtate muajsh, rrembehet nga tre individe kriminele dhe gjate perpjekjes me policine, nga kjo e fundit plagoset ne bark si dhe humbet kemben e djathte. Pa u ndalur ne kalvarin e familjes se foshnjes per ta kuruar ate ne Itali, shpenzime keto qe e kushtezuan familjen te shiste edhe shtepine dhe gjithçka tjeter, mund te themi se nderhyrja e Avokatit te Popullit, fale edhe Ministrit te Rendit, z. Sokol Olldashi, beri te mundur ekzekutimin e vendimit gjyqesor per demshperblimin e viktimes ne masen e 9.602.042 lekeve.

Dhe natyrisht qe te gjitha keto do te ishte cinike t'i konsideronim bamiresi. Jo. Ne themi vetem se beme te mundur respektimin e Kushtetutes dhe legjislacionit ne fuqi, duke finalizuar ekzekutimin e vendimit gjyqesor. Raste te tilla te njejta kane ndodhur edhe me vendimet gjyqesore qe lidhen me femijet Mirgen Matmuja, Amela Berberi, Bruno Farasholli etj.

Eshte me vend te vihet ne dukje trajtimi nga Institucioni yne i rasteve me natyre me komplekse dhe qe lidhen me vende te tjera fqinje, sic ishte ai i "zhdukjes" se nje numer i madh femijesh shqiptare ne nje institucion kujdesi te femijeve (Agia Varvara) ne Greqi, apo edhe raste te tjera qe kane te bejne me marrjen e paligjeshme te femijes nga njeri prind dhe dergimin e tyre jashte shtetit. Keto çeshtje jane ndjekur dhe vazhdojne te ndiqen nga Avokati i Popullit ne bashkepunim me Institucionet homologe te vendeve tjera.

Nje hapësire te madhe ne kuader te punes se Institucionit te Avokatit te Popullit per respektimin e te drejtave te njeriut, krijuan sidomos ndryshimet e fundit ne Ligjin "Per Avokatin e Popullit". Keshtu mund te permendet neni 13 i ligjit te ndryshuar, sipas te cilit....." *Ne rastet kur Avokati i Popullit fillon proceduren e shqyrtimit te çeshtjes me nismen e vet, dhe kur kujdestari ose perfaqesuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kerkohet pelqimi i te demtuarit kur eshte i mitur apo i paafte menderisht apo me aftesi te kufizuara ose per mbrojtjen e te drejtave te nje numri te madh te individeve.*

Per te qene me prane mbrojtjes se te drejtave te femijeve, prane Institucionit tone u mendua dhe rreth nje vit me pare eshte ngritur nje nen-seksion i vecante per mbrojtjen e te drejtave te femijeve. Kjo strukture e re, qe eshte ne hapat e para te punes se saj, u krijua ne bashkepunim me organizaten Save the Children in Albania dhe Agjensine Suedeze per Zhvillim Nderkombetar (SIDA). Gjate muajit janar 2006 pritet te filloje financimi nga SIDA i projektit (tre vjecar) me qellim funksionimin e plote te ketij nen-seksioni.

Detyra kryesore e ketij nen-seksioni eshte mbrojtja e te drejtave te femijeve ne Shqiperi, ne perputhje me Konventen per te Drejtat e Femijes (UN) si dhe instrumenteve te tjere ligjore kombetare dhe nderkombetare dhe konkretisht:

- \* mbikqyrja e veprimtarise se administrates publike si dhe te organizatave te tjera private ne territorin e Shqiperise qe u sigurojne sherbime femijeve, me qellim nbrojtjen e te drejtave te tyre.
- \* trajtimi i ankesave qe kane te bejne me shkeljen e te drejtave te femijeve.

- \* permiresime te legjislacionit egzistues qe ka te beje me mbrojtjen e te drejtave te femijeve.
- \* promovimi i te drejtave te femijeve e veprimeve qe percaktojne menyren se si ushtrohen keto te drejta, si dhe ndergjegjesimin e shoqerise ne pergjithesi.

Ne te ardhmen Institucioni yne krahas detyrimeve qe ka ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijeve dhe luftes kunder trafikimit te tyre, mendon te organizoje nje fushate ne shkalle kombetare per mbrojtjen e te drejtave te femijeve. Ne kete fushate do te mbahen parasysh sidomos:

- \* Rezervimi i nje vemendje te vecante ndaj pozicionit te femijeve viktima te dhunes seksuale, detyrimit per te punuar ne pune te renda etj.
- \* rishikimi i funksionimit te procedurave juridike duke konsideruar qe ato te aplikuar ne vendin tone shpesh here nuk lejojne apo pengojne femijet dhe prinderit e tyre te kallezojne kunder agresoreve te tyre.
- \* Aktivizimi per te eliminuar pengesat qe ndalojne femijet te perfitojne mbrojtje juridike.
- \* Njohja e Institucionit te Avokatit te Popullit edhe nga ky grup interesi, sikunder jane femijet nepermjet shfaqjes ne shkolla te Dokumentarit tone "Avokati i Popullit" nje dere e hapur per ju".

### **Te nderuar pjesemarres,**

Femijet jane subjektet me te ekspozuara ndaj formave te tilla te skllaverise moderne, sikunder jane ato te bazuara mbi shfrytezimin seksual dhe punen. Per rrjedhoje keto viktima jane te privuara nga cfaredo e drejte njerezore dhe detyrohen nepermjet kercentimeve dhe keqtrajtimeve.

Ne muajin shkurt te vitit 1997 Keshilli i Europes adoptoi veprime kunder trajtimit te qenieve njerezore dhe shfrytezimit seksual te femijeve dhe shtetet anetare u impenjuan per te ripare legjislacionet e tyre kombetare. Por, le te ndalem pak konkretisht, se çfare presim ne si Institucion nga Projekti me organizaten Save the Children? Minimalisht dhe ne vija te trasha, po permend ketu vetem dy elemente:

1. Forcimi e kualifikim i metejshe i kapaciteteve njerezore te Zyres se Avokatit te Popullit e ne vecanti te Nenseksionit per te Drejtat e Femijeve per te bere nje mbrojtje me te mire e me te kualifikuar te te drejtave te femijeve.

2. Krijimi i nje biblioteke te vecante per te drejtat e femijeve, qe do t'i sherbeje grumbullimit te informacionit mbi praktikat me te mira lidhur me mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

Po ne nga ana jone, çfare do te bejme me mire?

1. Kryerja e studimeve krahasimore per perqasjen e legjislacionit shqiptar dhe zbatimin sa me te mire te detyrimeve te Konventes se Kombeve te Bashkuara mbi te Drejtat e Femijeve.

2. Mbetet shume per t'u bere ne kuadrin e sensibilizimit te opinionit publik, per ekzistencen, punen e misionin e ketij nenseksioni ne mbrojtje te ketyre te drejtave. Kjo jo vetem me fushata promovimi, por dhe nepermjet mbajtjes se kontakteve te rregullta me mediat , duke publikuar rast pas rasti

çeshtjet e trajtuara nga nenseksioni per shkelje te te drejtave te femijeve nga organet e administrates publike.

3. Mbajtja e kontakteve te rregullta me mjaft OJF shqiptare dhe nderkombetare qe punojne ne fronte te ndryshme por me objekt te pergjithshem te punes se tyre, mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

Se ketejmi lindin dhe objektivat se çfare do te hetojme dhe rekomandojme:

4. Se pari, ne c'nivel eshte e drejta e pjesemarrjes se femijeve.

5. Se dyti, informimi me i mire per te drejtat e femijeve i te gjitha strukturave shtetere, organeve te administrates publike, puna e te cilave lidhet e ndikon ne jeten e femijeve dhe te te rinjve.

6. Nenseksioni do te punoje per te "vezhguar" realizimin ne praktike te parimeve themelore te Konventes Mbi te Drejtat e Femijeve, Konvente kjo qe perben nje dokument qe ka te beje jo vetem me te drejtat civile dhe politike, por dhe shoqerore, ekonomike dhe kulturore te femijeve.

7. Te ndjekim zbatimin e Strategjise Kombetare per Personat me Paaftesi (miratuar me VKM nr.8 date 7.01.2005), per femijet me paaftesi.

8. Trajtim i ankesave individuale, per mosrespektim apo dhunim te te drejtave te femijeve. Identifikim dhe nxjerrja ne pah e veprimeve apo mosveprimeve te paligjshme e te parregullta nga ana e organeve shtetere, te cilat ndikojne drejtpersedrejti tek femijet. Kjo sidomos ne kontekstin e shkollave, spitaleve, burgjeve, institucioneve.

9. Te punohet me te gjitha partnered per te ngritur nje system alarmi, te ngjashem me sistemin Ambra Alert per te gjitha femijet e humbur ne Shqiperi.

Sa me siper eshte parashikuar te jete komplementare me planin ekzekutivo praktik kombetar qe eshte perpiluar tashme edhe ne Strategjine Kombetare per Femijet si dhe Planin e Veprimit te Qeverise shqiptare per zbatimin e kesaj Strategjie.

Krijimi i Komitetit Nderministror per te Drejtat e Femijeve, si institucion i cili organizon dhe koordinon nxitjen e politikave dhe programeve per zhvillimin si dhe te drejtat dhe lirite e femijeve, padyshim eshte autoriteti shtetesor i posaçem, bashkepunimin me te cilin e konsiderojme pjese te natyrshme te punes tone.

### **Te nderuar zoterinj,**

Te gjitha besoj biem dakort qe femijeria eshte nje periudhe e kapaciteteve ne zhvillim, e zhvillimit te personalitetit, talenteve, aftesive mendore dhe fizike te njeriut. Ne fund te fundit, ne kemi detyrimin t'i lejojme femijet te luajne rolin e tyre si aktoret me te natyrshem te komunitetit njerezor. Dhe ky pohim mendoj se ka nje dimension sa vete historia e gjenezes.

Duke kerkuar ndjese per ndonje pohim kategorik, shpreh bindjen se sa me siper do te plotesohet dhe korigjohet nga diskutimet e tjera.

Ju faleminderit!

# **POLITIKAT SOCIALE PER FEMIJE DHE REFORMIMI I SISTEMIT TE SHERBIMEVE**

## **Marjeta ZAÇE**

ZëvendësMinistrie e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta

Te nderuar pjesemarres,  
Te nderuar organizatore,

Ne emer te Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, deshiroj te shpreh falenderimin tim per organizatoret e kesaj Konference te cilet shtrojne per diskutim nje problem te rendesishem sic eshte ai i mbrojtjes dhe i monitorimit te te drejtave te femijeve.

Synimet e kesaj Konference jane ne harmoni me Objektivat e Programit te Qeverise shqiptare per politikat ndaj femijeve.

Femijet jane nje nder grupet prioritare qe mbeshteten me politika dhe sherbime nga MPÇSSHB.

Per mbrojtjen e femijeve, eshte ratifikuar Konventa per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve dhe eshte hartuar Strategjia Kombetare per Femije, e cila eshte miratuar me VKM nr. 368, dt. 31.05.2005.

Parimet ne te cilat mbeshteten politikat dhe sherbimet e mbrojtjes shoqerore per femije jane:

- *Ndihma per familjet, me qellim qe ato te sigurojne nje mjedis te pershtatshem per mirerritjen dhe edukimin e femijeve;*

Kjo realizohet nga Programi i Ndiemes Ekonomike dhe sherbimet sociale te ofruara nga institucionet publike, private dhe OJF-te. Mbeshtetja e jetimeve dhe prinderve qe kane me shume se 2 femije te lindur njeheresh

- *Femijet pa kujdes prinderor, trajtohen me sherbime ne Institucionet Rezidenciale qe administrohen nga Sherbimi Social Shteteror.*

Keto institucione ofrojne sherbime me standarte te kenaqshme qe po permiresohen vazhdimisht, me aplikimin e metodave bashkekohore dhe asitences se donatoreve.

Shtepite e Femijes, ofrojne sherbim nga foshnjeria deri ne moshen 17 vjeç.

- *Sigurimi i nje mjedisi familjar per çdo femije ne nevoje.*

Ky parim udheheq punen e Komitetin Shqiptar te Biresimeve, i cili eshte institucioni pergjegjes per rregullimin e procedurave te biresimit, si nga shtetas shqiptare ashtu edhe nga te huaj.

Numri i femijeve qe trajtohen ne institucionet e perkujdesit shoqeror eshte rreth 400. Qendra perkujdesi per femije jane ngritur edhe nga OJF-te, te cilat jane licensuar apo kane kontrata bashkepunimi me MPÇSSHB. Sherbimi ne keto qendra eshte me cilesi me te larte dhe monitorohen nga Sherbimi Social Shteteror.

Strategjia Kombetare per Femijet parashikon masa dhe veprime per mbijetesen, mbrojtjen, zhvillimin dhe pjesemarrjen e femijeve dhe ngarkon me detyra per zbatimin e saj disa ministri dhe institucione.



Detyrat qe rrjedhin nga kjo Strategji si dhe nga Strategjia e Sherbimeve Sociale, qe u miratua kete vit jane perfshire ne planet e punes te institucioneve te Ministrise se Punes.

Ne zbatim te Planit te Veprimit te Strategjise se Sherbimeve Sociale parashikohen masa per:

- decentralizimin e institucioneve te perkujdesit per femije,
- kalimin e tyre ne administrim te njesive te qeverisjes vendore,
- de-institucionalizimin e femijeve, stimulimin e sherbimeve qe sigurojne mjedis familjar, si shtepite familje, kujdestaria tek te afermit ose familjet kujdestare dhe
- ngritjen e sherbimeve te reja ditore per femijet me prane komunitetit.

### **Vleresimi i situates se femijeve**

- Analiza e situates per femijet 0-18 vjec:
- **femijet jetime, te braktisur dhe te rruges, te trafikuar, qe punojne, me aftesi te kufizuara, femijet rom, qe braktisin shkollen, te abuzuar, te dhunuar, te pashoqeruar ne emigracion, etj.**

Sipas te dhenave administrative rezulton se ne:

- **Institucione rezidenciale publike trajtohen 400 femije,**
- **Qendrat rezidenciale jopublike trajtohen 200 femije**
- **Femije jetime pa ose me nje prind, qe jetojne ne familje / komunitet rreth 16 000 femije**
  - **Qendra rehabilitimi publike trajtohen 290 femije me AK**
  - **Qendra ditore publike per rehabilitim trajtohen 61 femije me AK**
  - **Qendrat ditore jopublike trajtohen 250 femije etj.**
  - Te dhenat per femijet e rruges, femijet e dhunuar, femijet e pashoqeruar ne emigracion apo te trafikuar, femijet qe punojne, femijet e ngjuar etj, shpesh jane te mbivendosura dhe jane kontradiktore.
  - Kerkohet nje sistem te dhenash per identifikimin dhe masat per mbrotjen e femijeve.

### **1. Femijet jetime dhe me probleme sociale ne institucionet rezidenciale**

#### **Sherbimet per kete kategori ofrohen:**

- Nga pjestare te familjes ose te aferm te jetimit,
- Ne 9 qendrat rezidenciale publike (400 femije) dhe 6 qendrat jopublike (200 femije)
  - Nga familjet sociale qe kane biresuar femije (mesatarisht cdo vit 60 - 70 femije)
  - Sherbimi i kujdestarise (deri tani per 350 femije nga shoqata Every Child).

#### **Problemet per femijet jetim ne institucione:**

- Sherbimet nuk arrijne standardet e cilesise dhe jane larg jetes se familjes.
- Jane te papergatitur per jete te pavarur pas moshes 18 vjeç.
- Mungon trajtimi per femijet qe nuk vazhdojne shkollat e mesme.
- Pas mbarimit te shkolles, nuk jane te siguruar me strehim dhe pune.
- Jane me te rrezikuara nga abuzimi seksual, shtatzania e hershme dhe perfshirja ne rrjetet e trafikut e te prostitucionit.
- Sherbimet alternative te pamjaftueshme.

### **Çfare pritet per te ardhmen**

- Modelimi i sherbimeve alternative te shtepive familje, te cilat po eksperimentohen.
- Promovimi i sherbimit te kujdestarise(po pergatiten projekte).
- Nxitja e biresimeve te hershme te femijeve qe jane braktisur dhe veçanerisht femijeve me probleme shendetesore.
- Investime ne infrastrukturen e institucioneve rezidenciale, rritjen e kapaciteteve te stafave per te rritur cilesine e sherbimeve.
- Implementimi i standardeve te pergjithshme dhe te femijeve per sherbimin ne institucione rezidenciale.

## **2. Femijet jetime pa prinder ose me nje prind qe nuk jetojne ne institucione**

### **Problemet qe evidentohen:**

- Femijet perfitojne pension familjar dhe jetojne me prindin ose me te afermit. Ka raste qe femijet nuk perfitojne pension.
- Mungojne strukturat dhe sistemi i identifikimit te nevojave te femijeve jetime ne nivel vendor.
- Mungojne programe per mbeshtetjen e familjeve me shume femije, me aftesi te kufizuar ose probleme sociale, per punesim, trajnim profesional apo ndihme ekonomike.
- Sherbimet alternative per femijet jane ne fazen fillestare: si sherbimi i kujdestarise, NE per te aferm qe kujdesen per femije jetime, familjet pritese dhe biresuese, sherbime te tipit shtepi familjeve etj.
- Mungon sistemi i mbikqyrjes, per neglizhencat, abuzimin, dhunes ndaj femijes etj.
- Nuk zbatohen masat shtrenguese ndaj prinderve qe braktisin femijet, i detyrojne te punojne, apo nuk i dergojne ata ne shkolle, etj.

### **Çfare pritet ne te ardhmen?**

- Sherbime alternative: sherbime ditore, sigurimi i familjeve kujdestare dhe biresuese. Te shkurtohet koha e qendrimit ne qendrat rezidenciale
- Mbeshtetja e familjes me te ardhura qe femijet te rriten ne mjedisin familjar.
- Permirersimi i ligjit “Per Biresimin”, “Per statusin e jetimit” dhe hartimi i ligjit “Per kujdestarine”,
- Te reduktohet kerkesa per te vendosur femijet ne qendrat rezidenciale, nepermjet edukimit per planifikimin familjar, parandalimin e braktisjes se femijes, prezantimin e sherbimeve etj.

- Te synohet qe femijet nen 8 vjeç te mos vendosen ne perkujdesje rezidenciale, perveçse ne raste emergjencash dhe per nje kohe shume te shkurter.
- Zbatimi i standardeve te sherbimit te perkujdesit shoqeror per femijet ne institucionet rezidenciale.
- Te licensohen ofruesit e sherbimeve publike, private dhe OJF-ve dhe te rritet cilesia e sherbimeve.
- Te sigurohet informacion nga njesite e qeverisjes vendore per femijet jetime, ato me nje prind dhe me probleme sociale.

### **3. Femije te braktisur, te rruges**

#### **Çfare eshte bere deri tani?**

- Fushata sensibilizimi, ndergjegjesimi dhe parandalimi te braktisjes se femijeve;
- Programe per uljen e numrit te femijeve te rruges;
- Programe per vazhdimin e shkolles dhe formimin profesional.

#### **Çfare pritet per te ardhmen?**

- Rritja e llojshmerise se sherbimeve, si: shtepite familje prane institucioneve rezidenciale publike dhe jopublike, qendrat ditore, komunitare etj.
- Zgjerimi i sherbimit te kujdestarise,
- Sigurimi i biresimit te hershem,
- Mbeshtetje per familjen, qe femijet te ndjekin shkollen
- Masa mbrojtjeje nga struktura speciale ne rastet e neglizhences, abuzimit apo dhunes.
- Masa shtrenguese ndaj prinderve qe braktisin femijet, apo nuk i dergojne ata ne shkolle, i detyrojne te punojne etj.

### **4. Femijet e trafikuar**

Qeveria ka bere perpjekje te vazhdueshme per parandalimin e trafikimit te qenieve njerezore ne pergjithesi dhe te femijeve ne veçanti. Format me te perhapura per trafikim e femijeve kane qene shfrytezimi per qellime seksuale, per shperndarje droge, per lypje, per tregti ne rruge, per qellime pornografike etj.

Te dhenat per numrin e femijeve te trafikuar, si pasoje e natyres klandestine te fenomenit te trafikimit, nuk jane te sakta. Nga burime te ndryshme vendase dhe te huaja, jepen te dhena kontradiktore. P.sh vleresohet se numri i femijeve te pashoqeruar ne emigracion ne Itali, ne vitin 2001 ishte rreth 4000. Sigurisht qe femijet e pashoqeruar ne emigracion jane me te rrezikuar per te rene ne rretet e trafikanteve.

Ne Greqi sipas studimeve te organizatave joqeveritare qe punojne kunder trafikimit te femijeve, numri i femijeve te perfshire ne rretat e trafikanteve eshte me i madh dhe vleresohet te jete rreth 5000.

Femijet, kontigjent per trafikim kryesisht jane nga familje me probleme ekonomike e sociale:

- Te karakterizuara nga dhuna ne familje, abuzimi, shfrytezimi dhe /ose neglizhenca;

- Familje te varfera, qe perfshijne femijet ne pune, ne dem te shkollimit dhe aktiviteteteve te moshes;
- Familje ku kujdesi per femijet eshte i paket, femije me nje prind, apo ku njeri nga prinderit punon jashte vendit, ku prinderit jane abuzues te alkoolit, droges, me probleme te shendetit mendor, me aftesi te kufizuara mendore, etj;
- Femije qe jetojne jashte perkujdesit familjar (jetime, apo jetime sociale);
- Familje nga te cilat jane trafikuar edhe femije te tjere me pare;
- Femijet qe kane braktisur shkollen dhe jane shnderruar ne lypsa;
- Femije te paregjistruar qe ne lindje.

#### **Problemet qe evidentohen:**

- Sisteme te pamjaftueshme sherbimesh per mbrojtjen e femijeve, per identifikimin dhe ofrimin e ndihmes se duhur psiko-sociale dhe socio-ekonomike per femijet ne rrezik dhe familjet e tyre.
- Varferia, perjashtimi social dhe mundesite e kufizuara te familjeve per te siguruar ardhura, duke kerkuar qe ato te sigurohe edhe me punen e femijeve.
- Mundesite e kufizuara per punesim brenda vendit dhe rruget e pakta per emigrim legal, shtyjne familjet e tyre per te ndermarre rrugezgjidhje te rrezikshme per femijet.
- Pamundesi te femijeve dhe familjeve ne rrezik per te vleresuar situatat e mundshme per shfrytezim.
- Mungesa e marreveshjeve te bashkepunimit me vendet pritese te femijeve, viktima te trafikimit.

#### **Çfare eshte bere deri tani**

- Per parandalimin e ketyre fenomeneve eshte hartuar nje Strategji kunder Trafikimit te Femijeve dhe per Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikimit, e cila eshte miratuar me VKM nr. 171, dt. 11.2.2005.
- Ne Planin e Veprimit te kesaj Strategjie parashikohen detyra per:
  - parandalimin nepermjet masave per ndergjegjesimin e grupeve ne risk trafikimi dhe koordinimin e veprimeve te strukturave publike dhe te sektorit jofitimprures per kete qellim;
  - mbrojtjen e viktimave duke siguruar sherbime pritese dhe akomoduese, pergatitje per kthim prane familjes ose te afermve;
  - hetimin dhe denimin e trafikanteve duke patur parasysh specifikat e veprave penale ndaj te miturve;
  - kthimin vullnetar dhe te asituar te femijeve te trafikuar nga vendet pritese, bashkepunimi ndermjet autoriteteve pergjegjese nga te dy vendet dhe perfshirjen e OJF-ve ne çdo rast;
  - Jane organizuar fushata sensibilizuese dhe ndergjegjesimi ne shkolla, komunitet, ne media per te parandaluar fenomenin.
  - Jane zbatuar programe per identifikimin e femijeve te rruges dhe ne rrezik trafikimi, eshte ofruar mbeshtetje materiale per familjet e varfera qe femijet te mos braktisin shkollen.
  - Programe te formimit profesional per femijet qe nuk vazhdojne shkollen
  - Programe per rikthimin e asistuar te femijeve dhe integrimin e tyre ne familje apo komunitet.

- Jane pritur dhe ofruar shërbime për viktimat e trafikut, gra, vajza dhe fëmijë, vendase dhe të huaja, të rikthyera nga vendet pritëse. Në një Qendër Kombëtare (rreth 300 përfitues).
- Jane hartuar dhe po negocohen marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe Qeverisë greke për mbrojtjen e fëmijëve të pashoqeruar, të trafikuar dhe në rrezik trafikimi që ndodhen në Greqi.

### **Çfare pritet në të ardhmen?**

- Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të fëmijëve. Politika që adresohen drejt parandalimit, mbrojtjes, kthimit vullnetar të asistuar, riadhesimit dhe riintegritimit të fëmijëve të trafikuar.
- Krijimi i mekanizmave multi sektoriale (Mekanizmi Kombëtar Referues) të identifikimit të viktimave të trafikimit dhe veçanerisht të fëmijëve të trafikuar.
- Krijimi i Autoriteti përgjegjës që do të shërbejë si koordinues i mekanizmit kombëtar referues;
- Bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve dhe partnerëve që punojnë në fushën e trafikimit të fëmijëve.
- Rikthimin në shkollë të fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi, që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe ofrimin e alternativave për formim profesional për të rinjtë në mosha të reja.

## **5. Fëmijë që punojnë**

- Kryesisht janë: shitës ambulante, lypesa, pastrues të makinave në semafore, punëtorë në bujqësi, veçanerisht në zonat rurale etj.
- Format më të keqja të punës së fëmijëve janë trafikimi për vjedhje, përfshirje në aktivitete të paligjshme etj.

### **Problemet që evidentohen:**

- Impakti i programeve dhe politikave për menjanimin e punësimit të fëmijëve është ende i pamjaftueshëm.
- Puna e fëmijëve mbetet veprimtari e fshehtë nga subjektet private.
- Bashkëpunimi me shkollën, familjen e komunitetin për rritjen e ndergjegjesimit të publikut për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve është i pamjaftueshëm.
- Evidentimi, vlerësimi dhe adresimi i drejtë i këtij problemi, kundër praktikave të rrezikshme dhe shfrytëzuesë të punës dhe trafikimit të fëmijëve për tërheqjen nga puna dhe trafikimi, dhe referimin e rasteve.
- Forcimin e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal; i cili do të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me të gjitha institucionet dhe strukturat që lidhen me punën e fëmijëve si Bashkia, Zyra e Punës, Arsimi, Policia, Shëndetësia si dhe partneret social.
- Treguesit për evidentimin dhe monitorimin e punësimit të fëmijëve nuk janë të mjaftueshëm, kjo veçanerisht për sektorin informal ku gjendet dhe numri më i madh i fëmijëve që punojnë. Ky sektor nuk është subjekt i inspektimit nga Inspektorati i Punës.
- Shkëmbimi i informacionit midis strukturave që lidhen me punën e fëmijëve nuk është i mjaftueshëm.

- Institucionalizimi dhe monitorimi i punes se femijeve, nepermjet krijimit dhe funksionimit te Komiteteve Lokale dhe Grupeve Monitoruese ne nivel lokal, qe tashme jane krijuar ne te tre keto rajone.

### **Çfare eshte bere deri tani?**

Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale ka demonstruar vullnet dhe angazhim ne luften kunder punes dhe trafikimit te femijeve nepermjet :

Implementimit te programeve kombetare per parandalimin e ketyre fenomeneve dhe rehabilitimin e femijeve viktime si bashkepunim i Ministrise me ILO/IPEC (Programi Nderkombetar per Eleminimin e Punes se Femijeve).

Krijimi i **Komitetit Drejtues Kombetar** per Programin “Mbi eleminimin e punes se femijeve”.

Krijimi dhe funksionimi i **Njesise se Punes te Femijeve**, si strukture e Ministrise se Punes, Çeshjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, qe funksionon si pike fokale kombetare.

Perfshirja e kesaj çeshtjeje ne politikat kombetare dhe strategjite qe hartohen ne te gjitha nivelet dhe ne politikat rajonale.

Forcimit te kapaciteteve institucionale per nje adresim te drejte te çeshtjes se punes dhe trafikimit te femijeve si ne nivel qendror dhe ate lokal.

Studimi, “Legjislacioni shqiptar lidhur me punen e femijeve dhe rekomandime per harmonizimin e tij me standartet nderkombetare” dhe rekomandimet per nxitjen e modifikimeve te mundshme te legjislacionit tone.

Dhenia prioriteteve rritjes se kapaciteteve te inspektoreve te punes dhe partnereve te tjere per t’iu pergjigjur sistematikisht dhe ne menyre te gjithaneshme formave me te keqia te punes se femijeve si ne sektorin formal dhe veçanerisht ate joformal.

Rritja e sensibilizimit te pergjithshem mbi çeshtjen e punes dhe trafikimit te femijeve si nje nga format me te keqia te punes se femijeve;

### **Çfare pritet ne te ardhmen:**

Forcimi i kapaciteteve te Inspektoriatit te Punes dhe partnereve te tjere mbi Sistemin e Monitorimit te Punes se Femijeve.

Perfshirja e punes se femijeve ne politikat dhe programet e pergjitheshme kombetare.

Finalizimi i “Raportit Kombetar dhe Planit Strategjik mbi politikat kombetare lidhur me çeshtjen e punes se femijeve ne Shqiperi”, qe do te lehtesoje procesin e implementimit te ketyre politikave nepermjet perfshirjes se nje rangui te gjere aktoresh dhe institucionesh aktive ne adresimin e ketyre problemeve, si ne nivel qendror edhe ate lokal.

Po punohet per pilotimin e nje “Sistemi te Monitorimit te Punes se Femijeve” ne 3 rajone, Tirane Korçe dhe Berat i cili synon:

## **6. Femije me aftesi te kufizuara**

### **Problemet qe evidentohen:**

- Sherbimet ditore dhe komunitare per femijet me AK jane ende te pamjaftueshme;
- Nuk ka mbeshtetje te mjaftueshme psiko-sociale per familjen;

- Nuk ka programe per trajnimin e tyre profesional, integrimin ne jeten komunitare;
- Ka pengesa ne mjedis per levizje dhe komunikim;
- Mungon vleresimi per AK ne te gjitha fazat e zhvillimit te femijes.
- Ka mungesa per te hyre ne klasat e integruara.
- Mangesi ne trajtimin e femijeve te komunitetit rom dhe egjyptian.

### **Çfare eshte bere deri tani?**

- Perfitimet per femijet e lindur me aftesi te kufizuar ose te bere te tille deri ne moshen 21 vjeç jane:
  - Nje pagese per aftesine e kufizuar ne kesh (70 \$), me qellim qe familja te permbushe nevojat e veçanta te femijes me AK.
  - Kur vazhdon shkollen e mesme marrin 200% te pageses se aftesise se kufizuar, kur vazhdon shkollen e larte marrin 300% te pageses.
  - Pagese kujdestarie per cdo femijen me AK qe nuk mund te kujdeset per veten sipas vendimit te KMCAP.
  - Femijet me AK perfshihen ne qendrat rezidenciale te zhvillimit, ne njesi ditore.

### **Çfare pritet ne te ardhmen?**

- Perpunimi i nje plani kombetar per femijerine e hershme, per pune te integruar per kete grupmoshe me ministrite e linjes.
  - Krijimi i nje strukture te veçante per femijet, brenda se ciles te kete nje njesi per femijerine e hershme.
    - Rritja e financimeve per PAK brenda buxheteve te ministrive te linjes.
    - Politika per arsim parashkollor per te gjitha femijet 0-6 vjeç, veçanerisht te atyre 5-6 vjeç.
    - Sigurimi i nje sistemi statistikor specifik te dhenash sipas rajoneve, gjinise, grupmoshave, etj.
    - Rishikimi i ligjeve qe trajtojne problemet shendetesore te nenes dhe te femijes
    - Permiresimi i legjislacionit penal, duke patur parasysh mbrojtjen e veçante te femijes nga te gjitha fenomenet qe paraqesin rrezikshmeri per jeten e tyre.

## **7. Femijet romë**

- Eshte miratuar Strategjia Kombetare per permiresimin e kushteve te jeteses per minoritetin rom.
  - Permiresimi i kushteve ekonomike, te shendetit, te arsimimit, kultures etj, per mirerritjen dhe zhvillimin e femijes.
    - Rregjistrimi dhe sensibilizimi i komunitetit, per te perfituar nga legjislacioni ne fuqi.
    - Rregjistrimi i femijeve si mase per mbrojtjen e tyre nga abuzimi dhe krijimi i mundesive per zhvillim.

### **Se pari: Reformimi i Sistemit te Sherbimeve Shoqerore**

#### **Çfare pritet ne te ardhmen?**

**Rruga e pare** – Decentralizimi. Transferimi i qendrave të shërbimeve rezidenciale (26qendra) në varesi të njësive të qeverisjes vendore, brenda 3 viteve të ardhshme .

**Rruga e dyte** - Ngritja e shërbimeve të reja shoqërore në komunitet. Janë ngritur 20 shërbimet e para ( 10 për femijet).

Me prioritet trajtohen femijet, femijet jetimë, të braktisur dhe të rruges, të trafikuar, që punojnë, me aftësi të kufizuara, femijet rom, që braktisin shkollën, të dhunuar, të pashoqëruar në emigracion, të abuzuar etj.

**Rruga e trete** – Deinstitutionalizimi. Transformimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime të levizshme me baze komunitare.

Deinstitutionalizimi si proces levizjeje nga shërbimet rezidenciale, në shërbime komunitare synon:

- Parandalimin e pranimëve dhe qëndrimeve të panevojshme në institucione rezidenciale.
- Sigurimin e alternativave të tjera për strehimin, trajtimin, edukimin dhe rehabilitimin e individëve që nuk e kanë të nevojshme qëndrimin në institucione rezidenciale.
- Përmirësimin e kushteve, përkujdesjes dhe trajtimit për individët që kanë nevojë për përkujdesje në qendra rezidenciale.
- Femijet qëndrojnë në institucione rezidenciale për një kohë minimale.
- Është bashkëpunuar me OJF, që synojnë të transformojnë shërbimin rezidencial për femijë në formë të tjera shërbimesh, shtëpi familje, kujdestari etj.

#### **Çfare është bërë deri tani?**

- Deinstitutionalizimi ka filluar në shtëpinë e foshnjës në Durrës.
- Shtëpia e foshnjës Shkoder po transformohet në qendër ditore për asistimin e femijëve dhe nënave të komunitetit.
- Është rritur numri i biërsimeve në familje brenda dhe jashtë vendit.
- Është synuar edhe biërsimi i femijëve në mosha të mëdha dhe të atyre me nevojë të vecanta

#### **Çfare pritet në të ardhmen**

Janë përcaktuar prioritetet për procesin e deinstitutionalizimit:

##### **A - Për Femjet**

- Femijet nën 8 vjeç, synohet të mos vendosen në institucione rezidenciale, përveç se në rast emergjence dhe në kohë të shkurtra.
- Të krijohen dhe zhvillohen sisteme alternative të përkujdesjes (familjet kujdestare dhe adoptuese).
- Të zhvillohen shërbimet ditore për femijë.
- Edukimi publik, për reduktimin e kërkesës për vende në qendrat rezidenciale dhe braktisjeve në maternitet.
- Të përgatiten femijet dhe të rinjtë në qendrat e përkujdesit rezidencial, për jetesën e pavarur jashtë institucionit.
- Të synohet që femijet të qëndrojnë në qendra rezidenciale për një kohë sa më të shkurtra.

#### **Se dyti : Garantimi i cilësive të shërbimeve shoqërore Nepermjet:**

- Hartimit dhe zbatimit të standarteve;



- **Licensimit te operatoreve publike e private qe ofrojne sherbime**
- **Inspektimit per zbatimin e standardeve.**

### **Standardet**

- Jane hartuar e miratuar standartet e pergjithshme si dhe standartet e femijeve per sherbimin rezidencial.
- Gjate periudhes 2006 - 2007 do te hartohen, testohen dhe miratohen, standartet per PAK, te moshuarit, viktimat e trafikut etj.

### **Licensimi**

- Eshte miratuar VKM "Per licensimin e subjekteve publike e private qe ofrojne sherbime shoqerore".
- Jane licensuar 20 subjekte.
- Ky proces do te vazhdoje edhe ne ardhmen.
- Me prioritet do te behet licensimi i subjekteve publike e private qe ofrojne sherbime ne :
  - **Qendra te kujdesit rezidencial per femije jetime, te braktisur, PAK, persona te varur nga alkooli dhe droga, viktimat e trafikimit etj,**
  - **Qendra ditore per femije, PAK, te rinj, te moshuar,**
  - **Qendrat e keshillimi, te planifikimit familjar, sherbime ne shtepi per PAK, te moshuar te vetmuar.**
  - **Qendra riaftesimi per PAK, per riintegrimin e grave te dhunuara dhe te trafikuar etj.**

### **Inspektimi**

- Kane filluar procedurat per ngritjen e Inspektoratit te Sherbimeve Shoqerore, i cili ka permiresuar monitorimin dhe zbatimin e standarteve nga ofruesit e sherbimeve shoqerore publike dhe private.
- Fillimisht inspektimi do te kete karakter informues dhe keshillues per njohjen, kuptimin dhe zbatimin e standarteve.
- Me pas inspektimi do te jete i detyrueshem per te gjithë ofruesit e sherbimeve.

#### **Se treti : Trajnimi i Stafit.**

##### **Çfare pritjet ne te ardhmen?**

Do te ngrihet nje sektor per trajnimin e stafeve ne nivele te ndryshem te menaxhimit te sherbimeve si:

- Nenpunesit e administrates civile ne MPÇSSHB e SHSSH qe lidhen me sherbimet shoqerore.
- Punonjesit e administratave te njesive te qeverise vendore qe punojne ne komuna, bashki dhe qarqe.
- Punonjesit aktuale dhe ata te rinj qe punojne ne qendrat e sherbimit shoqeror rezidencial.
- Punonjesit e ofruesve private te sherbimeve dhe punonjesit e OJF-ve.
- Studentet e shkencave shoqerore, qe kerkojne te fitojne dije dhe eksperience praktike.

### **Se katerti : Vleresimi i Politikave dhe Monitorimi i Progresit**

- Vlersimi i politikave kerkon dialog te rregullt dhe ligjor ndermjet MPÇSSHB e institucioneve ne varesi te saj dhe njesive te qeverisjes vendore per grumbullimin e te dhenave, informacioneve.

- **Tregues te detyrueshem statistikor nga MPÇSSHB per te gjitha institucionet ne varesi te tyre.**

- Raportim periodik nga bashkite, komunat ne nivel qarku, ne drejtorite rajonale te Sherbimeve Sociale, ne SHSSH dhe njesine e statistikes ne MPÇSSHB.

- Vleresime dhe raporte periodike te inspektoriatit te sherbimeve sociale
- Analiza periodike dhe raportimi ne instancat eprore.

### **Monitorimi**

#### **1. Komiteti i Nderministror per te drejtat e femijeve**

- **Kryetar:** Zevendes kryeministri
- **Anetaret:** Ministrit qe kane implikim te drejtperdrejte. (duhet te riaktivizohet)

#### **2. Sekretariati Teknik per femijet prane Ministrise se Punes**

**Anetaret:** 2-3 specialist

**Detyrat:** Mbledhja dhe Shperndarja e Informacioni; marredhenie me ministrite e linjes; me OJF-te e femijeve; me 12 rajonet e SSSH, qarqet/bashkite/komunat

#### **3. Specialist per femijet prane Drejtorise se Sherbime Sociale ne Ministri**

#### **4. Anetar ne Keshillin Administrativ i Sherbimit Social Shteteror**

-perfaqesue nga OJF-te qe ofrojne sherbim per femijet

#### **5. Specialiste per femijet ne Sherbimin Sociale Shteteror**

-ne nivel qendror dhe ne 12 rajonet e vendit

#### **6. Ne qark**

-Specilaiste per femijet ne sektorin e sherbimeve shoqerore (ne kater qarqet pilot jane ngritur sektoret )

#### **7. Njesite e Pushtetit Vendor**

-pike kontakti per femijet ne 65 Bashki, 308 Komuna

# **MBROJTJA E SHËNDETIT DHE ZHVILLIMI I FËMIJËVE - PRIORITET PËR SHËNDETËSINË SHQIPTARE**

## **Nedime CEKA**

Specialiste pranë Ministrisë së Shëndetësisë

### **Neni 6.**

#### **Mbijetesa dhe zhvillimi**

**Çdo femije ka te drejte te pamohueshme per te jetuar. Shtetet Pale marrin te gjitha masat e mundshme per te siguruar mbijetesen dhe zhvillimin e femijes.**

### **Neni 24**

1. Shtetet Pale njohin te drejten e femijes per te gezuar nje gjendje shendetesore sa me te mire dhe per te perfituar nga sherbimet per trajtimin e semundjes dhe riaftesimin e shendetit. Shtetet Pale perpiqen te sigurojne qe asnje femije te mos i mohohet e drejta per te pasur keto sherbime te kujdesit shendetesor.

2. Shtetet Pale ndjekin zbatimin e plote te kesaj te drejte dhe ne veçanti marrin masat e duhura: (a) Per te ulur vdekshmerine foshnjore dhe feminare; (b) Per t'u siguruar te gjithë femijeve ndihmen e nevojshme mjekesore dhe kujdesin per shendetin, duke e vene theksin ne zhvillimin e kujdesit shendetesor paresor; (c) Per te luftuar semundjen dhe kequshqyerjen, edhe ne kuadrin e kujdesit shendetesor paresor, me ane te perdorimit, nder te tjera, te teknikave lehtesisht te arritshme si dhe te sigurimit te produkteve ushqimore te pershtatshme dhe ujit te pijshem te paster, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes se mjedisit natyror; (d) Per t'u siguruar nenave kujdesin e duhur shendetesor, para dhe pas lindjes; (e) Per te mundesuar qe gjithë grupet shoqerore dhe ne veçanti prinderit dhe femijet te marrin informacion, te kene mundesi edukimi dhe te perkrahen per te perdorur dijet baze per shendetin dhe te ushqyerit e femijes, perpaesite e ushqyerjes me gji, higjienen dhe shendoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve; (f) Per te zhvilluar kujdesin shendetesor parandalues, keshillimin e prinderve, edukimin dhe sherbimet ne fushen e planifikimit familjar.

3. Shtetet Pale marrin te gjitha masat e efektshme dhe te nevojshme per te zhdukur praktikat tradicionale te demshme per shendetin e femijeve.

### **Principet bazë të mbrojtjes së shëndetit të fëmijëve**

•Mbijetesa dhe mireqenia e nenave dhe femijeve nuk jane te rendesishme vetem te para si e drejte e tyre, por jane njekohesisht thelbesore per zgjidhjen e sfidave te medha ekonomike, shoqerore dhe te zhvillimit.

•Kur nenat dhe femijet vdesin apo semuren, familjet e tyre, komunitetet dhe kombet gjithashtu vuajne. Kur nenat mbijetojne dhe behen me te forta, edhe femijet mbijetojne dhe behen me te forte. Kur nenat dhe femijet mbijetojne dhe behen me te forte edhe shoqerite ku ato jetojne ecin perpara.

- Permiresimi i mbijeteses dhe mireqenies se nenave dhe femijeve nuk çon vetem ne shoqeri me te shendetshme, por edhe ne pakesimin e pabarazive dhe varferise. Eshte vleresuar se per çdo dollar te investuar ne shendetin e femijeve, 7 dollare perfitohen si rrjedhoje e reduktimit te shpenzimeve per mireqenie sociale dhe rritjes se prodhimtarise tek te rinjte dhe te rriturit.

- Kur nje femi eshte i semure apo vdes, si familja ashtu edhe shoqeria vuajne. Semundjet e shpeshta dhe kequshqyerja ndikojne negativisht ne zhvillimin psikologjik, permasat trupore dhe forcen e femijeve. Kjo redukton arritjet finale ne edukim si dhe prodhimtarine dhe kapacitetin ne pune ne nje moshe me te rritur

### Sherbimet e Kujdesit per femijen

- Kujdesi paresor**

**FSHAT**

- ambulancat me personel te mesem mami-infermiere,

- Qendrat shendetesore MF+Mami/Inf

**QYTET**

- Keshillimoret e femijeve qe ndjekin mirerritjen dhe zhvillimin e femijeve 0-6 vjeç,

- Sherbimet per semundjet pediatrike te vendosura prane poliklinikave te lagjeve te qyteteve qe ndjekin femijen e semure deri ne moshen 14 vjeç.

- Kujdesi dytesor:** Ne te gjitha spitalet e rretheve eksistojne pavionet e pediatrikse se pergjitheshme.


- Kujdesi per te porsalindurin**


- Sherbimi neonatologjik spitalor ne vendin tone perfshhet ne 36 rrethe te vendit, ku jane dhe spitalet obstetrikale te kujdesit shendetesor dytesor dhe tretesor.

- Kujdesi tretesor:** Ky sherbim aktualisht ne vendin tone ofrohet nga Spitali pediatrik prane QSUT “Nene Tereza” Tirane.

- Qendra Kombetare per Mirerritjen dhe Zhvillimin e femijeve.** krijuar si e tille me VKM 325 dt.23.06.2000. Ajo u ngrit si nje qender diagnostikuese e trajtuese per problemet e zhvillimit, si nje qender trajnimi dhe si nje vend per kryerje studimesh shkencore ne lidhje me mirerritjen dhe zhvillimin e femijeve

TARGETI	INDIKATORET	VLERESIMI BAZE		2006	2009	2012	2015
		Viti	Vlera				
Obj. Zhvillimit te Mijevçarit							
Pakesimi me 1/2 e vdekshmerise amtare deri ne 2015	Vd.amtare per 100.000 lindje gjalle	2000	22.7	15	14	15	11






95 % e grave kane marre kujdes para lindjes, nga nje personel i afte mjeksor

- Shendeti para shtatzanise, ushqyerja, gjendja sociale dhe ambienti fizik, sjellja dhe mireqenia e nenes percaktojne rritjen dhe zhvillimin e fetusit intrauterin. Koha e shtatzanise, lindjes, ecuria e saj dhe komplikacionet qe mund te lindin sigurisht qe kane pasoja per nenen dhe foshnjen e saj.

- Niveli cilesise se sherbimit antenatal te ofruar nga personeli mjeksor mbetet ende jo ne nivelin e duhur sidomos ne drejtim te keshillimit dhe promocionit e edukimit te gruas shtatzene, familjes dhe te gjithe komunitetit


### Kujdesi ne lindje



7% e lindjeve jane ne shtepi; nga keto lindje ne shtepi rreth 6.2% jane me asistence nga nje personel mjeksor dhe 0.8 % pa asnje asistence mjeksore

## Lindjet e ndodhura ne shtepi


- aksesit dhe cilesia jo e mire te sherbimeve shendetesore,
- mungesat e personelit sidomos mamite ne fshatra, kjo si rrjedhoje e migracionit te brendshem te pakontrolluar,
  - deshiren e vet nenes per te lindur ne shtepi,
  - levizjen e pakontrolluar te popullates e per rrjedhoje nuk ndiqet dot nga mamia e patronazhit te zones,
  - kushtet jo te mira te infrastruktures se materniteteteve dhe shtepive te lindjes ne fshat qe shpesh kane mungesa ne uje, ngrohje dhe ne energji elektrike.



1970	1975	1980	1985	1990	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
97.9	70.4	50.3	30.1	28.3	30	28.8	25	24	17.5	16	17.5	17.2	16	







Verehet nje permiresim i situates se malnutricionit te **formes se rende**; prevalenca e malnutricionit eshte bere pothuajse e ngjashme si ne zonat urbane dhe rurale (kjo ndoshta e lidhur me migracionin e brendshem nga zonat rurale dhe mbipopullimin e zonave urbane). Moshja me e prekur eshte perseri grup moshja 1-2 vjeç (20.1%) qe siç u permend me siper reflekton praktikat jo te mira te fillimit te ushqyerjes solide/usqyerjes plotesuese qe ka lidhje me punen dhe njohurite jo te mira te personelit shendetesor lidhur me keshillimin per ushqyerjen e femijes si dhe me edukimin e nenave per kujdesin per mirerritjen e femijeve.

Ne vitin 1993 nga nje studim i OBSH, UNICEF, ISHP Shqiperia ka rezultuar se ka forme te rende te pamjaftueshmerise jodike ne 63% te femijeve

### Ushqyerja me gji


- Ushqyerja me gji, konsiderohet si nje nga treguesit kryesor te shendetit dhe mirerritjes se femijeve. Ne vendin tone ushqyerja me gji ka qene tradite, por mbas viteve 1990 nga medikalizimi i lindjeve ne maternitete dhe nga nga hapja e vendit drejt ekonomise se tregut filluan te futeshin edhe qumeshtet industriale.

- Ne shtator te vitit 1999, u miratua ligji mbi “Nxitjen e Ushqyerjes me gji”, mbeshtetur mbi Kodin nderkombetar te Marketingut te zevendesuesve te qumeshtit te gjirit. Qellimi i ketij Ligji eshte te kontribuojte per sigurimin e nje ushqimi te sigurte, te pershtatshem dhe te mjaftueshem per femijet, nepermjet mbrojtjes dhe nxitjes se ushqyerjes me gji, si dhe sigurimin e nje perdorimi te drejte te zevendesuesve te qumeshtit te gjirit, kur keta jane te nevojshem, mbi bazen e nje informacioni te pershtatshem dhe nepermjet tregtimit dhe shperndarjes se duhur te tyre.

- Gjendja e ushqyerjes me gji ne vendin tone eshte permiresuar ndjeshem, krahasuar me vitin 1998. Vihet re qarte ndryshimi ne praktika mes qyteteve ku eshte kryer nje nderhyrje, si trajnimi i personelit shendetesor, dhe atyre ku

nuk eshte bere asnje nderhyrje. -Personeli shendetesor eshte ndergjegjesuar per perparesite e ushqyerjes ekskluzive me gji ne gjashte muajt e pare te jetes. Por ende mbetet pune per te bere lidhur me permiresimin e ketij treguesi.

### Shkaqet e vdekjeve te foshnjat (Viti 2003)



- Semundjet e rrugeve te frymemarrjes zene vendin e pare ne vdekjet e femijeve 0-5 vjeç ne vendin tone
- Semundjet diarreike me gjithe reduktimin qe kane pesuar ende mbeten ne grupin e shkaqeve kryesore te vdekjeve ne femijet ne Shqiperi. Ato zinin rreth  $\frac{1}{4}$  te vdeksherise foshnjore ne vitet 1991 dhe 1992, duke u rritur ne 13.3% ne 1994 me tej kjo shifer ka ardhur duke u reduktuar .
- Shkaqet jane te lidhura kryesisht me kushtet jo te mira te jeteses dhe higjienes, mungesen e aksesit ndaj sherbimeve shendetesore, njohuri jo te mira te personelit shendetesor lidhur me ndjekjen dhe trajtimin e semundjeve kryesore te femijerise, dhe nivelin jo te mire te edukates dhe njohurive te nenes, familjes dhe komunitetit veçanerisht ne drejtim te mirerritjes, ushqyerjes se femijes dhe kujdesit per shendetin e femijes

### Imunizimi

Shqiperia ka nje skeme vaksinimi te detyrueshem kunder semundjeve kryesore te femijerise te parandalueshme me vaksinat: (Difteria, Tetanozi, Pertusi, TBC, Polio, Fruthi, dhe rubeola, hepatiti B). mbulesa vaksinale per keto semundje eshte e larte mbi 95% te femijeve. Ne vitet qe pasojne skemes se vaksinimit do ti shtohet edhe vaksinimi kunder Shytaes dhe Hemofilus influenzae e cila mbron moshat e femijeve te vegjel kunder semundjes se meningitit qe shkakton nje vdekshmeri te larte tek keto grup moshë. Ne vitin 2002 Shqiperia u çertifikuua nga OBSH si vend pa poliomielit dhe eshte duke zhdukur fruthin (gjate vitit 2002 dhe ne vitin ne vazhdim nuk eshte raportuar asnje rast).

Shqipëria tashme ka një Plan Kombëtar Veprimi për Imunizimin dhe qeveria shqiptare është pjesë e partneritetit me Aleancën globale të Vaksinave dhe Imunizimit (GAVI) e angazhuar për të siguruar vaksinat për fëmijet. Aktualisht buxheti për blerjen e vaksinave të kalendarit të detyrueshëm mbulohet nga shteti .

### **Problemet / Pengesat**

- **Situata aktuale e vendit:**

- **Tranzicioni ekonomik** social i vendit solli edhe ndryshime në gjendjen shëndetsore të popullatës dhe veçanërisht të grupeve të vulnerabël si gratë dhe fëmijet.

- **Varferia**

Simbas anketimit të matjes së nivelit të jetesës LSMS të vitit 2002 INSTAT rezultoi se 25.4 % e popullsisë shqiptare është e varfër dhe 5% e saj jeton në varfëri ekstreme.

Zonat më të varfëra janë ato verilindore, malore zona të tjera larg qendrave urbane.

- **Migracioni i brendshëm**

Një numër i madh personeli shëndetësor (veçanërisht infermiere/mami, mjek të përgjithshëm) që ka migruar nga zonat e thella, zonat verilindore dhe janë vendosur në zonat suburbane dhe urbane kryesisht të Shqipërisë Qendrore. Kjo ka bërë që në zonat e migruara të mos ketë me asnjë staf kujdesi shëndetësor.

- **A. Probleme në cilësinë dhe aksesin e shërbimeve**

Aftësitë dhe njohuritë jo të mira teknike në nivelin bashkë-kohor të personelit shëndetësor që punon në shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijën lidhur me konceptet e reja të kujdesit për shëndetin e mirërritjen e zhvillimit të fëmijës dhe për të kryer aktivitetet e kerkuara sipas standarteve të OBSH lidhur me kujdesin dhe fëmijën.

Kushtet e vështira të punës, motivimi i ulët financiar veçanërisht i personelit që punon në sistemin e kujdesit shëndetësor për të.

Mungesa në medikamentet dhe pajisjet dhe burime tjera; si dhe në disa raste medikamentet përdoren në mënyrë të papërshtatshme e jo efektive.

Ka mungesa në pajisje baze për keshillimet e fëmijës, personel të mesëm mami-infermiere dhe mjek pediater e neo-natolog në këto shërbime.

- **B. Probleme në Administrim/ Monitorim/ Supervizion**

Organizimi i shërbimeve, lidhjet funksionale ndërmjet QSH dhe sistemeve të referencës janë të pakënaqshme (mungesa e kapacitetit komunikues p.sh telefonit, ambulancës, mungesa e protokolleve për referimet).

- **C. Probleme me Sistemin e Informacionit**

- **D. Probleme me informim, edukim, komunikimin shëndetësor**

Mungesa e një trajnimit të thellë të personelit mjek, mami, infermiere dhe profesioniste të tjera shëndetsore në metoda-logjine të edukimit shëndetësor

dhe promovimit të shëndetit, si dhe në teknikat e këshillimit për të ndihmuar individët në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe shëndetit të tyre riprodhues.

### **Strategjia sistemit shëndetësor shqiptar**

- **Reformimi në fushën e prodhimit të shërbimeve**

– Pjesë e kësaj reforme janë edhe përmirësimi i shërbimeve të shëndetit të nënës dhe fëmijës në këto drejtime:

1. Përmirësimin dhe integrimin e strukturave të shërbimit shëndetësor të gruas dhe fëmijës në të tre nivelet e kujdesit.
2. Përmirësimin e cilësive të shërbimeve të nënës dhe fëmijës në të tre nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të protokolleve standarte për ndjekjen e shëndetit të gruas dhe fëmijës
3. Ngritjen e nivelit teknik të personelit shëndetësor, nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të gjithë stafit shëndetësor që punon në këto shërbime
4. Plotësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e shëndetit të gruas dhe fëmijëve.
5. Integrimin dhe koordinimin e aktiviteteve me strukturat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, donatorët, etj.

### **Ndërhyrjet për zgjidhje**

- **A. Organizimi i shërbimeve**

- Rajonalizimi i shërbimeve obstetrikale dhe perinatale duke përcaktuar nivelet e shërbimit, numrin dhe tipin e institucioneve shëndetësore si dhe të aktiviteteve që do të implementohen në çdo nivel kujdesit .

- **B. Vazhdimësia e kujdesit**

- Integrimi i kujdesit antenatal me kujdesin obstetrikal dhe perinatal baze
- Përdorimi i protokolleve të ndjekjes dhe mjekimit si dhe të dokumentacionit të unifikuar do të lehtësojë vazhdimësinë e kujdesit

- **C Trajnimet dhe detyrat**

- Të sigurohet trajnimi praktik periodik mbi njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të kryer detyrat e caktuara me cilësi të nevojshme
  - Trajnime specifike për mamitë duhet të përfshijnë kujdesin për lindjen normale (si dhe kujdesin obstetrikal baze, (parandalimin e menaxhimin dhe diagnozën e infeksioneve, hipertensionin në shtatzani, lindjen distocike), kujdesin për të porsalindurin, për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

- **D Cilësia e kujdesit amtar dhe neonatal, femitor**

- përgatitja e udhëzuesve standarte për kujdesin obstetrikal dhe perinatal;
- unifikimi i dokumentacionit për ndjekjen e të porsalindurit dhe të gruas shtatzene: të cilat do të ndikojnë në :
  - përmirësimin e përmbajtjes së vizitave para lindjes
  - përdorimin e praktikave të lindjeve të sigurta dhe të pastra
  - përmirësimin e kujdesit neonatal baze dhe praktikave reanimuese .

- **Zgjerimi i strategjise se MISF** - per reduktimin e semundshmerise dhe vdekshmerise foshnjore dhe feminare
- **Trajnimi i personelit KSHP** per ushqyerjen e femijes, kequshqyerjen dhe mungesat ne vitamina e mikronutriente, ndjekjen e rregullt dhe periodike te zhvillimit te femijes
- **Mjetet dhe paisjet**
  - te sigurohen mjetet dhe paisjet sipas .listave standarte te OBSH
  - permiresimi i perdorimit te medikamenteve
- **Sistemi i raportimit rutine**
  - vendosja e nje sistemi raportimi rutine te indikatoreve kryesor qe lidhen me shendetin dhe zhvillimin e femijes
  - analiza e problemeve te shendetit amtar, perinatal, foshnjore
- **Promovimi dhe edukimi** i nje menyre ushqyerje dhe jetese te shendeteshme ne familje dhe komunitet, dhe sidomos nxitjen e ushqyerjes me gji per dy vitet e para te jetes dhe dhenien e shtesave me mikronutriente e vitamina kur eshte e nevojshme.

#### **E. Permiresimi i legjislacionit ne mbrojtje te shendetit te femijeve**

- **Eshte ne proces perpunimi i Kartes se te drejtave te femijeve ne spital me qellim qe t'u garantohen femijeve te shtruar ne spital te drejtat e tyre per te jetuar, per t'u zhvilluar, per te qene te mbrojtur dhe per te qene pjese e procesit pa dallim dhe nenvleresim.**

# ARSIM CILESOR DHE MASIV PER TE GARANTUAR ZHVILLIMIN BASHKEKOHOR TE FEMIJEVE

**As. Prof. Dr. Pranvera KAMANI**

Specialiste pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Shoqëria shqiptare është në një proces shndërrimesh të rëndësishme ekonomike, sociale, politike dhe kulturore të cilat e përballin shkollën dhe gjithë sistemin arsimor me sfida të vazhdueshme. Në këtë periudhë, sistemi arsimor ka pësuar ndryshime të rëndësishme në strukture dhe përmbajtje për të reflektuar me mirë nevojat e ndërtimit të një ekonomie moderne. Rezultate të këtij ndryshimi janë mundësi më të mëdha për fëmijet për të ndjekur shkollën të ndryshme, publike dhe private, në përputhje me nevojat e tregut dhe perzgjedhjet personale.

Pas viteve 2000 evidentohen tregues të konsoliduar të arsimit. Në vitin 2004, braktisja e shkollës ka qenë 1,2%, tregues ky që ka ardhur vazhdimisht në ulje. Aktualisht në sistemin e arsimit parauniversitar 45% e fëmijëve 3-5 vjeçarë ndjekin institucionet parashkollore ose 10% më shumë se në vitin 1996, në arsimin e detyruar vijojnë shkollën 98% e fëmijëve të grupmoshës 6-14 vjeç; në arsimin e mesëm janë regjistruar rreth 77% e nxënësve që mbarojnë arsimin e detyruar. Rreth 65 % e nxënësve zhvillojnë mesimin në shkollën të rikonstruuar. Të gjithë këta tregues përkojnë apo më mirë të themi që kapërcejnë objektivat e mileniumit për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve.

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe në veçanti e fëmijëve përbënë parimin themelor mbi të cilin ngrihet strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar për vitet 2004-2015. **Reformimi i sistemit parauniversitar synon riorganizimin dhe modernizimin e sistemit të shkollimit në përputhje me: zhvillimin ekonomik të vendit, krijimin e hapësirave demokratike të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe hapjen e rrugës për integrimin e arsimit tonë në Europë.**

Në këtë kuader orientohej politika dhe strategjia e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve në arsim. Drejtimet kryesore ku do të përqendrohet veprimi i të gjitha institucioneve arsimore, në të ardhmen, për të siguruar një nivel të lartë të edukimit, përvetësimit dhe zbatimit të të drejtave të fëmijëve janë:

**Sistem arsimor cilesor**

**Studimi i të drejtave të fëmijës në kurrikulin shkollor**

**Sigurimi i informacionit të detajuar për arsimin.**

**Perfshirja e fëmijëve në vendimarrje**

**Sistem arsimor cilesor**

Realizimi i këtij objektiwi kërkon në radhë të parë reformimin e sistemit arsimor, rishikimin e kurrikules dhe modernizimin e procesit mesimor që të sigurojë: **një formim bashkëkohor dhe integruar të nxënësve; perfshirjen e të gjithë nxënësve në arsimin e detyruar; rritjen në 80% të nxënësve në arsimin e mesëm; rritjen e numrit të fëmijëve parashkollor në kopshte.**

Strategjite qe do te udheheqin realizimin e nje sistemi arsimit cilesor jane:

- \* Rritja e nivelit te arsimit te detyruar ne 9 vjet, sipas skemes 5 + 4 + 3. Zbatimi i kesaj strukture afron sistemin arsimit shqiptar me ate te shumices se vendeve te tjera te Ballkanit, te BE dhe te vendeve te OECD.
- \* Permiresimi dhe konsolidimi i sistemit arsimit publik cilesor dhe falas ne nivelet e parashkollorit, arsimit te detyruar dhe te mesem si dhe shtimi i alternativave private te arsimit ne te gjitha nivelet.
- \* Hartim i kurrikules se re te arsimit te detyruar 9-vjeçare. Sot ndihet nevoja e konceptimit dhe zhvillimit te nje modeli kurrikular te orientuar nga kerkesa dhe te fokusuar ne fitimin e njohurive dhe aftesive te nevojshme ne menyre qe femijet te ndjehen dhe te veprojne si qytetare aktive te nje shoqerie demokratike ne ndryshim qe respekton te drejtat e njeriut dhe bazohet ne ekonomine e tregut. Realizimi i kesaj kerkese dikton kalimin nga metoda ekzistuese me baze lendesh, ne ate qe bazohet ne rezultatet e nxenes te cilat orientojne ne opsione per lende te reja dhe siguron integrimin e lendeve mesimore. Keto jane elemente qe sjellin nje risi te konsiderueshme ne kurrikulin e arsimit shqiptar.
- \* Modernizimi i procesit te mesimdhenies dhe mesimnxenes. Reforma kurrikulare qe eshte ne proces po trajton me perparesi aspektin cilesor te mesimnxenes ne raport me ate sasi duke synuar t'u siguroje nxenesve me shume kohe, te kultivoje te ata shprehite eksperimentuese, te rrishte ambicjen per kerkim e te zhvilloje operacionet mendore te analizave dhe sintezave gjate procesit mesimor.
- \* Zgjedhja e lendeve nga nxenesit dhe kurrikula gjithperfishirese. Zhvillimet e brendshme dhe kerkesa e afrimit me komunitetin europian diktojne nevojat per rritjen e fleksibilitetit ne hartimin e kurrikules, ne menyre qe shkollat ose niveli lokal ta pershtasin ate, ne masen qe u lihet ne dispozicion, me nevojat dhe kerkesat e zhvillimit lokal, perspektiv ose te tradites. Politikate qe udheheqin perdorimin e lendeve me zgjedhje dhe te grup-lendeve, i sherbejne forcimit te ketij fleksibiliteti. Perfshirja e femijeve me nevoja te veçanta (veçanerisht handikapet) ne arsimin publik do te nise qe ne arsimin parashkollor, duke promovuar zhvillimin e politikave qe mbeshtesin aksesin e barabarte ne arsim.
- \* Sigurimi dhe pasurimi i bazes materiale didaktike dhe laboratorike, ne te gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, per te nxitur dhe rritur shkallen e kerkimit, efektivitetin e pervesimit te kurrikules se re arsimore. Arritjet e dertanishme qe numerojne rreth 510 laboratore fizike, kimie dhe biologjie si dhe 70 laboratore te informatikes se shperndare ne shkollat e mesme dhe 9-vjeçare te zones urbane do te shtrihen ne vitet ne vijim edhe ne shkollat e arsimit te detyruar dhe te mesem te zones rurale.
- \* Konsolidimi i sherbimit psikologjik dhe shtrirja e tij ne te gjitha kopshtet dhe shkollat e vendit ne ndihme te promovimit dhe zhvillimit mendor e fizik te nxenesve si dhe rritjes se cilesise se procesit te mesimnxenes dhe mesimdhenies.
- \* Permiresimi i kurrikulit te universitetve te mesuesise.
- \* Zhvillimi i profesionit te mesuesit nepermjet krijimit te agjensive per zhvillimin e profesionit te mesuesit, rishikimin e kurrikules se trajnimit te mesuesve ne detyre dhe trajnimin per ngritjen profesionale te mesuesve.

- \* Sigurimi i nje rrjetit funksional dhe cilesore te institucioneve arsimore ne te gjitha vendin, ne veçanti per zonat e thella rurale, nepermjet perqendrimit te shkollave.
- \* Sigurimi ne vijimesi i teksteve falas ne arsimin e deytruar, per te siguruar aksesin e duhur ne arsim te gjitha shtresave te popullsisë pavaresisht gjinise, etnise, fese etj.
- \* Shperndarja e teksteve falas, ne arsimin e mesem, ne disa komuna te varfëra te vendit per te rritur aksesin e nxënësve ne kete nivel shkollimi.
- \* Forcimi i kapaciteteve monitoruese dhe vleresuese, te brendeshme dhe te jashtme te arsimit nepermjet rritjes se efiçences se QKAVP.

### **Studimi i te drejtave te femijes ne kurrikulin shkollor**

E drejta e njeriut per arsim eshte ne menyre te pazgjidhshme e lidhur me te drejtat e tjera themelore te njeriut, te drejta qe jane universale, te pandara, te nderlidhura dhe te ndervaruara ku perfshihen:

- \* E drejta e barazise midis burrit dhe gruas dhe kontributit te njejte qe duhet te japin ne familje dhe shoqeri.
- \* E drejta e njeriut per pune dhe shperblim qe i siguron nje standarde te pershtatshem jetese.
- \* E drejta e njeriut per lirine e mendimit, besimit dhe feseE drejta e njeriut per te patur nje standarde te pershtatshem jetese.
- \* E drejta e njeriut te marri pjese ne marrjen e vendimeve dhe politikave qe ndikojne jeten e tij ne nivel komunitar, lokal, kombetar dhe nderkombetar.

Ne kete fokus, studimi i te drejtave te femijes ne kurrikulin shkollor synon te siguroje njohjen dhe përvetësimin e te drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore te femijeve te paraqitura ne Konventen e Kombeve te Bashkuara duke i perfshire keto ne te gjitha veprimtarite e shkolles.

Ne vitet e fundit, ne kuadrin e permiresimit te kurrikules se lendeve se edukates qytetare si dhe lendeve te tjera, jane trajtuar elemente te rendesishme te mbrojtjes dhe promovimit te te drejtave te femijeve. Zhvillimi i projekteve te ndryshme me OJF qe veprojne ne kete fushe, kane ndikuar ne rritjen e njohurive teorike dhe praktike te nxënësve dhe mesuesve per promovimin dhe mbrojtjen e te drejtave te femijeve. Hartimi i kornizes se re kurrikulare per arsimin parauniversitar ka krijuar hapesira te reja te trajtimit te te drejtave te femijeve si ne kurrikulen e lendeve te veçanta ashtu edhe ne trajtimin kroskurrikular dhe ekstrakurrikular te tyre.

MASH konsideron realizimin e te drejtave te femijeve ne shkolle me shume se zbatimin e nje kurrikule te re, ajo konsideron si praktike e funksionimit te shkolles dhe marredhenieve midis aktoreve te saj, nxënës, mesues, komunitet. Ky koncept i rendesishem dhe bazal ne transformimin e jetes se shkolles sone do te thote:

- \* te edukoj nxënës me besim ne vete dhe pergjegjes per ate qe ndodh ne klase dhe jashte saj;
- \* te nxisi nxënësit te luajne nje rol te dobishem ne jeten e shkolles, komunitetit, vendit dhe me gjere;
- \* t'i pajisi nxënësit me njohuri per zhvillimin ekonomik te vendit, per ngritjen dhe funksionimin e institucioneve demokratike;
- \* t'i edukoj nxënësit me vlere te qendrueshme;
- \* te nxisesi dhe te edukoj respektin ndaj identiteti kombetar, fetar, etnik;



- \* te edukoj nxenesit me aftesine e te menduarit kritik, me frymen e debatit konsatrktiv, tolerances dhe pranimit te te menduarit ndryshe.

### **Sigurimi i informacionit te detajuar per arsimin.**

Informim efektiv nepermjet konsolidimit te sistemit te menaxhimit te informacionit ne sektorin e arsimit (EMIS) synon: sigurimin e nje sistemi te detajuar te informacionit (sipas moshes dhe seksit), te besueshem dhe krahasues qe do te mundesoje identifikimin e nivelit te arsimit dhe edukimit te femijeve, si dhe problemeve te ndryshme social-ekonomike te femijeve. **Mbi kete baze te dhenash do te orientohen nderhyrjet politike ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijeve per t'u siguruar nje sherbim arsimor cilesor pavaresisht perkatesise etnike, fetare, gjendjes shoqerore, shendetsore etj.** Ngritja dhe forcimi i sistemit EMIS, i mbeshtetur nga Banka Boterore, ka nje rol te dyfishte: krijimin e database nepermjet sistemit kompjuterik; sigurimi i kerkimit konceptual dhe investigimi analitik i te dhenave, per qellime studimore.

Sistemi EMIS nuk nenkupton vetem sistemin kompjuterik, por kerkimin konceptual dhe investigimin analitik te te dhenave per qellime studimore. Sistemi duhet te fuqizoje kapacitetin per te kategorizuar te dhenat ekonomike, infrastruktorore, sociale (duke perfshire grupet e minoritetit) dhe arsimore sipas niveleve: rural, urban dhe qendror, qarku, bashkie/komune, deri ne nivel shkolle.

Nje nder qellimet e ngritjes se ketij sistemi eshte dhe shperndarja e informacionit ne organizata te ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare, ne medjan elektronike dhe te shkruar me qellim qe te sensibilizoje opinionin kombetar dhe nderkombetar per probleme qe kerkojne zgjidhje emergjente si dhe te siguroje partneritet ne veprimet qe duhen te ndermeren ne nivele nderministrore per mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te femijeve.

### **Perfshirja e femijeve ne vendimarrje**

Synon te siguroje pjesemarrjen efektive dhe te pergjegjshme te femijeve ne vendimarrje ne perputhje me aftesite e tyre, ne te gjitha nivelet e arsimit ne klase, shkolle, ne nivel lokal dhe qendror.

**Plotesimi i Dizpozitive Normative te Shkolles qe do te sanksionojne realizimin e te drejtes se femijeve per t'u bere pjese e vendimarrjes per problemet qe lidhen me procesin mesimor, veprimtarite brenda dhe jashte shkolles, si edhe percaktimi i instrumenteve dhe modaliteteve qe do te bejne efektive kete pjesemarrje ne:**

- \* Informimin dhe marrjen e vendimeve se bashku me trupin pedagogjik
- \* Marrjen e pergjegjesive ndaj vehtes, shkolles, familjes dhe komunitetit
- \* Zbatimi i formave te delegimit dhe perfaqesimit te nxenesve
- \* Pjesemarrje aktive ne bordet drejtuese te shkolles
- \* Zhvillimi i programeve dhe projekteve ne nivel shkolle, rajoni dhe me gjere qe do te pergatisin femijet per t'u integruar ne jeten e shoqerise demokratike, t'i aftesoje te ushtrojne te drejtat dhe pergjegjesite e qytetarit, t'i inciojne ne jeten politike dhe ekonomike te vendit nepermjet konsolidimit te praktikave te funksionimit te Qeverise se Nxenesve dhe Parlamentit Rinor.

Ne perfundim dua ta mbyll thjeshte duke u perpjekur te shpjegoje se çfare do te thote “te drejtat e femijeve”. Ndodh qe shpesh here njerezit duke u perpjekur te shpjegojne te “drejtat’ i ngaterrojne ato here me deshirat dhe here me nevojat. Ka gjera qe ne vertet desherojm ti kemi apo desherojme t’i bejme per femijet tane si t’u blejme lodra apo t’u sigurojme udhetime argetuese etj. Keto mund te duken si nevoje per femijet por nuk jane te tilla pasi ata mund te jetojne edhe pa to.

Nevojat jane ato gjera qe femijet duhet t’i kene apo qe duhet t’i bejne qe te kene nje jete te mire. Qe te kene nje jete te shendetshme ata duhet te kene ushqim, uje, vende per te jetuar dhe te rrethohen nga njerez qe kujdesen per ta. Te jene ne gjendje te zbulojne talentet e tyre, te kene shansin te mesojne, te luajne dhe te perjetojne pervoja te reja. Te jene te mbrojtur dhe te sigurte. Te jene pjese e komunitetit, te kene te drejten e fjales dhe te degjohen.

Te drejtat jane si nevojat. Ato jane bazale per jeten e femijes. Njerezit duhet te sigurojne realizimin e nevojave themelore te femijes. Por eshte Qeveria qe ka pergjegjesine kryesore te siguroje realizimin dhe respektimin e te drejtave te tyre.

Gjate ketyre 15 vjeteve ne kemi hedhur hapa te cilat deshmojne per vullnetin dhe deshiren e mire qe kemi per te hedhur themelet e sigurte te sistemit te mbrojtjes dhe promovimit te te drejtave te femijeve ne vendin tone.

## FEMIJET NE INSTITUCIONE

### Elda KALAJA

Kordinatore Kombetare e Aleances per Femijet

Para periudhes tranzitore Shqiperia konsiderohej si nje vend me nivel te ulet te braktisjes dhe neglizimit te femijeve. Ndryshimet ekonomike dhe sociale te tranzicionit pas viteve 90 kane rritur ne menyre te ndieshme femijet ne risk. duke rritur numrin e femijeve te cilet abandonohen, neglizhohen apo abuzohen nga prinderit. Funksonimi i mbeshtetjes se femijeve jetime apo te neglizhuar, brenda rrethit familiar (gjysher apo te aferm) absorbon nje numer te madh femijesh te kesaj kategorie. Deri ne fillim te viteve 90, pjesa e madhe e femijeve ne institucionet publike te perkujdesit social ishin jetime biologike, ndersa sot jetimet sociale perbejne edhe kontigjentin me te madh te femijeve te cilet mbeshtetn nga strukturat formale te perkujdesit social.

Gjate 10-15 viteve te fundit nje numer nderhyrjesh kane permiresuar sherbimet dhe cilesine e jetes brenda institucioneve residenciale publike per femijet jashte kujdesit prinderor. Gjithashtu ngritja dhe funksionimi i nje numri institucionesh residenciale te drejtuara nga OJQ si edhe zhvillimi i formave alternative te perkujdesjes (si biresimi, restorimi i lidhjeve femije-prinder dhe rikthimi i femijeve ne familjen biologjike, kujdestaria foster apo perkujdesja ne shtepite familje) tregojne per nje tendence positive ne drejtim te zhvillimit te sistemit te perkujdesit social.

Pavarësisht nga ndryshimet politike, programi social është zhvilluar në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria dhe Parlamenti shqiptar si edhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve. Nisur nga ky fakt, megjithëse elementë të politikës sociale të së kaluarës janë ruajtur, mund të konfirmohet se politika sociale e pas viteve 90 është tërësisht e reformuar, në përputhje të plotë me programin e transformimit ekonomiko-social të Shqipërisë.

Sipas te dhenave te Sherbimit Social Shteteror, ne vitin 2004, ne Shqiperi llogariten 1,198 femije jashte kujdesit prinderor te cilet i perkasin sistemit formal, qe do te thote se ato rriten sipas njerit prej modeleve te mesiperme. Nga keto jane rreth 448 femije te strehuar ne institucionet rezidenciale publike (shtepite e femijve 0-3 vjec, 3-6 vjec, 6-14 vjec, qendrat rezidenciale te zhvillimit), ndersa pjesa tjeter trajtohen ne institucione te vogla rezidenciale apo ditore te drejtuara nga OJF-te (581 femije), shtepi-familje (169 femije) dhe 54 femije jane vendosur ne familje nepermjet biresimit.

Gjate dekaodes se fundit, format e perkujdesjes ndaj femijeve jashte kujdesit prinderor kane ndryshuar ne menyre te dukshme. Strukturat e kujdesit social publike dhe jopublike kane zhvilluar forma te ndryshme, bashkekohore sherbimesh kujdesi, qe nga institucionet residenciale deri tek kujdestaria. Por, megjithe progresin e deritanishem, ato jane te pamjaftueshme per te adresuar numrin ne rritje te femijeve jashte kujdesit prinderor. Ne shume nga institucionet apo format alternative te sherbimeve, cilesia e tyre eshte nen standartet qe sigurojne nje minimum te domosdoshem te zhvillimit te femijeve. Ne disa institucione, femijet (me aftesi te kufizuara) nuk marrin sherbime te pershtateshme per zhvillimin e tyre te vecante fizik apo mendor.

Sistemi Informal	Sistemi formal	
	Sistemi formal publik	Sistemi formal i menaxhuar nga OJQ
▼ <ul style="list-style-type: none"> <li>Perkujdesja e gjysherve apo te afermeve (rreth 16,000 femije)</li> <li>Biresime (54 femije te biresuar gjate vitit 2004 dhe rreth 1,000 femije te biresuar qe nga 1994)</li> </ul>	▼ <ul style="list-style-type: none"> <li>Institucionet nacionale residenciale (350 femije)               <ul style="list-style-type: none"> <li>Shtepite e femijeve 0-3 vjec</li> <li>Shtepie e femijeve 3-6 vjec</li> <li>Shtepite e femijeve 6-14 vjec</li> </ul> </li> <li>Qendrat Rezidenciale te Zhvillimit (98 femije)</li> </ul>	▼ <ul style="list-style-type: none"> <li>Institucionet residenciale (401 femije)</li> <li>Shtepite Familje (169 femije)</li> <li>Kujdestari</li> <li>Qendra ditore per femije me probleme sociale (180 femije)</li> <li>Rikthim ne familje te femijeve te larguar jashte Shqiperise te pashoqeruar nga prinderit</li> </ul>

Sherbimet e deritanishme nuk i japin pergjigje disa kerkesave jetesore te femijeve jashte kujdesit prinderor sic jane; strehimi, punesimi, arsimimi etj. Nje pjese e konsiderueshme e sherbimeve publike per kete kategori femijesh jane te centralizuara nga pikpamja financiare dhe manaxheriale. Ne me te shumten e rasteve, jane te neglizhuara parimet e interesit me te mire te femijes, ai i mos-diskriminimit, e drejta e mbijeteses dhe e zhvillimit, e drejta per te marre pjese aktive ne vendimet qe lidhen me te ardhmen e tij, per tu integruar ne shoqeri dhe per tu zhvilluar ne perputhje me potencialet qe zoteron.

Kuadri ligjor qe lidhet me mbrojtjen e te drejtave te femijëve ne institucione ne Shqipëri mund të konsiderohet relativisht i plotë dhe bashkëkohor. **Ligji i organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore Nr. 8652 datë 31.07.2000** krijon kushtet e nevojshme për decentralizimin e shërbimeve shoqërore. Megjithatë, duhet të nënvizohet se decentralizimi financiar ende nuk mund të realizohet në çdo njësi të pushtetit vendor, sepse burimet vendore të sigurimit të financimit janë të kufizuara.

Mbeshtetja e femijeve jashte kujdesit prinderor me institucione residenciale eshte forma me perhapur. Ajo perben nje risk per te ardhmen e femijeve nen kujdesin e kesaj alternative. Femijeve qe rriten ne institucionet residenciale, (publike apo te drejtuara nga OJQ) u mohohet e drejta per te patur nje familje dhe ata vuajne pasojat e institucionalizimit te cilat manifestohen me probleme te zhvillimit te femijes, nivel i ulet i vete-vleresimit, mbarevatje e dobet ne shkolle dhe mundesi te pakta per te qene i pavarur pas adoleshences. Abuzimi i femijeve fillon me abandonimin nga prinderit dhe perfundon me vendosjen e tyre ne boten e mbyllur te jetes institucionale. Perpjekjet e pamjaftueshme, e here te neglizhuara, per t'i ri-kthyer femijen ne familjen biologjike, problemet ne procesin e biresimit (keq-interpretimi i termit «moskujdes i dukshem»), zhvillimi ende i brishte i perkujdesit alternativ,

ineficienta e programeve që mbeshtesin familjet e varfëra apo mungesa e shërbimeve sociale me baze komunitare, e privon këto kategori femijesh ndaj një të ardhmeje positive.

Institucionet rezidenciale duken më shumë si institucione mbajtëse (ushqim, fjetje dhe kujdes shëndetësor) sesa institucione zhvillimi psikosocial.

Cilësia e shërbimeve është e ulët. Shërbimet sociale të realizuara në institucione rezidenciale zënë peshën specifike më të madhe në totalin e shërbimeve. Ky tipar nuk i përshtatet kërkesave bashkëkohore për trajtim dhe integrim social. Vazhdimi në traditën e institucioneve rezidenciale nuk lidhet vetëm me varfërinë ekonomike të vendit, por edhe me dobësitë në formimin profesional të personelit të shërbimit në institucione.

Këshillimi, ndërmjetsimi, përdorimi i psikologjisë dhe punës sociale si mjete që ndihmojnë fëmijën të kapërcejë krizën dhe të ri-integrohet në shoqëri, njihen pak nga personelit e shërbimit në institucionet rezidenciale dhe aplikohen akoma më pak.

Institucionet rezidenciale nuk bëjnë përpjekjet e duhura për kthimin e fëmijëve në familjen biologjike, ose në krijimin e kushteve për biresim që në fazën e parë të braktisjes apo neglizhimit nga familja biologjike. Në shumë raste, mungesa e kriterëve të qarta e kuptueshme çon në interpretime të gabuara e me pasoje në të ardhmen e fëmijës.

Në Kodin e Familjes parashikohet se fëmijë do të konsiderohet i braktisur në rast se « kur prindërit e tij, në mënyrë të dukshme, nuk janë interesuar për të gjatë një viti, përpara paraqitjes së kërkesës për deklarin e braktisjes...

*Konsiderohen në mënyrë të dukshme të painteresuar për fëmijën prindërit që vullnetarisht nuk kanë mbajtur marrëdhënie të përzemërta të nevojshme për rritjen e tij ....»*

Është shumë e vështirë të përcaktohet se çfarë konsiderohet interesim i dukshëm për fëmijet: a mund të konsiderohet që një telefonatë apo një takim në vit interes i dukshëm për fëmijet?

Kjo sjellje vonesa që të deklarohet fëmija i braktisur dhe të fillojnë procedurat e biresimit që në shumicën e rasteve. Kjo ka çuar që të rritet moshën mesatare në institucione dhe ulje të rasteve të biresimit.

Sa i përket formës së shërbimeve, sistemi i ri do të synojë të transformojë qendrat rezidenciale nga qendra të mbyllura në qendra të hapura e bashkëkohore. Sistemi do të ofrojë forma alternative: paralelisht me formën rezidenciale (e cila do të jetë e përkohshme) do të zhvillohet edhe ofrimi i shërbimeve sociale në komunitet apo familje (rëndësia e kësaj forme do të rritet gradualisht).

Numri i biresimeve do të ishte më i madh nëse në legjislacionin aktual eliminohen probleme/keqinterpretime ligjore lidhur me aktin e braktisjes, të cilat pengojnë apo vonojnë biresimin, për një numër të madh femijesh në institucionet rezidenciale.

Megjithatë është hartuar strategjia për de-institucionalizimin e fëmijëve, është rritur numri i institucioneve rezidenciale jo-publike.

Pamvaresisht përmiresimeve në disa aspekte të vecanta të jetës në institucionet rezidenciale (si përmiresimi i kushteve të jetesës, përmiresimi i cilësive dhe shumëllojshmërisë së ushqimit, përmiresimi i sjelljes së stafëve të institucioneve), forma e perkujdesjes në thelb nuk ka ndryshuar, ajo vazhdon të ketë efekt negativ në zhvillimin psiko-social të fëmijëve dhe të kompromentojë

te ardhmen e tyre. Shume faktore kane kontribuar ne mbajtjen dhe rritjen e numrit te institucioneve residenciale.

Perkujdesja institucionale eshte e kushtueshme ndersa strukturat aktuale te perkujdesit social per femije te drejtura nga OJQ, funksionojne per aq kohe sa edhe kohezgjatja e projektit apo financimi i donatoreve. Po te mund te orientoheshin, shpenzimet per mbajtjen e institucioneve residenciale, ne forme me efektive drejt perkujdesit alternativ jo rezidencial, do tu ofrohej mbeshtetje dhe e ardhme nje numri me te madh femijesh ne nevoje.

### Rekomandimet

Familja eshte edhe ambienti me i mire per mbrojtjen dhe mirerritjen e femijes. Ne konventen e mbrojtjes se drejtave te femijeve deklarohet se Familja eshte e kujdestari kryesor i femijes dhe ky interes me i mire i femijes duhet te merret ne konsiderate. Kur nje femije ne menyre te perhereshme apo te perkoheshme eshte i de-privuar nga perkujdesi i familjes se origjines, forma alternative perfshire biresimin apo kujdestarine foster duhet te perdoren ne rast se jane te nevojshme per perkujdesin per femijen ».

Legjislacioni ne lidhje me standartet e shërbimeve është jo i plotë. Këtu nuk përfshihen vetëm shërbimet që ofrohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, por çdo shërbim, përfitues i të cilit është fëmija. Në këtë kuadër, vëmëndje e posaçme duhet ti kushtohet “ **Procedurave të birësimit brenda dhe jashtë vendit**” si edhe “**kujdestaria e ofruar nga familje kujdestare**”, e drejta e kujdestarisë dhe e drejta e marrjes së vendimit mbi kujdestarinë. Element i një rëndësie të veçantë konsiderohet procedura e **mb ikqyrjes së cilësisë së shërbimeve** dhe respektimit të **standarteve të miratuara**.

Respektimi i konventes se te drejtave te femijeve kerkon qe ne Shqiperi ne sistemin e perkujdesjes sociale per femijet, nderhyrjet te prevenojne hyrjen e femijeve ne sistem ose te mundesojne/ndihmojne daljen sa me shpejt. Me qellim qe te arrihet ky synim nje numer veprimesh afatshkurtera e afatgjata jane te nevojshme :

Kujdestaria Foster, gjithashtu tregoi se ka kosto te ulet dhe se mund te zhvillohet me sukses si mjet alternativ kunder institucionalizimit te femijeve. Mbeshtetja financiare e familjes se origjines, ri-ndertimit te mardhenieve femije-prind apo perdorimi i kujdestarise foster si forme e ndermjetme drejt biresimit jane forma te kujdestarse foster qe mund te aplikohen me sukses ne konditat e Shqiperise. Megjithate aplikimi i saj ka nevoje per nje kuader te plote ligjor, i cili eshte ne proces pregatitjeje.

Duhet te ndertohen politika sociale bashkekohore ne mbrojtje te interesave te femijeve jashte kujdesit prinderor nepermjet zhvillimit te formave alternative te perkujdesesit te cilat u ofrojne femijeve perkujdes afatgjate ne nje familje apo ambient te ngjashem me te.

Krijimin e nje sistemi nacional me baze komunitare te shërbimeve sociale per femije jashte kujdesit prinderor nepermjet ndertimit te nje legjislacioni bashkekohor lidhur me klasifikimin, vendosjen ne perkujdesje dhe te drejtat, format e financimit, monitorimin, vleresimin dhe dhenien e llogarise.

Rritjen e pjesëmarrjes së pushtetit vendor në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Krijimi i sistemit bashkëkohor të grumbullimit të të dhënave, duke u mbështetur mbi treguesit e matjes së mirëqënies shoqërore të fëmijëve, në veçanti të atyre që iu përkasin grupeve shoqërisht të përjashtuara.

Avokati i Popullit, i krijuar në vitin 2000 është një institucion i pavarur i cili mbikqyr mënyrën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Nënseksioni i të drejtave të fëmijëve, i cili sapo është themeluar, kontribuon drejtëpërsëdrejti në vlerësimin dhe matjen e efektivitetit të politikave sociale të mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror.

## **NE DO TE MBROJME TE DREJTAT E ÇDO FEMIJE, PAVARESISHT SHTETESISE DHE VENDIT TE ORIGJINES**

**George MOSCHOS**

Zv. Ombudsmeni i Greqise

Te nderuar miq,

Ne emer te Ombudsmeni Grek, dhe si Zevendes Ombudsman Per te Drejtat e Femijeve, do te doja t'ju sillja pershendetjet me te ngrohta per te gjithë pjesemarrësit e Konferences. Po keshtu do te doja gjithashtu te falenderoja Avokatin e Popullit te Shqiperise, qe me ftoi te merrja pjese sot ne kete eveniment te rendesishem, por per arsye te disa obligimeve te mia ne Greqi, nuk mund te jem me ju sot.

Vitet e fundit, detyra e mbrojtjes dhe promovimit te te drejtave te femijeve, i eshte caktuar me ligj ombudsmaneve dhe institucioneve te pavarura ne te gjithë boten, duke ju pergjigjur kerkesave te Konventes se Kombeve te Bashkuara mbi te Drejtat e Femijes. Te gjithë ne qe punojme si Ombudsmane te te Drejtave te Femijeve, kemi nje detyrim qe te bashkojme perpjekjet tona per te mbrojtur femijet si mbajtes te drejtash njerezore.

Bashkepunimi nderkombetar eshte nje mjet i rendesishem per te siguruar nje presion sa me te forte ndaj qeverive, ne menyre qe keto te respektojne te drejtat e femijeve dhe te permiresojne masat ligjore e administrative qe ato ndermarrin per zbatimin e tyre. Kjo eshte dhe nje menyre per te permiresuar dokumentet e propozimeve mbi mbrojtjen e te drejtave te femijeve qe kane levizur bashke me familjet e tyre apo te pashoqeruar nga vendi i tyre ne nje tjetër, si emigrante, refugjate apo viktimat e trafikimit dhe shfrytezimit.

Ombudsmeni Grek ka pasur deri tani nje numer rastesh per te bashkepunuar me Ombudsmanin Shqiptar dhe Autoritetet Publike, duke trajtuar çështje te femijeve shqiptare, qe jetojne ne Greqi, si emigrante apo si viktimat. Ne madje kemi bashkepunuarne investigimet dhe perfundimet tona, ne menyre qe femijet qe jane larguar ne te kaluaren nga institucionet Greke te perkujdesit te mund te identifikohen ne Shqiperi. Padyshim, keto lloj çështjesh, duhen trajtuar gjithmone me kujdes, duke shmangur pergjithesimet e kota dhe ndeshkimet dhe duke respektuar te dhenat personale te femijeve viktimat aktuale apo potenciale per abuzim. Po keshtu ne duhet te jemi te kujdesshem per te mbrojtur te gjitha te dhenat personale te femijeve nga shfaqja apo publikimi ne masmedia, per arsye se kjo do te perbente nje dhunim te te drejtave te tyre te privacies dhe per kete arsye ne na duhet qe t'i mbrojmë ata nga çdo lloj abuzimi institucional sekondar.

Me lejoni te perfitoj nga mundësia qe t'ju garantoj se Ombudsmeni Grek ka vendosmerine qe te veproje ne menyre te vendosur per mbrojtjen e te drejtave te femijeve qe rrjedhin nga Konventa e Kombeve te Bashkuara. Ne do te mbrojmë te drejtat e çdo femije qe jeton ne Greqi, ne menyre te njejte, pavaresisht nga shtetësia e tyre apo nga vendi i origjines, dhe do te jemi veçanerisht te ndjeshem per viktimat e diskriminimit, shfrytezimit dhe çdo lloj forme tjetër dhunimi te te drejtave themelore njerezore.



Duke ju uruar nje konference sa me te sukseshme, besoj ne perfundimet dhe ne gjetjet e saj dhe shpresoj ne bashkepunime te metejshme me Avokatin e Popullit Shqiptar dhe çdo organizate tjeter aktive te te drejtave te femijeve ne vendin tuaj.

## **RRUGE PER TE NGRITUR URAT E BASHKEPUNIMIT**

### **Thëllëza ARIFI**

Ne emer te Ombudsperonit te Kosoves

I nderuar Z, Dobjani te nderuar mysafire,

Me lejoni qe ne emer te Ombudsperonit te Kosoves z. Marek Antoni Nowicki, Grupit per te Drejtat e Femijeve dhe ne emrin tim personal t'ju shpreh pergezimet e mia per kete Konference, tashme tradicionale qe Zyra e Avokatit te Popullit ne Shqiperi po ben si aktivitet qe ndihmon promovimin e te drejtave te njeriut. Ju jam mirenjohese per ftesen, pjesmarrjen ne nje konference te tille, sidomos kur jane ne pyetje te Drejtat e Femijeve si nje kategori me komplekse dhe e veçante e popullsise.

GDF – ne IOK u themelua ne mars te vitit 2004, e perkrahur nga zyra e UNICEF-it ne Prishtine dhe ofron mbrojtjen, promovimin, vezhgimin dhe inicon hetimet mbi shkeljet e te drejtave te femijve nga ana e autoiteteve publike. Themelimi i Grupit per te Drejtat e Femijeve i mundesoi IOK qe te fokusohet me shume ne mbrojtjen e te drejteve te femijve edhe ate sipas Konvetes per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe sipas Konventes per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijve, ne menyre qe mbrojtja e ketyre te drejtave ne Kosove te behet ne menyre me efektive dhe qe gjendja e femijve te permiresohet ne pergjithesi.

Konferenca e tilla jane per tu mirepritur dhe sidomos kur jane ne pyetje mbrojtja nga shkeljet e te drejtave te femijve sidomos te aty te drjetave te cilat koheve te fundit jane bere dukur jo vetem per Shqiperine por edhe per Rajonin, si p.sh. trafikimi i femijve siç u diskutua edhe gjate krejt kesaj Konference. Prandaj le te na sherbejn koferencat e tilla si rruge per te ngritur dhe perforcuar urat e bashkpunimit qe te jemi “ Te gjithë se Bashku ne Mbrojtje te te Drejtave te Femijeve” dhe jo vetem ne Shqiperi, por edhe ne Rajon.

Mendoj se sa ka qene e sukseshme kjo Konference dhe per kete flet fakti se ne kete Konference Ju i nderuari Avokat arritet te mbledhni dhe te diskutoni per te Drejtat e Femijve te gjitha institucionet e Shqiperise qe nga Pralamenti, Qeveria, Ministrit e deri te OJQ vendore e nderkombetare.

Prandaj krejt se fundmi uroj qe ajo çfare u diskutua dhe u premtua per te Mbrojtjen e te Drejtave te Femieve nga ana e te gjitha ketyre institucioneve te mos mbetet ne leter por te realizohet dhe qe te Mbrojtja e te Drejtat e e Femijve kudo qe jane te avancohet.

## **KUSHTET PER REALIZIMIN DHE RESPEKTIMIN E TE DREJTAVE TE FEMIJEVE**

### **Nevenka KRUSHAROVSKA**

Zevendese e Avokatit te Popullit te Maqedonise

Ju pershendes te gjithëve dhe Ju deshiroj pune te mbare, uroj qe me keto punime te arrihen rezultate pozitive.

Kam nderin dhe kenaqesine qe jam e ftuar ne kete Konference, ngaqe konsideroj se te gjithë ne se bashku do te kontribuojme ne ngritjen e ndergjegjes sa i perket te drejtave te femijeve dhe mbrojtjen e veçante te tyre nga institucionet e shteteve tona, nga çdo individ e sidomos nga institucionet kompetente, siç jane institucionet e ombudsmanëve.

Seksioni per mbrojtjen e te drejtave te femijeve ne Republiken tone vepron ne kuader te zyres nacionale te Ombudsmanit te Republikës se Maqedonise. Me Ligj in e ri te Avokatit te Popullit, te miratuar nga fundi i vitit 2003, ne per9jithesi roli i Institucionit fitoi ne peshe, ndersa ne menyre te vqante u avancua mbrojtja e te drejtave te femijeve, si kategori e veqante per te cilen sigurojme mbrojtje sipas parashtresave te parashtruara me iniciative individuale. Se ketejmi, duke percjelle situatat, sa i perket realizimit te te drejtave te femijeve ne plan me te gjere, veprojme me ndermarrjen e masave per realizimin konsekuent, respektimin dhe perparimin e te drejtave te femijeve. Nderkaq, shfrytezojme te gjitha mundesite e parapara me Ligj si dhe me propozimet tona ndikojme edhe ne amendimin e normave ligjore. Njeherit, me Rregulloren per pune dhe me aktet e tjera te Avokatit te Popullit, perforcohet roli i Seksionit dhe parashikohet zgjerimi i tij me punesimin e juristeve, psilcologeve dhe punonjesve social.

Edhe perkunder perpjekjeve tona, per respektimin konskuent te te drejtave dhe interesave te femijeve, nuk mund te themi se te gjithë femijet ne Republiken e Maqedonise gezojne kushte te njejta gjate realizimit te te drejtave te tyre, ndersa kjo ndodh per shkak te papunesise dhe varferise se nje pjese te madhe te popullates. Nderkaq, Institucioni yne ne menyre permanente ve ne dukje dhe orvatet qe Kuvendi dhe Qeveria e Republikës se Maqedonise, gjate hartimit te politikës dhe shperndarjes se mjeteve te buxhetit, para se gjithash te udhehiqen nga interesi me i larte i femijeve, nga ajo se femijet kane prioritet kundrejt nevojave te tjera, si edhe te respektohen tre parimet kryesore te Konventes per te drejtat e femijes, mosdiskriminimi, interesi i femijes dhe pjesemarrja e femijes. Per fat te keq, akoma nuk mund te them se jemi te kenaqur me reformat e filluara dhe ndryshimet qe zbatohen ne shtetin tone.

Konsiderojme se edhe me tej ndihet nevoja per aplikimin e masave per ngritjen e ndergjegjes publike per te drejtat e femijeve dhe statusin e tyre, si subjekte me te drejta dhe detyra te veçanta, me ç'rast nevojitet edukimi i femijeve, mesuesve, prinderve, e qe

deri diku zbatohet me femijet dhe kuadrin arsimor, por akoma nuk ekzistojne menyra perkatese te organizimit per edukimin e prinderve, perverse permes disa organizatave joqeveritare.

Ne Institucionin e Avokati i Popullit, femijet rralle here me vetiniciative paraqiten per te kerkuar mbrojtjen e te drejtave. Ne te shumten e rasteve, ne emer te tyre, parashtresa parashtrojne prinderit. Pra, mund te konstatohet se femijet akoma nuk i njohin sa duhet te drejtat dhe detyrat e tyre dhe se aftesia e vetembrojtjes gjate cenimeve dhe abuzimeve te te drejtave te tyre edhe me tej nuk eshte ne nivelin e kenaqshem. Prandaj, gjate kohe tentojme qe te drejtat e femijeve t'i perfshijme ne te gjitha nivelet e arsimit. Ky proces ka filluar, por akoma nuk eshte finalizuar.

Ne kete kontekst, nje pjese e aktiviteteve eshte perqendruar ne dhenien e propozimeve per ndryshimin e normave ligjore. Keshtu, me propozimet tona jane bere ndryshime ne me teper ligje, nga te cilet do ta kisha permendur Ligjin per familjen, ne pjesen e percaktimit te kushteve perkatese per realizimin e te drejtave te femijeve per mbajtjen e kontakteve personale me prinderit, me te cilet nuk jetojne. Keto ndryshime dhane rezultate pozitive dhe njeherit rezultuan edhe me zvogelimin e numrit te parashtresave qe kane te bejne me kete te drejte. Sidomos e nje rendesie te verante eshte se me keto ndryshime parashikohet detyrimi qe qendrat per ceshtje sociale, gjate marries se vendimeve per keto ceshtje, ti inkuadrojne edhe femijet, si edhe varesisht nga moshja dhe pjekuria t'i marrin parasysh mendimet dhe qendrimet e tyre.

Gjithashtu, ne planin normativ, me iniciativen tone, jane parashikuar masa ligjore per mbrojtjen e femijeve nga alkooli dhe duhani, ne kontekst te kesaj tani aplikohet ndalimi i blerjes se alkoolit dhe duhanit nga femijet, si edhe kufizimi i vizitave te klubeve ne oret e vona te nates. Por, edhe perkunder kesaj, keto vese te te rinjte akoma nuk jane qrrrenjosur teresisht.

Kujdes te vecante i kushtojme edhe mbrojtjes se femijeve nga ndikimi i informatave te ndryshme te demshme dhe mbrojtja e femijeve nga dhuna. Me ndryshimet ne Ligjin per familjen, jane parashikuar me teper masa per mbrojtjen e femijeve, te cilet jane viktimat te dhunes ne familje. Per fat te keq, ende nuk jane hapur keshillimore per personat, te cilet ushtrojne dhune ndonese me ndryshimin e Ligjit eshte parapare mundesia e largimit te perkohshem nga shtepia e personit qe ushtron dhune mbi femijen, i cili pastaj detyrimisht viziton keshillimoren ne menyre qe ta permiresoje sjelljen e tij.

Te brengosur per shkak te dukurise se keqtrajtimit fizik dhe psikik te nxenesve nga ana e kuadrin arsimor, ndermorem masa per raste konkrete dhe tentuam te bejme ndryshime edhe ne normat ligjore, me te cilat ndalohet keqtrajtimi fizik dhe psikik i femijeve. Megjithate, jo sa duhet eshte precizuar ajo se ç'nenkuptohet me nocionin keqtrajtim fizik e çka me psikik. Gjithashtu, ne rastet e aplikimit te shpeshte te keqtrajtimit fizik apo psikik, nga mesues te caktuar, nuk zbatohet masa e perjashtimit te tyre nga procesi edukativo-arsimor. Me qellim te verifikimit te gjendjes reale, lidhur

me keqtrajtimin fizik apo psikik te nxenesve nga ana e kuadrit arsimor, ne bashkepunim me Zyren e UNICEF-it ne Republiken e Maqedonise, planifikojme qe gjate vitit 2006 te bejme hulumtimin e kesaj dukurie.

Disa vjet me pare, intervenuam qe te ndermerren masa per mbrojtjen e te drejtave te femijeve te rruges. Keshtu, kesaj kategorie te femijeve iu siguria mbrojtje e veçante sociale dhe lloje te tjera te mbrojtjes. Se ketejmi, u perkrah edhe propozimi yne per formimin e qendrave ditore per perkujdesje te femijeve te rruges dhe kah fundi i vitit 2004 ne Shkup filloi me pune qendra ditore per perkujdesjen e ketyre femijeve. Shpresojme qe femijet te largohen nga rruga, te kthehen neper shkolla dhe t'u sigurohet perfshirje ne jeten shoqerore.

Gjate mbrojtjes te te drejtave te femijeve, kujdes te veçante i kushtojme te drejtave te femijeve te cilet bien ndesh me ligjin. Sipas propozimeve tona, ne Kodin Penal te Republikes se Maqedonise, jane parapare disa masa alternative per te mitur: puna e dobishme, nderprerja me kusht e procedures penale dhe masat e sigurise. Tanimë është hartuar Ligji i veçante per te drejtat e te miturve, me te cilin do te perfshihen femijet e rrezikuar dhe femijet qe jane ne konflikt me ligjin dhe do te parashikohen masa preventive per rehabilitimin e femijeve te cilet jane ndeshur me ligjin dhe kane vuajtur ndonje sanksion.

Me qellim te parandalimit te trafikimit te femijeve dhe sigurimit te ndihmes dhe mbrojtjes perkatese te femijeve viktima, te cilet me se shumti shfrytezohen per prostitucion apo per pune te detyrueshme, ne menyre aktive jemi perfshire ne grupin per hartimin e planit aksionar per parandalimin e trafikimit te femijeve, plan ky i cili besojme se se shpejti do te miratohet nga Qeveria e Republikes se Maqedonise.

Per ekzistence, rritje dhe zhvillim normal te femijeve, vemendje e veçante duhet kushtuar sherbimeve shendetesore, perkatesisht femijet duhet te gezojne mbrojtje shendetesore te nivelit me te larte, ashtu siç parashikohet me Konventen per te drejtat e femijeve. Institucioni yne rendesi te madhe i kushton realizimit te kesaj te drejte, duke vepruar sipas parashtresave individuale dhe ne pergjithesi, duke propozuar edhe zgjidhje.

Me normat ligjore, femijet çlirohen nga disa detyrime sa i perket shfrytezimit te mbrojtjes shendetesore. Megjithate, per shkak te gjendjes se veshtire materiale, te me teper familjeve ne shtet, mbi te gjitha per shkak te kontributeve te papaguara nga ana e punedhenesve, nje numer i madh i femijeve nuk kane kushte per sigurimin e mbrojtjes adekuate shendetesore. Prandaj, disa here kemi inicuar ndryshime ne normat ligjore, ne kuptim te çlirimit nga detyrimet per femijet deri 18 vjeç, me qellim qe te mund t'i shfrytezojne sherbimet shendetesore dhe barnat. Tentativat tona per çlirim nga participimi i femijeve, u kurrezua me sukses por vetem per femijet me nevoja, te cileve u njihen kushtet per shfrytezim dhe furnizim me vegla ortopedike.

Me qellim te sigurimit te kushteve perkatese per realizimin dhe respektimin e te drejtave te femijeve me nevoja te veçanta dhe qe te njejtet pa kurfare diskriminimi te perfshihen ne jeten shoqerore, kemi bere perpjekje qe keta femije te qendrojne neper familjet e tyre dhe te mos akomodohen neper institucione, si edhe te inkuadrohen neper kopshte dhe rreze procesin e rregullt arsimor me femijet e tjere. Ky proces ka filluar dhe deri me tani jane shenuar rezultate pozitive.

Nje e drejte tjetere e femijeve eshte edhe regjistrimi ne fibrin amze te te lindurve. Ndonese ligji ekziston dhe ne te parashikohet qe prinderit dhe institucionet shendetesore ku eshte lindur femija, me kohe ta paraqesin lindjen e femijes dhe ate ta regjistrojne ne evidencen amze, ne jeten e perditshme hasim ne numer te madh te femijeve te paregjistruar. Prandaj, ata jane te penguar t'i realizojne te drejtat e tyre. Ky fenomen sidomos vjen ne shprehje te qytetaret e bashkeseve rome dhe shqiptare. Duke vepruar sipas parashtresave qe kane te bejne me kete problem, konstatoam se shpesh here prinderit nuk e paraqesin femijen e lindur dhe me vone ate nuk mund ta regjistrojne ne shkolle e as nuk mund t'i shfrytezojne te drejtat e tjera. Gjate viteve te kaluara, veshtire liconfirmohet se velle femija eshte lindur ne Republiken e Maqedonise, ngaqe prinderit nuk kane ne dispozicion asnje dokument. Megjithate, Institucioni Avokati i Popullit, si edhe institucionet e tjera, gjejne menyra per t'i verifikuar keto fakte dhe per ta bere te mundshem regjistrimin e femijes ne evidencen amze. Problem paraqitet, kur nuk ka interesim dhe bashkepunim nga ana e prinderve.

Duke u nisur nga e drejta e femijes per pjesemarrje, ne te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me te drejtat dhe interesat e tij dhe me qellim qe t'i perfshijme femijet ne punen tone, gjate vitit 2004, me perkrahjen e Zyres se UNICEF-it ne Shkup, formuam te ashtuquajturin Bord te femijeve te perbere nga femije te shkollave tetevjeçare dhe te mesme, me anetare qe u perkasin bashkeseve te ndryshme qe jetojne ne Republiken e Maqedonise.

Perkrah trajnimit te femijeve per te drejtat e tyre dhe punes se institucionit tone, femijet e Bordit dhane propozimet dhe mendimet e tyre per ndryshin e normave ligjore dhe zbatimin e tyre konsekuent, ndersa propozimet e paraqitura i derguam prane organeve kompetente.

## **NEVOJA PER FUSHATE INFORMIMI**

### **Jean-Luc NICOLLIER**

Drejtor i ASED me qender ne Gjeneve

Qysh nga vitit 1993, ASED-i perpiqet dhe ndihmon per permiresimin e jetes se femijeve dhe te personave me aftesi te kufizuara mendore dhe fizike ne Shqiperi.

Si drejtor i OJQ-se zvicerane ASED, nje organizate ne ndihme te femijeve dhe te personave ne nevoje, sot do te flas vetem per qeshtjen e te drejtave te femijeve dhe te te rriturve me aftesi te kufizuara.

Kjo kategori njerezish perben nje minimum prej 2.5 % te popullsisë sikunder kudo tjeter neper bote. Ne Shqiperi, behet fjale per 80'000 persona, te cilet duhet te kene te njejtat te drejta si te tjeret, te drejta te cilat duhet te respektohen ne menyre te veqante per faktin se vete ata e kane te veshtire t'i mbrojne ato.

E para e drejte qe ata kane eshte e drejta per te jetuar. Nen regjimin komunist, nuk kane ekzistuar qendra rezidenciale per persona te rritur me aftesi te kufizuara. Ata nuk jetonin gjate. Dhe ende sot, nuk ka ndonje qender te tille ne te gjithë Republikën.

Midis ketyre 80.000 Shqiptareve, Jane rreth 20.000 femije me aftesi te kufizuara mendore dhe fizike. Sot ka vetem 250 vende ne qendrat e ndryshme rezidenciale shtetere. Pothuajse 100 me pak se perpara 15 vjeteve. Ata qe qendrojne ne shtepi marrin nje pension shume te vogel. Familjet e tyre perballen me nje sere veshtiresish. Eshte shume e veshtire te perkujdesesh per femijet me aftesi te kufizuara, sidomos kur mjetet nuk jane te mjaftueshme. Sigurisht, ekzistojne edhe disa insitucione te tjera. Te verberit kane nje qender, po ashtu edhe personat e shurdhet, Por nderkohe ka edhe shume forma te tjera handikapesh. Disa "qendra ditore" dhe insitucione private jane krijuar ne saje te nismave private dhe me se shumti te financuara nga OJQ te ndryshme. Disa klasa speciale te hapura nga ministria e Arsimit dhe e Shkences u japin mundesine disa femijeve me handikape te lehta per te zene kohen, por jo te gjithë pranohen ne to. Keshtu, na duhet te pranojme se Shqiperia eshte shume mbrapa ne lidhje me trajtimin e sektorit te handikapit.

Nga ana tjeter, ne saje te nismes se drejtuesve te ndryshem ne ministrite perkatese, ka patur nje permiresim te dukshem te jeteses se personave qe jane marre nen perkujd,-sje ne insitucione te ndryshme. Pas 12 vite perpjekjesh te vazhdueshme, drejtuesit jane ndergjegjesuar per rendesine e nje trajtimi te pershtatshem te ketyre personave. Insitucionet e tyre kane patur mjaft permiresime me ndihmen e OJQ-ve si kjo e jona. Kurset e formimit te ASED-it dhe HEP-it (Shkolla e Larte e Pedagogjise ne Lozane) kane perbere nje element te rendesishem per te rritur nivelin e perkujdesjeve. Kjo

situatë me respektim progresiv të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Tani që çdo gjë duket se përparon dhe që standarti i jetesës në Shqipëri është rritur, është koha që të mendohet me seriozitet për këtë sektor, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Duhet kuptuar nevojat për një buxhet të mjaftueshëm me qëllim që të ecet përpara dhe të mos *lejojme* kthimin në situatën e shkuarës.

Po jap këtu disa nga të drejtat themelore të fëmijëve me aftësi të kufizuara:

E drejta për të qenë i respektuar duke marrë parasysh ritmin e ndryshëm të jetesës së secilit.

Mungesa e një personeli të kualifikuar e pengon respektimin e kësaj të drejte themelore. Qdo gjë duhet bërë me shpejtësi dhe fëmijëve iu duhet të kalojnë një kohë të mirë duke fjetur. Kur ata nuk mund të ushqehen vetë ose hanë me ngadalë, askush nuk merr mundimin t'i ushqejë. Disa janë të uritur madje edhe kur ka për të ngrenë. Ata duhet të kenë të drejtën për t'u respektuar sipas ritmit biologjik dhe fiziologjik të secilit.

E drejta për të mbajtur kontaktin me familjet e tyre. Kur fëmijet vendosen në qendra të ndryshme, nuk mendohet fare për vendndodhjen familjare të tyre. Për shembull, në qoftë se një familje në Shkodër vendos të futë fëmijën e vet në një institucion, fëmija do të vendoset në Berat, edhe pse ka tashmë një qendër në Shkodër. Motrat dhe vellezerit nuk vendosen së bashku. Përse është kjo situatë? Nuk kushton ndonjë gjë të madhe që të riorganizohet puna dhe të vendosen fëmijet pranë familjeve të tyre. Prinderit mund të ndihmohen institucionin dhe të ruajnë kontaktin me fëmijet e tyre. Këta fëmijë duhet të kenë të drejtën për të jetuar pranë familjeve të tyre dhe të ruajnë kontaktin me to.

E drejta për t'u arsimuar. Është bërë zakon që fëmijet me aftësi të kufizuara të mbahen në shtëpi pa menduar për të zhvilluar aftësitë e tyre për të mesuar dhe për të përparuar. Sa më i rëndë të jetë handikapi, aq më e rëndësishme është që të zhvillohen aftësitë potenciale që janë të paprekura. Shkollimi dhe edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara që jetojnë në shtëpitë e tyre në qendra dhe në klasa speciale brenda sistemit të shkollave normale është shumë i rëndësishëm dhe duhet zhvilluar. Ata duhet të kenë të drejtën për arsimim, sikurse çdo fëmijë tjetër.

E drejta për t'u integruar në shoqëri dhe për t'u rritur. Personat me aftësi të kufizuara por që mund të levizin mundet fare mirë të mesojnë një zanat. Ata mund të bëjnë kopshtare, bukepjekës, rrobaqepës apo të merren me punë të vogla. Ata duhet të kenë të drejtën për t'u integruar në shoqëri civile dhe të rriten.

E drejta për të menaxhuar vetë buxhetin e tyre. Kur persona me aftësi të kufizuara që jetojnë në një qendër prodhojnë artikuj të ndryshëm, fitimi nga këto produkte duhet t'i mbetet qendres, kjo gjë ndihmon për forcimin e autonomisë dhe u jep atyre besimin në vetvetë.

Drejtoritë e institucioneve duhet të kenë me shumë përgjegjësi për të menaxhuar buxhetin e tyre.



Aktualisht, drejtorite e qendrave jane te detyruara t'i blejne mallrat ne Tirane me qmime te imponuara. Shpesh ato mund te blejne te njejtat mallra me lire ne qytetet e tyre duke mos paguar edhe koston e transportit. Ne buxhetin e tyre duhet te parashikohet nje shume per mirembajtjen e nderteses dhe te pajisjeve madje edhe ne ato qe jane rikonstruktuar nga OJQ te ndryshme.

Puna e organizatave humanitare duhet te lehtesohet. Eshte e pabesueshme qe nje OJQ jo fitimpruese te jete e detyruar te paguaje 20 % te TVSH-se me fondet e donatoreve qe i japin ato para per qellime humanitare. Rezultati eshte qe donatoret refuzojne te financojne projekte ne Shqiperi. Dhe perjashtimi nga te gjitha taksat per OJQ-te eshte i nevojshem per te nxitur donatoret te tjere.

### **Perfundime**

Ndjehet nevoja per nje fushate kombetare per te informuar popullsine rreth personave me aftesi te kufizuara dhe te Drejtave te tyre. Te kesh nje person me aftesi te kufizuara ne familje nuk duhet te perbeje nje turp. (çdo femije me aftesi te kufizuara ka nje aftesi te cilen mund ta zhvilloje dhe atij i duhet dhene nje shans per tu rritur dhe duhet trajtuar si i tille.

Menaxhimi dhe pergjegjesia per sektorin e handikapit u duhet besuar profesionisteve. Nje shprese e madhe ka lindur ne kete fushe. Duke filluar nga Qershori i vitit qe vjen, do te diplomohen studentet e pare ne pedagogjine e specializuar ne Universitetin e Vlores dhe profesioniste te rinj do te dalin ne treg. Kjo dege eshte krijuar me iniciativen e ASED-it, Shkolles se Larte te Pedagogjise se Lozanes ne Zvicer dhe eshte financuar nga zyra e zhvillimit dhe e kooperimit Zviceran. Profesionistet e diplomuar ne kete dege duhet te shfrytezohen ne kete fushe te veçante, perndryshe rrezikon qe ata te largohen nga vendi.

Eshte e domosdoshme qe te merret seriozisht ky sektor i 80'000 shtetasve Shqiptare. Duhet krijuar infrastruktura e nevojshme. Duhet rritur numri i qendrave ditore, klasave speciale. Programi afatgjate MARCELA i propozuar nga ASED-i ekziston por kerkesa per projekte te ndryshme duhet te vije nga autoritetet shqiptare.

Ka shume ministri, puna e te cilave lidhet me jeten dhe te drejtat e personave me aftesi te kufizuara - Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, e Punes dhe e Shanseve te Barabarta, e Transportit, e keshtu me rradhe. Une mendoj se, duke pare rendesine, urgjencen dhe veshtiresite e koordinimit midis ministrive, del i nevojshem krijimi i nje koordinatori special nder-ministror per personat me aftesi te kufizuara. Ne kete menyre, buxheti per personat me aftesi te kufizuara do te rritet dhe ndihma humanitare e OJQ-ve do te lehtesohet.

Kjo eshte rruga per te arritur ne nivelin e institucioneve Evropiane qe lidhen me handikapun.

Faleminderit!

# ADMINISTRIMI I DREJTESISË PËR TE MITURIT

## Anola SHALA

Specialiste ne Ministrine e Drejtesise

Te nderuar pjesemarres,

Ne kuader te ratifikimit, implementimit dhe zbatimit te Konventes per te Drejttat e Femijes, nder prioritetet kryesore te Ministrise se Drejtesise ka qene dhe vazhdon te jete:

marrja e masave konkrete ligjore dhe administrative per zhvillimin dhe permiresimin e kuadrit ligjor dhe nenligjor, material e procedural, i nevojshem per mbrojtjen, kujdesin dhe ndihmen ligjore per te miturit, ndjekja dhe realizimi i strategjive dhe projekteve me institucionet e ngarkuara per mbrojtjen, respektimin dhe ekzekutimin e te drejtave dhe interesave te ligjshme te tyre, duke synuar perafrimin me standartet nderkombetare kjo ne mbeshtetje edhe te instrumentave te tjere nderkombetare qe veprojne ne kete fushe

Si rezultat i konceptimit te administrimit te drejtesise per te miturit si pjese integrale e procesit te zhvillimit te legjislacionit kombetar si edhe ne kuader te ratifikimit dhe zbatimit te Konventes per "Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve" (ne shkurt, 1992) u krijua si pjese e struktures se Ministrise se Drejtesise edhe Drejtoria e Drejtesise per te Miturit dhe Sherbimeve Juridiko Administrative.

Nder detyrat kryesore te saj permendim; bashkerendimin dhe realizimin e politikave, programeve dhe veprimtarive qe aplikohen ne fushen e drejtesise per te miturit, edukimin ligjor, luften dhe parandalimin e shkeljeve te ligjit dhe kriminalitetit tek te miturit.

Ne lidhje me konceptin "Drejtesia per te Mitur" eshte e nevojshme qe te identifikojme qartesisht ç'fare do te kuptojme dhe si rrjedhoje ç'fare politikash, nderhyrje dhe masa duhet te zhvillojme per drejtesine e te miturve.

Misioni i drejtesise per te miturit eshte dhe duhet te perqendrohet ne dy fusha kryesore :

te zhvilloje te drejttat e te miturve dhe te siguroje mbrojtjen e tyre nga rreziqet qe mund te cenojne jeten, shendetin, edukimin dhe mirerritjen e tyre, si dhe te parashikojte denueshmerine dhe trajtimin e te miturve qe perfshihen ne rrugen e krimit.

Ne kete kuader, te miturit konsiderohen te rrezikuar nese, keqtrajtohen fizikisht ose moralisht, kur kushtet e jeteses se tyre si ushqimi, shendeti, sigurimi, edukimi nuk mundesojne me nje zhvillim normal fizik dhe psikologjik te tyre.

Nje kategori tjetere me shume rrezik serioz per femijet jane: perdorimi i dhunes, abuzimet seksuale, prostitucioni, konfliktet prinderore, braktisja prinderore apo braktisja e shkollimit, te gjitha keto fenomene çojne ne prishjen e ekuilibrit individual te femijes.

Nga pikepamja legjislative, drejtesia per te mitur karakterizohet nga zhvillimi i nje kuadri masash ligjore materiale dhe procedurale te posaçme per trajtimin e te miturve. Legjislacioni aktual qe kemi mund te konsiderohet nje

arritje. Megjithate, zhvillimet ekonomiko-sociale, zhvillimet e se drejtes nderkombetare (ku tashme jemi pale e shume konventave) dhe problemet qe verejme deri me sot eidentojne nevojen per nderhyrje te metejshme ne peraftrimin e tij me standartet me te mira nderkombetare ne fushen e mbrojtjes dhe zhvillimit te femijeve, perfshire edhe drejtesine per te miturit.

Persa i perket garantimit te te drejtave te te miturve dhe sigurimit te mbrojtjes se tyre nga rreziqet qe mund te cenojne ata, gjyqtaret dhe gjykatat e specializuara per te miturit, marrin vendimet perkatese per dhe ne interesin me te larte te te miturit.

Legjislacioni per te miturit ka nevoje te preket dhe zhvillohet me tej ne fushen penale, ne ceshtje te tilla qe lidhen me hetimin, gjykimin dhe ekzekutimin e vendimeve penale, ne fushen e parandalimin te krimeve nga minoret.

Konkretisht, drejtesia per te miturit ne fushen penale synon ne vendosjen e masave mbrojtese, te ndihmes, edukimit dhe mbikqyrjes se te miturit. Aspekti edukues eshte dhe duhet te mbizoteroje mbi natyren ndeshkuese te masave qe caktohen nga vendimet e gjykates, te cilat gjithmone shoqerohen me lehtesimin e mases dhe llojit perkates te denimit. Madje per ata te mitur qe nuk kane mbushur moshen 14 vjeç nuk mund te behet fjale per sanksione penale por vetem per masa edukuese.

Duke patur parasysh kater parimet themelore te Konventes per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve, *mbijetesen, mbrojtjen, zhvillimin dhe pjesemarrjen*, angazhimet e institucionit tone jane pasqyruar si ne kode ashtu edhe ne ligje te veçanta ne mbrojtje te te drejtave legjitime te femijeve.

Konkretisht mund te permend, se:

Te qenit femije legjislacioni shqiptar e perkufizon ne lidhje me aftesine per te kuptuar rendesine e veprimeve qe kryen dhe pasojave qe vijne prej tyre. Ne **Kodin Civil** percaktohet se, personi kur mbush moshen 18-vjeç, i lind zotesia e plote qe me veprimet e tij te fitoje te drejta dhe te marre persiper detyrimet civile.

Miratimi i **Kushtetutes se Republikes se Shqiperise** parashikoi dispozita te veçanta ne mbrojtje te femijeve, te rinjve, te grave shtatzena dhe nenave te reja. Ne kuadrin e lirive dhe te drejtave ekonomike , sociale dhe kulturore, kushtetuta i njeh femijes te drejten te jete i mbrojtur nga dhuna, nga keqtrajtimi, shfrytezimi dhe perdorimi per pune.

Mjaft i rendesishem ishte edhe miratimi i **Kodit te ri te Familjes** , ne te cilin jane perfshire nje pjese e mire e konventes. Ne te eshte parashikuar parimi i interesit me te larte te femijes.

Permiresime te vazhdueshme jane bere ne **Kodin Penal**, i cili ka parashikuar amendamente ne mbrojtje te te miturve, nga fenomene e situata te krijuara rast pas rasti. Keshtu, jane parashikuar dispozita ne lidhje me mbrojtjen e femijeve nga trafikimi, marredheniet seksuale e homoseksuale, prostitucioni, pornografia, braktisja, etj.

Ne dispoziten *“Mbi trafikimin e femijeve”*, permiresimet e bera synonin ne ndryshimin e konceptit te trafikimit te te miturve duke perfshire ne te specifikime veprash te tjera , si skllaverimin apo forma te ngjashme te tij, venien ne perdorim ose transplantimin e organeve, etj, gjithashtu synonin, ne ritjen e mases se denimit si dhe ne parashikimet mbi dhenien e gjobes.

Ndryshimet ne kete Kod, krijuan mundesine e zbatimit te ligjit penal te Republikes se Shqiperise edhe per shtetasit e huaj qe merren me trafikimin e jashteligjshem te njerezve, femijeve dhe grave. Keto amendamente mundesojne mbrojtjen e femijeve shqiptare nga trafikimi, sidomos ata qe jetojne jashte territorit te shtetit tone, per arsye te emigrimit me familje ose te largimit nga familja e tyre.

Gjithashtu, Kodi Penal, per te mbrojtur femijet nga perhapja e fenomeneve te shoqerise se sotme shqiptare ka parashikuar dhe nje dispozite te vecante mbi pornografine, sipas se ciles prodhimi, shperndarja, reklamimi, importimi, shitja dhe botimi i materialeve pornografike ne ambjentet e te miturve, perbejne kundervajtje penale dhe denohen me gjobe ose me burgim deri ne dy vjet.

Po ashtu, eshte parashikuar, nje dispozite specifike mbi kanosjen serioze per hakmarrje ose per gjakmarrje qe i behet nje te mituri per t'u ngujuar si dhe masen e denimit. Gjakmarrja apo praktika te tjera te ketij lloji ndikojne demshem ne zhvillimin e femijes, per kete arsye do te punohet per permiresimin e legjislacionit ne kete drejtim.

Te gjitha keto vepra kriminale perbejne shkelje te renda te te drejtave te njeriut dhe ne vecanti te te drejtes se femijeve per nje rritje, edukim dhe zhvillim normal dhe ne harmoni me synimet e shoqerise.

Nese do t'i referohemi te dhenave statistikore per kriminalitetin tek te miturit, krahasuar me vitet 2002 dhe 2003 pasqyrojne nje rritje graduale te fenomenit.

Te denuar te mitur gjate vitit 2004 jane 320, nga te cilet: 313 per krime dhe 7 per kundravajtje. Ne vitin 2002 dhe 2003 nga kjo kategori te denuarish ishin respektivisht 274 (251 per krime, 23 per kundravajtje) dhe 308 ( 259 per krim, 49 per kundravajtje). Veçori eshte se gati 98% e te denuarve te mitur jane per krime. Krahasuar me te denuarit ne shkalle vendi (6379) te denuarit e mitur jane 5% e tyre.

Gjate ketij viti(referuar 2004), rritje me te ndjeshme ne numer kane te denuarit per krime kunder jetes, kunder lirise se personit dhe krimin e vjedhjes apo te grabitjes. Po sipas ketyre te dhenave ka zvogelim te numrit te te denuarve te mitur per krimet ne fushen e drejtesise.

Ne menyre tabelare krahasimet lidhur me te denuarit e mitur ne tre vitet e fundit jepen si vijon:

Te denuar te mitur	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004
Per krime	251	259	313
Per kundravajtje	23	49	7

Pra, te denuar te mitur per vitin 2004, gjithsej jane 313, prej tyre 48 te mitur jane denuar me gjobe, 209 te mitur jane denuar me burg deri ne 2 vjet, rreth 41 te mitur jane denuar me burg nga 2-5 vjet, rreth 15 te mitur jane denuar me burg nga 5-10 vjet dhe rreth 2 te mitur jane denuar mbi 10 vjet. Ndersa per kundravajtje jane denuar gjithsej rreth 7 te mitur, prej tyre rreth 5 te mitur jane denuar me gjobe, rreth 2 te mitur deri ne 2 vjet burg.

Nder çeshtjet e gjykuara (krimet) permendim se:

Per marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (neni 100/1) gjatë vitit 2004 janë gjykuar 15 çështje nga 17 vepra të kryera dhe janë dënuar 10 persona;

Per marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (neni 100/2) janë gjykuar 10 çështje për 14 vepra të kryera dhe janë dënuar 5 persona;

Per marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhune me të mitur 14-18 vjeç (neni 101/1,2) janë gjykuar 17 çështje nga 22 vepra të kryera dhe janë dënuar 18 persona;

Per marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhune me të mitur 14-18 vjeç (neni 101/3) janë gjykuar 3 çështje nga 4 vepra të kryera dhe nuk është dënuar asnjë person;

Per vepra të turpshme janë gjykuar 11 çështje nga 11 vepra të kryera dhe janë dënuar 16 persona.

Pra duhet bërë shumë në mbrojtje të kësaj kategorie specifike me mjete dhe menyrë nga me të mirat ligjore e institucionale, për të larguar nga rruga e krimit dhe ri-integruar në komunitet.

Ndryshime ligjore janë bërë edhe në **Kodin e Procedurës Penale**. Ato kanë pasur si qëllim, që të miturit të gezojnë ndihmë të posaçme juridike dhe psikologjike në çdo shkallë të procedimit, në prani të prindit apo personave të kërkuar nga vete i mituri, ndihmen e mbrojtjes së detyrueshme kur i pandehuri është në moshën nën 18 vjeç, si dhe një sërë garancish për mbrojtjen e të miturve dhe personalitetin e tyre, si p.sh;

Pyetja e të miturve në seance me dyer të mbyllura.

E drejta e përfaqësuesit ligjor të të miturit për të mbrojtur interesat e tij me cilësinë e të demtuarit akuzues.

Mbrojtja e detyrueshme profesionale për të miturin nën 18 vjeç.

Ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe të fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitareve të mitur të akuzuar ose të demtuar nga vepra penale.

Mosarrestimi për një veper penale e cila parashikohet si kundravajtje penale.

Gjithashtu, në këto kod është parashikuar edhe një paragraf i veçantë sipas të cilit përcaktohet se gjykimi i të miturve bëhet nga seksione perkatëse, të krijuara në gjykatat e rrethëve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit. Për këto mekanizem po punohet për përfshirjen e tij në reformën gjyqësore.

Jane miratuar në kuadrin e përmirësimit të metejshëm të legjislativës edhe:

Ligji Nr.8331, dt. 21.04.1998 “ **Per ekzekutimin e vendimeve penale**”

Ligji Nr.8328, dt. 16.04.1998 “ **Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim**”.

“**Rregullorja e Pergjithshme e Burgjeve**”( V.K.M. Nr.63, dt.09.03.2000).

Gjatë periudhës 2000-2001, është mundësuar edhe realizimi i ndarjes së të miturve të dënuar dhe atyre të paraburgosur në seksione të veçanta, e konkretisht në *Institutin e Riedukimit - Vaqarr dhe në burgun 313 – Tiranë* - seksioni i paraburgimit. Kjo në përputhje edhe me aktet nderkombetare e kryesisht me rregullat standarte minimale të OKB-se.

Është hartuar Urdhëri i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Rendit Publik (sot Ministria e Brendshme), me Nr. 3750, dt. 10.07.2003 “Per

*kalimin e sistemit te paraburgimit ne varesi te Ministrise se Drejtesise” ( V.K.M Nr 327, dt. 15.05.2003)*

Ne çdo institucion te vuajtjes se denimit eshte perfshire punonjesi social i cili eshte bere pjese e trajnimeve te vazhdueshme per aftesimin ne menyre te veçante ne drejtim te komunikimit me minorenet. Ne menyre te veçante, futja e punonjesit social ne Institucionin e Riedukimit Vaqarr ka ndikuar ndjeshem tek minorenet.

*Strategjia Kombetare per Femijet*, ne Mars te vitit 2001, shoqeruar me plan veprimin perkates si dhe ajo e vitit 2005-2010.

Ne bashkepunim me UNICEF, eshte hartuar strategjia **“Mbi drejtesine e te miturve”**, ne qershor te vitit 2001. Ministria e Drejtesise eshte angazhuar ne grupin draftues te rishikimit te legjislacionit, i cili ka perfunduar me hartimin e nje pakete qe perfshin nje sere ndryshimesh ligjore te cilat e transformojne sistemin e drejtesise ligjore per te miturit, ne nje sistem te pranueshem me kerkesat e standartet nderkombetare ne kete fushe.

Kjo pakete legjislative eshte programuar te shoqerohet edhe me masa konkrete institucionale dhe kerkimin e sigurimit te burimeve njerezore e financiare te posaçme per zbatimin e saj. Ne vazhdimesi, projekt ndryshimet i jane referuar Kodit te Procedures Penale, Kodit Penal, Ligjit nr. 8436, dt. 28.12.1998 “Per organizimin e pushtetit gjyqesor” i ndryshuar, Ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale”, Ligjit nr. 8328, dt. 16.04.1998 “Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim”, Ligjit nr. 8678, dt. “Per organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8677, dt.2.11.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e Policise Gjyqesore”.

Ne kuadrin e trajnimit te gjyqetareve te cilet aktualisht gjykojne çeshtjet familjare si dhe ata qe gjykojne çeshtjet penale, Ministria e Drejtesise ne bashkepunim me Shkollen e Magjistratures, ka zhvilluar aktivitete me teme “Drejtesia e te Miturve”, duke trajtuar kryesisht tema te ndryshme ne lidhje me njohjen dhe zbatimin e legjislacionit shqiptar qe vepron ne fushen e te miturve, shkembime mendimesh dhe dhenie eksperiencash nga eksperte te huaj.

Realizimi i ketyre objektivave si pjese e Ministrise se Drejtesise si dhe i institucioneve te tjera te linjes, ne kuader te zbatimit te konventes per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, u finalizua me prezantimin e raportit Kombetar ne Gjeneve ne Janar te vitit 2005, perpara Komitetit per te Drejtat e Femijeve, si detyrim qe rrjedh nga KDF. Gjithashtu, ne planin e perafimit te legjislacionit vendas me legjislacionin komunitar, ne kuader te perpjekjeve te Shqiperise per aderimin ne Bashkimin Europian, se fundi jane miratuar:

Ratifikimi i Konventes *“Per kontaktet me Femijet”*.

Aderimi i Shqiperise ne Konventen Europiane “Mbi aspektet civile te rrembimit nderkombetar te femijeve” e nenshkruar ne Hage, me 25 tetor 1980 .

Aderimi i Shqiperise ne Konventen Europiane “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshem, njohjen, ekzekutimin dhe bashkepunimin ne lidhje me pergjegjesine prinderore dhe masat per mbrojtjen e femijeve”, (Hage, me 19 Tetor 1996).

Protokollet opsionale te Konventes per te Drejtat e Femijeve, lidhur me çeshtjet e shitjes se femijeve, prostitucionin dhe pornografine me

femijet, si edhe perfshirjen e tyre ne konfliktet e armatosura (*Nju Jork - 06.09.2000*),

*pa lene menjane ketu nenshkrimet e koheve me pare te;*

*Konventes Nr. 182, "Per format me te keqia te punes se femijeve », si edhe Rekomandimit nr.190 "Per format me te keqia te punes se femijeve",*

*Konventes se Hages, "Mbi bashkepunimin dhe realizimin e biresimeve ndervendase"- Qershor 2000 hyre ne fuqi ne Janar 2001, etj.*

Njohja, studimi krahasues dhe pranimi i akteve te tjera te se drejtes nderkombetare ne fushen e te drejtave te femijeve dhe drejtesise per te mitur padyshim qe perben nje prioritet. Marrja persiper e angazhimeve nderkombetare shoqerohet edhe me masat legjislative ne planin e brendshem, e cila patjeter ndikon ne rritjen e cilesise dhe standarteve ligjore e institucionale qe ne mund te jemi ne gjendje te ofrojme per te miturit.

Nder objektivat kryesor qe jane parashikuar per t'u realizuar, duke mbajtur ne vemendje edhe rekomandimet e dhena nga Komiteti per te Drejtat e Femijeve ne Gjeneve, permendim:

Miratimin e paketes ligjore « Mbi Drejtesine e te Miturve », si dhe ngritjen e strukturave perkatese per zbatimin e tij,

Krijimin dhe venien ne funksionim te nje Instituti Riedukimi per te Miturit, ne te cilin te sigurohet asistence juridike dhe psikologjike, arsimim dhe formimin kulturor e profesional per ta, etj

Ngritjen e seksioneve per gjykimin e te miturve ne disa gjykata te rretheve gjyqesore, duke mbajtur ne vemendje caktimin e gjyqtareve te specializuar ne kete fushe.

Specializimin e vazhdueshem te ketyre gjyqtareve.

Ngritjen dhe funksionimin prane institucionit te Policise Gjyqesore, te nje sektori te veçante ne lidhje me hetimin e kesaj grup moshe, me perberje te personave te kualifikuar ne kete drejtim.

Trajnime profesionale afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate ne lidhje me drejtesine per te miturit.

Transferimin ne menyre graduale te te gjitha ambjenteve te komisariateve, ngritjen dhe funksionimin e tyre jo vetem per te rriturit por edhe per te miturit si dhe krijimin e mundesive rehabilituese me standartet bashkekohore .

Ne te gjitha keto synime prioritare per t'u realizuar nga Ministria e Drejtesise, eshte gjetur mbeshtetje e posaçme e autoriteteve dinjotoze nderkombetare si UNICEF dhe Qeveria Suedeze SIDA. Para pak kohesh ne institucionin tone u lançua nje projekt 3-vjeçar me keta bashkepunetore, me synimin e vetem "Reforma ne sistemin e drejtesise per te miturit", i cili kryesisht prek sistemin e paraburgimit dhe penitenciar per minorenet qe kane kryer vepra penale, pa lene menjane zbatimin e prioriteteve te lartpermendura.

Ne perfundim do te doja te theksoja se, besoj qe te gjithë jane te mendimit se kerkohet te behet me shume per problematikat e ngritura, per te krijuar, organizuar e zhvilluar institucione, mekanizma dhe rregulla lidhur me struktura kombetare, kordinuese dhe interaktive per çeshtjet e femijerise dhe adoleshences, per ngritjen e njesive te ngarkuara me perpunimin e te dhenave dhe kryerjen e studimeve lidhur me keto çeshtje e keshtu me rradhe. Ministria e Drejtesise njeh dhe vlereson bashkepunimin me Institucionin e

Avokatit te Popullit ne zhvillimin e sistemit te drejtesise per te miturit, duke marre ne konsiderate dhe zbatuar rekomandimet e dhena prej tij. Institucioni yne eshte nje nga kontribuesit e rendesishem ne kete fushe. Pergjegjesia, funksionet e drejtimit kryesor te punes se institucioneve te tjera, ndoshta kerkojne hartimin dhe miratimin e dispozitave ligjore te posaçme dhe akteve nenligjore qe mendojme se mund dhe duhet te hartohen e miratohen per kete qellim.

Faleminderit !



# **SISTEMI I DREJTESISË PËR TË MITUR NËN KENDEVESHTRIMIN E KOMITETIT SHQIPTAR TE HELSINKIT**

**Prof.As.Dr Vasilika HYSI**

Drejtoreshë Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

**Etilda SALIU**

Perfaqesuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Te nderuar pjesemarrës,

Parasegjithash do të deshiroja të falenderoja institucionin e Avokatit të Popullit për tematin e perzgjedhur për Konferencën vjetore të tij dhe për ftesën që i ka bërë Komitetit Shqiptar të Helsinkit për të sjellë vlerësimet e veta për sistemin e drejtësisë penale për të mitur në Shqipëri.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit si organizata e parë e të drejtave të njeriut në Shqipëri ka një përvojë të gjatë në fushën e vezhgimit të respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe atë të të miturve në veçanti. Kryesisht, KSHH-ja ka vezhguar respektimin e të drejtave të femijëve në komisariate, në vendet e paraburgimit, në burgje dhe respektimin e disa të drejtave të të miturve në procesin penal. Gjithashtu, gjatë këtij viti, KSHH-ja bëri objekt të punës së tij studimin e legjislativës dhe praktikën e lidhur me të drejtën e mbrojtjes falas dhe vlerësimin e paketës ligjore të përgatitur nga eksperte të Ministrisë së Drejtësisë me mbështetjen e UNICEF-it<sup>1</sup>. Përsa i përket trajtimit të të miturve në vendet e paraburgimit dhe burgjeve, KSHH-ja vezhgoi nga afër respektimin e të drejtave të të miturve në këto institucione.

Në këtë referat do të ndalemi në disa momente të rëndësishme të sistemit të drejtësisë penale të të miturve.

Që në fillim do të donim të theksonim se ndonëse kanë kaluar 13 vjet nga ratifikimi i konventës “Për të drejtat e femijëve” dhe me pas janë miratuar një sërë dokumentesh të tjera ndërkombëtare, *sistemi i drejtësisë penale për të mitur është ende larg standarteve të përcaktuara jo vetëm në dokumentat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, por edhe në vete standartet e përcaktuara nga legjislativi shqiptar*. Është arritur në këtë përfundim nisur jo vetëm nga analiza që i është bërë zhvillimit të reformës ligjore në këtë fushë, por edhe nga ballafaqimi i mjeteve që parashikon nga legjislativi shqiptar lidhur me trajtimin e të miturve dhe zbatimin e tyre në praktike.

## **1. E tashmja e sistemit të drejtësisë penale të të miturve**

Nëse do të hidhnin një vështrim të organeve që përbejnë sistemin e drejtësisë penale për të mitur dhe organet e tjera që kanë lidhje me të mund të themi se në secilin prej tyre janë shënuar progres, por ka njohur edhe ngecje ose deshtime. Po përpiqemi në mënyrë të përbledhur të paraqesim të tashmen e këtij sistemi dhe hapat që sygjerohen sit e domosdoshme të ndermeren në të ardhmen e afert.

**A. Sistemi aktual i drejtësisë penale për të mitur është me shumë i orientuar drejt ndeshkimit të personit të mitur sesa rehabilitimit të tij.**

Kushdo mund te arrije lehte ne kete perfundim, mnese analizon reformen ligjore te realizuar deri tani dhe zbatimin e saj, sidomos politiken penale qe ndiqet ndaj te miturve.

Reforma ligjore e ndermarre qe prej vitin 1995 me miratimin e Kodit penal dhe procedural penal ka hedhur bazat ligjore te nje trajtimi te veçante te te miturve - autor te veprave penale. Por shume prej ketyre elementeve kane mbetur ne leter dhe jane te pazbatueshme ne praktike. Ne kete drejtim do te donin te sillnin ne vemendjen tuaj, faktin se shume prej te miturve nen moshen e pergjegjesise penale qe kryejne krime nuk mund te trajtohen nga specialiste psikologe dhe punonjes sociale, ne qendra ditore ose te perhershme, pasi qendra te tilla, te percaktuara nga ligji si **qendra edukimi nuk funksionojne** qe prej vitit 1992. Keta te mitur lihen ne fatin e ruges dhe pa asnje mundesi rehabilitimi. Ne te njejten pozite ndodhen edhe ata te mitur qe kane arritur moshen e pergjegjesise penale dhe te cilet gjykata krijon bindjen e brendeshme se ata duhet te perjashtohen nga denimi me burgim.

Alternativat e denimit me burgim si: puna ne interes publik, pezullimi i denimit me burgim dhe venia ne prove e te miturit jane ose te pazbutueshme ose ne rast se zbatohet jane jo efektive. Ndonese kane kaluar 10 vjet nga miratimi i kodit penal, ende **nuk jane ngritur strukturat mbikqyrese** qe duhet te mbikqyrin te miturit gjate kohes se proves. Per rrjedhoje, kontrolli i gjykates mbi efektivitetin e vendimit te marre mungon dhe se revokimi i nje mase te tille te zbatuar nga gjykata i lihet faktin nese i mituri eshte kapur per kryerjen e nje veprave penale po aq te rende ose me te rende.

Pra del e qarte se ne kete rast drejtesia vepron vetem kur i mituri eshte rifutur perseri ne krim dhe kjo eshte qe eshte evidentuar nga strukturat perkatese.

Kushtetuta e RSH dhe kodi penal percaktojne mbrojtjen e femijeve narkomane dhe rehabilitimin e tyre. Deri me sot masat mjekesore qe mund te zbatohet ndaj te miturve qe jane te varur nga droga dhe kryejne krime nuk zbatohet. Mungon nje qender e **trajtimit mjekesore dhe pedagogjike** qe do te mundesonte rehabilitimin e tyre. Shpesh here gjyqtaret vihen ne veshtiresi per te zbatuar masat mjekesore ndaj personave te tille dhe alternative e vetme e tyre eshte denimi me burgim. Ne vendet e vuajtjes se denimit mungon kujdesi e veçante per trajtimin dhe rehabilitimin e personave narkomane.

Ne praktiken e gjykatave shqiptare, **zbatimi i masave shtrenguese dhe te denimit me burgim nuk shihen gjithnje si mjeti i fundit.** Per shkak te mungeses se akteve neligjore dhe strukturave perkatese, prokuroret dhe gjyqtaret vihen shpesh ne pozite te veshire lidhur me trajtimin e te miturit. Para tyre shtrohen vetem dy alternative: ose te lene te miturin te lire dhe pa kontroll ose te marrin masen e arrestit ndaj tij.

**Zbatimi i mases se arrestit ndaj te miturve** jo ne pak raste shoqerohet me shkelje te te drejtave te tyre, me perjashtim te rretheve Tirane dhe qarkut te Shkodres, ku te miturit qe kryejne krime vendosen ne institucionin 313 dhe ne institucionin e Shenkollit, Lezhe, ne rrethet e tjera ata mbahen ne komisariate qe kane nje infrastrukture teje te vjeter, duke qendruar se bashku me persona madhore (per shkak te mbipopullimit dhe mungeses te mjediseve te veçanta), dhe duke shkelur nje sere te drejtash te tyre.

E drejta e mbrojtjes eshte e detyrueshme ne rastet e procedimit te te miturve dhe ne rast pamundesie per te patur nje avokat, organi i prokurorise ose

gjykata i cakton te miturit kryesisht nje avokat te paguar nga shteti. Nga anketat<sup>2</sup> e zhvilluara me persona te arrestuar dhe te denuar, me prokurore, gjyqtare dhe avokate ne rrethin e Tiranes per te drejten e mbrojtjes rezulton se sherbimi ligjor falas eshte e shpeshte ne praktiken gjyqesore dhe se ne te shumten e rasteve ai i eshte afruar te miturve. Ne disa raste kjo e drejte nuk ushtrohen ne momentet e pyetjes se te miturit ne polici dhe se cilesia e ketij sherbimi le shume per te deshruar.

***Ndihma ligjore jo vetem ofrohet nga avokate te rinj dhe me pervojte te paket profesionale, por ne te shumten e rasteve ata nuk jane te specializuar ne çeshtjet e drejtesise per te mitur.***

Persa i perket ***ndihmes psikologjike***, me perjashtim te gjykates se krimeve te renda dhe gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, ku fale nje bashkepunimi me Kliniken ligjore te te miturve ky sherbim ofrohet, ne gjykatat e tjera, gjyqtaret hasin ne veshtiresi per te garantuar kete sherbim ndaj te miturve. Nga kontaktet me punonjes te policise, prokurorise dhe gjykates ne keto rrethe rezulton se ky lloj sherbimi nuk ofrohet kur i mituri eshte ne komisarjat.

Kushtet e paraburgimit ne komisarjate jane teje te renda. ***Mundesia e vazhdimet te edukimit dhe formimit profesional mungojne.*** Mungojne mjetet e komunikimit revistat, degjimi i radios dhe TV, duke cenuar rende kerkesat e ligjit "Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim". Zbatimi i afateve te njejta te paraburgimit si per miturit dhe te rriturin, cenon rende zhvillimin fizik dhe psikologjik te te miturve. Raportet e vezhgimit te Komitetit Shqiptar te Helsinkit<sup>3</sup> dhe te organizatave te tjera si Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve, kushtet e trajtimit te femijeve ne keto institucione jane te renda dhe jashte standarteve.

Nese i referohemi veprave penale te gjykuara me autor te miturin dhe ***politiken e denimit te te miturve*** gjate periudhes 2002-2004, rezulton se shumica e veprave penale jane krime dhe se denimi me burgim eshte denimi kryesor i zbatuar nga gjykatat.

Orientimi i politikës penale drejt denimit me burgim shpesh eshte e kushtezuar nga fakti se te miturin gjykohen ne gjendje arresti dhe per rrjedhoje jo ne pak raste gjykatat japin denimi baraz me periudhen e paraburgimit ose ata s'kane alternative te tjeter.

Deri me sot eshte shkëlur rende kerkesa e ligjit per gjykimin e te miturve nga gjyqtare te seksioneve te te miturve, pasi ***seksionet e te miturve*** nuk jane ngritur ende.

Jo e mire paraqitet trajtimi i te miturve ne ***vendet e vuajtjes se denimit me burgim.*** Te miturit ndaj te cileve gjykata ka caktuar denimin me burgim vendosen ne institucionin e Vaqarit. Megjithë perpjekjet e bera per te permiresuar kushtet ne keto institucione, trajtimi i te miturve nuk eshte ne perputhje me standartet e duhura.

**B. Modeli i sistemit te drejtesise penale per te mitur ne Shqiperi eshte me shume i orientuar te autori i krimit sesa te viktimat dhe rehabilitimi i saj.**

Ndonese te miturit jane shpesh viktimat te krimit ne familje dhe jashte saj, te krimeve te renda siç eshte trafikimi, sistemi i drejtesise penale nuk ofron nje mbrojtje te veçante te interesave me te larta te femijes.

Deri me sot, reforma ne sistemin e drejtesise penale ka qene e orientuar ne ashpersimin e ligjit per te ndeshkuar rende autoret e krimeve ndaj te miturve.

Ky orientim i politikës penale duhet vlerësuar pozitivisht, por nuk është i mjaftueshëm dhe efektiv. Praktika tregon se përballë sistemit të drejtësisë penale, të miturit-viktimit shpesh viktimizohen për herë të dytë, pasi atyre **nuk i ofrohet ndihma ligjore dhe psikologjike e nevojshme** dhe shpesh shihen nga drejtësia si burim me vlerë për të siguruar të dhëna rreth autorit dhe vepres së kryer.

Deri më sot janë ndermarre nisma për **te rritur aftësitë profesionale të punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve** lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, të trajtimit të të miturve- autor dhe viktimave të krimit. Për fat të keq, në rradhet e policisë vihet re mungesa e përdorimit të burimeve njerezore të trajnuara, levizje në detyrë të persona ose mungesë e lehtësira për të zbatuar njohuritë e përfituara në trajnime. Kjo gjendje ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e të drejtave të të miturve. Një problem i tillë, ndonëse me pak i shprehur haset edhe në rradhet e organeve të procedimit dhe të gjyqimit.

Një problem tjetër i pranishëm në sistemin e drejtësisë penale është se në shumë rrethë, punonjësit e policisë dhe organi i prokurorisë nuk kanë informacionin e duhur **rreth mundësive që ekzistojnë për të lehtësuar trajtimin e femijëve viktime** (ndihma nga OJF-te, qendra sociale, etj.) ose këto lloj shërbimesh mungojnë në shumë prej qyteteve jashtë Tiranës.

## **2. Si duhet të jete e ardhmja e sistemit të drejtësisë penale të të miturve?**

Specialistët e praktikës dhe përfaqësues të të drejtave të femijëve janë të mendimit se sistemi i drejtësisë penale për të mitur duhet të reformohet. KSHH-ja ka përshëndetur reformën e ndermarre nga Ministria e Drejtësisë me mbështetje të UNICEF-it për ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe ligjeve të tjera që lidhen me sistemin e Drejtësisë penale për të mitur, nismën e SIDA-s dhe të Save of Children për të mbështetur ngritjen dhe forcimin e seksionit të të miturve pranë Avokatit të Popullit. Por reforma e inicuar nuk është e mjaftueshme.

Më qellim rritjen e efektivitetit të drejtësisë penale të të miturve dhe mbrojtjen e interesit me të lartë të femijës do të ishte e nevojshme që përmirësimet e legjislativës për të mitur **duhet të shoqërohen me përkatitjen aktive nenligjore përkatëse që do të mundësojnë zbatimin e ligjeve në praktikë**. Miratimi i ndryshimeve, pa hartuar në të njëjtën kohë edhe aktet nenligjore të nevojshme do të sjellë probleme, vonës ndoshta dhe nevojën e rishikimit të mëvonshëm të këtyre ndryshimeve.

Nga ana tjetër, **ne këtu proces reformimi të sistemit të drejtësisë penale, mbrojtja e të miturve duhet të shihet në të dy këndvështrimet: mbrojtja e të miturve autor dhe viktime e krimit**.

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur duhet të orientohet me shumë drejtë denimeve alternative të denimit me burgim sesa të denimi me burgim. Krahas përmirësimeve ligjore, **është e nevojshme evidentimi i shërbimeve sociale, publike dhe private që ekzistojnë** dhe nevoja e ngritjes së shërbimeve të tjera të cilat do të kujdesen për të miturit e përjashtuar nga denimi, për shkak moshës ose rrezikshmërisë së vepres dhe të tij.

**Përfshirja e psikologut në proces** vlerësohet si një masë e rëndësishme. Jemi të mendimit se ky proces duhet të shoqërohet me përcaktimin e rolit të psikologut, kriteret që duhet të përmbushë ai, roli i tyre në trupin gjyqësor, etj.

Sistemi aktual i drejtesise, sidomos organet e procedimit penal dhe gjykatat penale duhet te zhvillojne hetime me te shpejta dhe te zbatojne gjykimet e posaçme me qellim qe te **kufizojne kohën e mbajtjes se te miturve ne paraburgim**. Nje rol te rendesishem ne kete drejtim luan edhe Dhoma Kombetare te Avokatise e cila duhet te sigurojne ndihme juridike efektive dhe ndaj te miturve ne çdo faze te procesit penal dhe se ne listen e avokateve kryesisht duhet te jene jo vetem avokate te rinj dhe me pervojte te paket profesionale, por avokate te kualifikuar ne fushen e te drejtave te femijeve.

Krijimi i njesive te veçanta ne sherbimet e policise per te asistuar ne ngjarjet qe kane per autore ose subjekt te miturit, **specializimi i oficereve te policise gjyqesore** me njohuri ne fushen e psikologjise se te miturit, per pyetjen e tyre do te ishte e nevojshme.

KSHH –ja sygjeron qe Ministri i Drejtesise, pas nje studimin te ngarkeses se çeshtjeve ku pale eshte i mituri, te vendose gjykatat prane te cilave mund te ngrihen seksionet e te miturve dhe t'i kerkoje Presidentit te RSH te dekretoje ngritjen e **seksioneve per te miturit**. Krahas kesaj nisme, trajnimit dhe kualifikimit e oficereve te policise gjyqesore, te prokuroreve dhe gjyqtareve jane te nevojshme te vazhdohen.

Pjese e reformes duhet te jete edhe sistemi i paraburgimit dhe vuajtjes se denimit per te miturit. **Institucionet e trajtimit te te miturve duhet te kategorizohen** dhe ne institucionet ekzistuese duhet te merren masa per permiresimin e infrastruktures se tyre me qellim qe keto vende te ofrojne kushte per edukimin dhe riintegrimin e te miturve. Reforma e institucioneve te trajtimit te te miturve qe kryejne nje veper penale dhe kane nevojte per nje trajtim te veçante kerkon ngritjen e e nje sistemi institucionesh te hapura, ½ te hapura dhe te mbyllura. **Percaktimi i tyre duhet te behet ne te njejten kohe me miratimin e ndryshimeve, pasi ligjet e ndryshuara do te mbetet te pazbatuara**. Ky proces duhet te shoqerohet me pergatitjen e rregulloreve te tyre.

**Monitorimi i respektimit te te drejtave te miturve** ne kontakt me sistemin e drejtesise penale eshte nje element teje i rendesishem. Krahas rolit te mekanizmave te brendshem kontrollues sidomos te prokurorise dhe te gjykates, rendesi kane organet monitoruese te jashtme, nder te cilat Institucioni i Avokatit te Popullit dhe organizatat monitoruese te te drejtave te njeriut.

Roli i tyre jo vetem monitorues, por edhe rekomandues do te mundesojne evidentimin e shkeljeve, sinjalizimin e organeve kompetente; do te kontribuojne ne marrjen e masave per ecurine e reformes se sistemit te drejtesise penale te te miturve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit do te vazhdoje te kontribuojne ne permiresimin e sistemit te drejtesise per te mitur me qellim qe ky sistem jo vetem te ndertohet sipas standarteve te duhuara, por edhe te funksionojne ne perputhje me interesat e femijes ne kontakt me to. KSHH-ja do te vazhdoje te jete nje vezhgues aktiv dhe i vemendshem i respektimit te te drejtave te te miturve ne kontakt me sistemin e drejtesise penale.

- 1 *Studimi i sistemit të drejtësisë për të mitur, e tashmja dhe e ardhmja e tij mund të gjeni të botuar në punimin me temë "Sistemi i drejtësisë penale për të mitur në Shqipëri, Reflektime mbi të tashmen dhe të ardhmen e tij, botim i KSHH-së, Tiranë 2005.*
- 2 *E drejta e mbrojtjes falas në Shqipëri (probleme të teorisë dhe të praktikës), botim i KSHH-së, Tiranë, 2005, f. 24 -36.*
- 3 *Për më gjerë shih respektimin e të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve në Shqipëri, përfundime të vëzhgimeve të KSHH-së, Tiranë 2005.*

# KRIMINALITETI NGA DHE NDAJ FEMIJEVE, DUKURITE, TIPARET E TIJ DHE MBROJTJA E TE DREJTAVE TE TYRE NGA POLICIA

## Luan MULLAJ

Shef i Sektorit per Mbrojtjen e Femijeve, Drejtoria kunder Akteve Terroriste dhe Krimeve te Hapura, Ministria e Brendshme

Te nderuar pjesmarres ne Konferenca,

Te pergjegjshem per misionin dhe detyrat ne drejtim te mbrojtjes se femijeve, ne respektim dhe zbatim te legjislacionit ne fuqi dhe akteve nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne, duke respektuar lirite dhe te drejtat themelore te njeriut e ne vecanti te femijeve strukturat me objekt pune te drejtperdrejte mbrojtjen e femijeve ne Policine e Shtetit si; Sektori per Mbrojtjen e Femijeve, Sektori Luftes Kunder Trafikeve te Paligjshme, por edhe struktura te tjere si ; Sektori i Policimit ne Kumunitet, Sektori i Policise Rrugore, Sektori i Policise se Rendit, Sektori i Luftes Kunder Krimeve ndaj Personit dhe Pasurise, Sektori Luftes Kunder Droges, etj nga piramida ne baze vecanerisht gjate dy viteve te fundit /2004-2005/ kane demonstruar perkushtim, profesionalizem, pergjegjshmeri dhe transparenc ne realizimin e objektiveve dhe detyrave ne kete drejtim.

Gjithashtu detyrimet dhe detyrat e planeve te veprimit te Strategjise Kombetare per Femijet, Strategjise Kombetare Kunder Trafikimit te Femijeve dhe Mbrojtjes se Femijeve Viktima te Trafikimit, rekomandimet e Komitetit per te Drejtat e Femijeve te OKB-se, se fundi edhe rekomandimet e Reporterit Special te OKB-se per "Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografine e Femijeve" si dhe detyrat funksionale te saj dhe ato te ngritura enkas per kete qellim ne vazhdimesi kane rritur pergjegjesit, kapacitetet dhe rezultatet ne evidentimin e krimeve te kryera nga femijet dhe krimeve te kryera kunder femijeve, por edhe kundermasave me te shpejta, me efektive ne zbulimin, parandalimin, dokumentimin dhe venien e autoreve para drejtesise.

Per te qene sa me korrekt e transparent dhe per te njohur konkretisht kriminalitetin nga dhe ndaj femijeve dukurite dhe tiparet e tij te viteve te fundit, une po i referohem studimit statistikor per kete qellim te cilin po e bej present, si vijon :

Gjate periudhes se viteve **2000 – 2004** implikimi i femijeve, autor ne vepra te ndryshme penale ka qene si me poshte:

Per vepren penale te "**Vrasjes**" jane evidentuar gjithsej 911 autore prej te cileve 18 ose 2% kane qene te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale te "**Kanosjes per vrasje**" jane evidentuar gjithsej 907 autore prej te cileve 31 ose 3.4% te tyre jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale te "**Vrasjes nga pakujdesia**" jane evidentuar gjithsej 45 autore prej te cileve 5 ose 11.1% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 5 ose 11.1% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale te "**Plagosje rende me dashje**" jane evidentuar gjithsej 1157 autore prej te cileve 2 ose 0.1% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 39 ose 3.37% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale te "**Plagosje nga pakujdesia**" jane evidentuar gjithsej 95 autore prej te cileve 6 ose 6.3% e tyre jane te moshes deri 14 vjeç dhe 13 ose 13.6% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Plagosje e lehte me dashje**" jane evidentuar gjithsej 1094 autore prej te cileve 15 ose 1.3% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 130 ose 11.8% jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale te "**Tentative vrasje**" jane evidentuar gjithsej 1078 autore prej te cileve 2 ose 0.1% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 41 ose 3.8% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per **krime seksuale** jane evidentuar gjithsej 21 autore prej te cileve 1 ose 4.7% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 3 ose 14.2% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Marrdhenie seksuale me te mitur**" jane evidentuar gjithsej 93 autore prej te cileve 1 ose 1% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 19 ose 20.4 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Marrdhenie seksuale me dhune**" jane evidentuar gjithsej 196 autore prej te cileve 8 ose 4% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Tentative per marrdhenie seksuale me dhune**" jane evidentuar gjithsej 122 autore prej te cileve 7 ose 5.7% prej tyre jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Rrembim personi**" jane evidentuar gjithsej 149 autore prej te cileve 2 ose 1.3% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Heqje e paligjshme e lirise**" jane evidentuar gjithsej 58 autore prej te cileve 1 ose 1.7% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Ushtrim prostitucioni**" jane evidentuar gjithsej 51 autore prej te cileve 2 ose 3.9% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Shfrytezim i femrave per prostitucion**" jane evidentuar gjithsej 50 autore prej te cileve 3 ose 6% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje e pasurise**" jane evidentuar gjithsej 536 autore prej te cileve 12 ose 2.2% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 53 ose 9.8% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje lokale tregtie**" jane evidentuar gjithsej 847 autore prej te cileve 16 ose 1.8% e tyre jane te moshes deri 14 vjeç dhe 159 ose 18.7% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje banese**" jane te evidentuar gjithsej 1072 autore prej te cileve 26 ose 2.4% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 184 ose 17.1% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje makinash**" jane evidentuar gjithsej 544 autore prej te cileve 33 ose 6% e tyre jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per **vjedhje te tjera** jane evidentuar gjithsej 1865 autore prej te cileve 75 ose 4% e tyre jane te moshes deri 14 vjeç dhe 242 ose 12.9% e tyre jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Tentative vjedhje me arme e dhune**" jane evidentuar gjithsej 76 autore prej te cileve 5 ose 6.5% e tyre jane te moshes deri 14 vjeç dhe 13 ose 17.1% e tyre jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje me dhune**" jane evidentuar gjithsej 606 autore prej te cileve 6 ose 0.9% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 58 ose 9.5% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.



Per vepren penale "**Vjedhje me arme**" jane evidentuar gjithsej 633 autore prej te cileve 40 ose 6.3% e tyre jan ete moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "Vjedhje me pasoje vdekjen" jane evidentuar gjithsej 41 autore prej te cileve 5 ose 12.1% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Tentative vjedhje**" jane evidentuar gjithsej 209 autore prej te cileve 8 ose 3.8% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Mashtrim**" jane evidentuar gjithsej 330 autore prej te cileve 2 ose 0.6% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Shkaterrim i prones me zjarr**" jane evidentuar gjithsej 67 autore prej te cileve 1 ose 1.4% eshte l moshes deri 14 vjeç dhe 3 ose 4.4% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Shkaterrim i prones me eksploziv**" jane evidentuar gjithsej 77 autore prej te cileve 2 ose 2.5% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Shkaterrim i prones me mjete te tjera**" jane evidentuar gjithsej 427 autore prej te cileve 11 ose 2.5% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 24 ose 5.6% jane te moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale "**Fallsifikim te monedhave**" jane evidentuar gjithsej 145 autore prej te cileve 7 ose 4.8% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Fallsifikim i dokumenteve zyrtare**" jane evidentuar gjithsej 1922 autore prej te cileve 1 ose 0.05% jane eshte l moshes deri 14 vjeç dhe 48 ose 2.4% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Shperndarje e substancave te ..**" eshte evidentuar gjithsej 1 autor l moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime kunder punonjesit shteteror**" jane evidentuar gjithsej 132 autore prej te cileve 1 ose 0.7% eshte l moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime kunder punonjesit te policise**" jane evidentuar gjithsej 97 autore prej te cileve 1 ose 1% eshte l moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vrasje e punonjesit te policise**" jane evidentuar gjithsej 30 autore prej te cileve 3 ose 10% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Kundershtim i punonjesit te policise**" jane evidentuar gjithsej 971 autore prej te cileve 2 ose 0.2% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 10 ose 1% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Armembajtje pa leje**" jane evidentuar gjithsej 1660 autore prej te cileve 4 ose 0.2% jane te moshes 14 deri 18 vjeç dhe 71 ose 4.2% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Trafik droge**" jane videntuar gjithsej 101 autore prej te cileve 2 ose 1.9% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Prodhim, shitje, transportim ..**" jane evidentuar gjithsej 1103 autore prej te cileve 2 ose 0.1% e tyre jane te moshes deri 14 vjeç dhe 30 ose 2.7% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime ne fushen e drejtesise**" jane evidentuar gjithsej 132 autore prej te cileve 4 ose 3% jane te moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale "**Trafikim i femrave per prostitucion**" jane evidentuar gjithsej 495 autore prej te cileve 1 ose 0.2% eshte l moshes deri 14 vjeç dhe 7 ose 1.4% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Kalim i paligjshem i kufirit**" jane evidentuar gjithsej 973 autore prej te cileve 1 ose 0.1% eshte l moshes deri 14 vjeç dhe 123 ose 12.6% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per **vepra penale te ndryshme** jane evidentuar gjithsej 1248 autore prej te cileve 7 ose 0.5% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 46 ose 3.6% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Marrje pengu**" jane evidentuar gjithsej 104 autore prej te cileve 1 ose 0.9% eshte i moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale "**Ndihme per kalim te paligjshem te kufirit**" jane evidentuar gjithsej 155 autore prej te cileve 5 ose 3.2% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

**Kurse per vitin 2005** deri me 30 Tetor **jane evidentuar autore si me poshte:**

Per vepren penale "**Vrasje**" jane evidentuar gjithsej 110 autore prej te cileve 10 ose 9% e tyre jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vrasje ne tentative**" jane evidentuar gjithsej 116 autore prej te cileve 1 ose 0.8% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 9 ose 7.7% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vrasje nga pakujdesia**" jane evidentuar gjithsej 6 autore prej te cileve 1 ose 16.6% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Plagosje e rende me dashje**" jane evidentuar gjithsej 154 autore prej te cileve 1 ose 0.6% eshte i moshes deri 14 vjeç dhe 16 ose 10.3% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Plagosje nga pakujdesia**" jane evidentuar gjithsej 12 autore prej te cileve 2 ose 16.6% jane te moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale "**Plagosje e lehte me dashje**" jane evidentuar gjithsej 404 autore prej te cileve 3 ose 0.7% jane te moshes deri 14 vjeç dhe 67 ose 16.5% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Kanosje per vrasje**" jane evidentuar gjithsej 272 autore prej te cileve 1 ose 0.3% eshte i moshes deri 14 vjeç dhe 13 ose 4.7 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Tentative per marrdhenie seksuale**" jane evidentuar gjithsej 23 autore prej te cileve 3 ose 13% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Marrdhenie seksuale ose homoseksuale me te mitur**" jane evidentuar gjithsej 10 autore prej te cileve 1 ose 10% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Marrdhenie seksuale ose homoseksuale me dhune deri 14 vjeç**" jane evidentuar gjithsej 4 autore prej te cileve 1 ose 25% eshte i moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Tentative rembim personi**" jane evidentuar gjithsej 5 autore prej te cileve 1 ose 20% eshte i moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Ushtrim prostitucioni**" jane evidentuar gjithsej 13 autore prej te cileve 2 ose 15.3% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Shtytja e te miturve ne krim**" jane evidentuar gjithsej 2 autore prej te cileve 2 ose 100% jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Kundershtim i punonjesit te policise**" jane evidentuar gjithsej 145 autore prej te cileve 5 ose 3.4 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vepra penale kunder punonjesit te shtetit**" jane evidentuar gjithsej 65 autore prej te cileve 1 ose 1.5 % eshte i moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vepra te tjera penale kunder personit”** jane evidentuar gjithsej 161 autore prej te cileve 2 ose 1.2 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 6 ose 3.7 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje ndermarrje e firma te tjera prodhuese”** jane evidentuar gjithsej 11 autore prej te cileve 2 ose 18.1 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje lokale tregtie”** jane evidentuar gjithsej 106 autore prej te cileve 16 ose 15 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 35 ose 33 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje banese”** jane evidentuar gjithsej 95 autore prej te cileve 14 ose 14.7 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 30 ose 31.5 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje makine”** jane evidentuar gjithsej 52 autore prej te cileve 6 ose 11.5 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje te tjera”** jane evidentuar gjithsej 520 autore prej te cileve 38 ose 7.3 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 125 ose 24 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Tentative vjedhje”** jane evidentuar gjithsej 87 autore prej te cileve 4 ose 4.5 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 19 ose 21.8 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje banese me dhune”** jane evidentuar gjithsej 9 autore prej te cileve 1 ose 11.1 % eshte i moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje me dhune te tjera”** jane evidentuar gjithsej 75 autore prej te cileve 12 ose 16 % jane te moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje me arme te tjera”** jane evidentuar gjithsej 25 autore prej te cileve 2 ose 8 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Tentative vjedhje me arme”** jane evidentuar gjithsej 11 autore prej te cileve 4 ose 36.3 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim prone me zjarr”** jane evidentuar gjithsej 18 autore prej te cileve 1 ose 5.5 % eshte i moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim prone me eksploziv”** jane evidentuar gjithsej 9 autore prej te cileve 1 ose 11.1 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim prone me mjete te tjera”** jane evidentuar gjithsej 84 autore prej te cileve 4 ose 4.7 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 12 ose 14.2 % jane te moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim i rrugeve”** jane evidentuar gjithsej 7 autore prej te cileve 4 ose 57.1 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim ujesjellsave”** jane evidentuar gjithsej 2 autore prej te cileve 1 ose 50 % jane te moshes 14 deri 18 vjeç.

Per vepren penale **“Kalim i paligjshem kufiri”** jane evidentuar gjithsej 100 autore prej te cileve 3 ose 3 % jane te moshes deri 14 vjeç dhe 14 ose 14 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Tentative kalim kufiri”** jane evidentuar gjithsej 12 autore prej te cileve 2 ose 16.6 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Dhenie ndihme per kalim kufiri”** jane evidentuar gjithsej 108 autore prej te cileve 4 ose 3.7 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Tentative per shfrytezim prostitucioni”** jane evidentuar gjithsej 2 autore prej te cileve 1 ose 50 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Tentative per trafik femijesh”** jane evidentuar gjithsej 2 autore prej te cileve 1 ose 50 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Trafik mjetesh motorike”** jane evidentuar gjithsej 45 autore prej te cileve 1 ose 2.2 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Kontrabante me mallrat e tjera”** jane evidentuar gjithsej 105 autore prej te cileve 2 ose 1.9 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Fallsifikim monedhash”** jane evidentuar gjithsej 27 autore prej te cileve 2 ose 7.4 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Fallsifikim dokumentash zyrtare”** jane evidentuar gjithsej 545 autore prej te cileve 37 ose 6.7 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Shitje, shperndarje narkotikesh”** jane evidentuar gjithsej 80 autore prej te cileve 6 ose 7.5 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Trafikim i narkotikeve”** jane evidentuar gjithsej 34 autore prej te cileve 1 ose 2.9 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Kultivim i bimeve narkotike”** jane evidentuar gjithsej 173 autore prej te cileve 2 ose 1.1 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Armembajtje pa leje”** jane evidentuar gjithsej 138 autore prej te cileve 9 ose 6.5 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Deshmi, kallzim i rreme”** jane evidentuar gjithsej 17 autore prej te cileve 1 ose 5.8 % jane te moshes 14 deri nen 18 vjeç.

**Ndersa femije te demtuar/viktima te krimit sipas viteve jane:**

**Te demtuar per vitin 2000**

Per vepron penale **“Klime kunder jetes”** jane evidentuar gjithsej 689 te demtuar prej te cileve 66 ose 9.5% jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Vrasje me dashje”**, jane evidentuar gjithsej 306 te demtuar prej te cileve 19 ose 6.2% jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Klime kunder shendetit”**, jane evidentuar gjithsej 171 te demtuar prej te cileve 12 ose 7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Klime seksuale”**, jane evidentuar gjithsej 94 te demtuar prej te cileve 48 ose 51 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Klime kunder lirise se personit”**, jane evidentuar gjithsej 59 te demtuar prej te cileve 24 ose 40.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Klime kunder moralit”**, jane evidentuar gjithsej 132 te demtuar prej te cileve 61 ose 46.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Vepra penale te tjera kunder personit”**, jane evidentuar gjithsej 741 te demtuar prej te cileve 89 ose 12 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Vjedhje”**, jane evidentuar gjithsej 913 te demtuar prej te cileve 56 ose 6.1 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Vjedhje me dhune”**, jane evidentuar gjithsej 386 te demtuar prej te cileve 26 ose 6.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale **“Mashtrome”**, jane evidentuar gjithsej 149 te demtuar prej te cileve 1 ose 0.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim i prones”**, jane evidentuar gjithsej 125 te demtuar prej te cileve 2 ose 1.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

#### **Te demtuar per vitin 2001**

Per vepren penale **“Krime kunder jetes”** jane evidentuar gjithsej 566 te demtuar prej te cileve 47 ose 8.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vrasje me dashje”**, jane evidentuar gjithsej 237 te demtuar prej te cileve 20 ose 8.4 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime kunder shendetit”**, jane evidentuar gjithsej 133 te demtuar prej te cileve 9 ose 6.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime seksuale”**, jane evidentuar gjithsej 64 te demtuar prej te cileve 30 ose 46.8 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime kunder lirise se personit”**, jane evidentuar gjithsej 45 te demtuar prej te cileve 12 ose 26.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime kunder moralit”**, jane evidentuar gjithsej 78 te demtuar prej te cileve 17 ose 21.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vepra penale te tjera kunder personit”**, jane evidentuar gjithsej 727 te demtuar prej te cileve 61 ose 8.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje”**, jane evidentuar gjithsej 736 te demtuar prej te cileve 5 ose 0.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje me dhune”**, jane evidentuar gjithsej 286 te demtuar prej te cileve 9 ose 3.1 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim i prones”**, jane evidentuar gjithsej 133 te demtuar prej te cileve 1 ose 0.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

#### **Te demtuar per vitin 2002**

Per vepren penale **“Krime kunder jetes”** jane evidentuar gjithsej 451 te demtuar prej te cileve 46 ose 10.1 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vrasje”**, jane evidentuar gjithsej 206 te demtuar prej te cileve 20 ose 9.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime kunder shendetit”**, jane evidentuar gjithsej 194 te demtuar prej te cileve 25 ose 12.8 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime seksuale”**, jane evidentuar gjithsej 80 te demtuar prej te cileve 48 ose 60 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime kunder lirise se personit”**, jane evidentuar gjithsej 32 te demtuar prej te cileve 3 ose 9.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Krime kunder moralit”**, jane evidentuar gjithsej 52 te demtuar prej te cileve 10 ose 19.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje te pasurise “**, jane evidentuar gjithsej 1219 te demtuar prej te cileve 5 ose 0.4 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Vjedhje me dhune, me arme”**, jane evidentuar gjithsej 266 te demtuar prej te cileve 4 ose 1.5 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Shkaterrim i prones”**, jane evidentuar gjithsej 124 te demtuar prej te cileve 4 ose 3.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale **“Trafikim i qenieve njerezore”** jane evidentuar gjithsej 379 te demtuar prej te cileve 24 ose 6.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

#### **Te demtuar per vitin 2003**

Per vepren penale **“Krime kunder personit”** jane evidentuar gjithsej 1730 te demtuar prej te cileve 272 ose 15.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder jetes**" jane evidentuar gjithsej 489 te demtuar prej te cileve 60 ose 12.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vrasje**", jane evidentuar gjithsej 166 te demtuar prej te cileve 13 ose 7.8 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder shendetit**", jane evidentuar gjithsej 135 te demtuar prej te cileve 19 ose 14 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime seksuale**", jane evidentuar gjithsej 99 te demtuar prej te cileve 60 ose 60.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder lirise se personit**", jane evidentuar gjithsej 36 te demtuar prej te cileve 12 ose 33.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder moralit**", jane evidentuar gjithsej 3 te demtuar prej te cileve 1 ose 33.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje te pasurise**", jane evidentuar gjithsej 1694 te demtuar prej te cileve 32 ose 1.8 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje me dhune**", jane evidentuar gjithsej 119 te demtuar prej te cileve 5 ose 4.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje me arme**" jane evidentuar gjithsej 112 te demtuar prej te cileve 9 ose 8% jane te moshes deri 18 vjeç.

Per vepron penale "**Shkaterrim i prones**", jane evidentuar gjithsej 221 te demtuar prej te cileve 2 ose 0.9 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Trafikim i qenieve njerezore**"jane evidentuar gjithsej 699 te demtuar prej te cileve 32 ose 4.5 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

#### **Te demtuar per periudhen Janar- Shtator 2004**

Per vepron penale "**Krime kunder personit**" jane evidentuar gjithsej 1707 te demtuar prej te cileve 179 ose 10.4 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder jetes**" jane evidentuar gjithsej 360 te demtuar prej te cileve 35 ose 9.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vrasje**", jane evidentuar gjithsej 108 te demtuar prej te cileve 5 ose 4.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder shendetit**", jane evidentuar gjithsej 105 te demtuar prej te cileve 12 ose 11.4 % jane te moshes deri 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime seksuale**", jane evidentuar gjithsej 82 te demtuar prej te cileve 43 ose 52.4 % jane te moshes deri 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder lirise se personit**", jane evidentuar gjithsej 24 te demtuar prej te cileve 6 ose 25 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje te pasurise**", jane evidentuar gjithsej 2012 te demtuar prej te cileve 46 ose 2.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje me dhune**", jane evidentuar gjithsej 105 te demtuar prej te cileve 8 ose 7.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Vjedhje me arme**" jane evidentuar gjithsej 78 te demtuar prej te cileve 1 ose 1.2 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Trafikim i qenieve njerezore**"jane evidentuar gjithsej 548 te demtuar prej te cileve 26 ose 4.7 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

#### **Te demtuar per periudhen Janar – Qershor 2005**

Per vepron penale "**Krime kunder personit**" jane evidentuar gjithsej 1053 te demtuar prej te cileve 235 ose 22.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepron penale "**Krime kunder jetes**" jane evidentuar gjithsej 214 te demtuar prej te cileve 25 ose 11.6 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vrasje**", jane evidentuar gjithsej 69 te demtuar prej te cileve 7 ose 10.1 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime kunder shendetit**", jane evidentuar gjithsej 65 te demtuar prej te cileve 8 ose 12.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime seksuale**", jane evidentuar gjithsej 44 te demtuar prej te cileve 24 ose 54.5 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime kunder lirise se personit**", jane evidentuar gjithsej 11 te demtuar prej te cileve 5 ose 45.4 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Krime kunder moralit**", jane evidentuar gjithsej 1 te demtuar prej te cileve 1 ose 100 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vjedhje te pasurise**", jane evidentuar gjithsej 1346 te demtuar prej te cileve 20 ose 1.4 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vjedhje me dhune**", jane evidentuar gjithsej 60 te demtuar prej te cileve 6 ose 10 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Vjedhje me pasoje vdekjen**" jane evidentuar gjithsej 3 te demtuar prej te cileve 1 ose 33.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Per vepren penale "**Trafikim i qenieve njerezore**" jane evidentuar gjithsej 171 te demtuar prej te cileve 4 ose 2.3 % jane te moshes deri nen 18 vjeç.

Pra kjo eshte tabloja zyrtare e policise e zhvillimit te kriminalitetit tek femijet nese do benim nje krahasim te thjeshte referuar te dhenave numerike dhe ne perqindje te paraqitura do arrinim lehtesishte ne konkluzionin se krimi nga femijet eshte ne rritje sikurse edhe krimi kunder femijeve ne periudha te caktuara ka qene gjithashtu ne rritje.

#### **Dukurite dhe tiparet e tij konsistojne kryesishte ne keto drejtime:**

Shperndarja gjeografike e femijeve te perfshire ne veprimtarine kriminale(krime te kryera nga femijet) varion ne ndryshim nga viti ne vit dhe konkretisht ne periudhen **2000 – 2005** femijet i gjejme te implikuar ne numer dhe ne perqindje me te larte ne veprat penale si "**Vjedhje pasurie**", "**Vjedhje lokale tregtie**", "**Vjedhje banese**", "**Tentative vjedhje me arme e dhune**", "**Vjedhje me dhune**", "**Vjedhje me arme**", "**Vjedhje te tjera**", "**Armembajtje pa leje**", "**Prodhim, shitje, transportim i narkotikeve**", "**Kalimi paligjshem i kuifirit**" dhe "**Marrdhenie seksuale me te mitur**", etj.

Ne te njejtin plan po te shikojme edhe shperndarjen gjeografike persa i perket krimeve te kryera ndaj femijeve gjate periudhes **2000 – 2005** femijet i gjejme si objekt te veprave penale me se shumti te; **Krimeve Seksuale, Krime kunder lirise se personit, Krime kunder moralit, Vjedhje me dhune, Vetvrasje**, etj.

Duke analizuar dhe vleresuar gjendjen e paraqitur me lart me realizem, pergjegjshmeri dhe profesionalizem, mbrojtja e femijeve dhe te drejtave te tyre nga policia, edhe ne te ardhmen do perbej nje perparesi ne punen e strukturave te Policise se Shtetit, vecanerishte te policise kriminale dhe asaj ne komunitet, per te mundesuar njohjen me mire te situates ne ambjente ku mesojne, argetohen dhe frenkuentohen nga femije, vecanerisht ne terriore te njohura si problematike, te varfera apo me kriminalitet te larte ne te kaluaren, si dhe tek kategorite me probleme sociale apo kanunore ne zona te vecanta. E gjithë kjo per te patur mundesi reale per parandalimin e akteve kriminale nga dhe ndaj femijeve dhe venien e autoreve para drejtesise.

Vec sa me siper nuk dua te le pa permendur edhe nje dukuri sporadike jo te kendshme, qe kemi pasur edhe raste ku persona te vecante nga personeli i

policise kane tejkeluar kompetencat dhe kane shkelur te drejtat e femijeve gjate shoqerimit apo ndalimit te tyre te cilat kur jane konstatuar apo bere present jane analizuar e ndeshkuar pa hezitim sipas rregulloreve ne polici dhe ligjit. **Veprimet e kundraligjshme ndaj femijeve nuk kane tolerance.**

Deshiroj te theksoj edhe nje dukuri qe cdo dite behet me shqetesuese, rritjen e numrit te femijeve perdorues te duhanit dhe alkoolit dhe indiferencen e institucioneve shkollore e me gjere ne kete drejtim, fenomen ky qe po ta shikosh dhe analizosh gjeresishte, ky kontigjent eshte shume afer perdoruesve te droges dhe terren i gatshem per shperndaresit e transportuesit e saj, etj. Ndaj mendoj se ketij fenomeni duhet qendruar fort, nga institucionet, shkolla, komuniteti, media per nje edukim, kulture e qendrim ndryshe, te mbeshitetur fort edhe nga sherbimet e policise.

Ne jemi te ndergjegjshem vec sa me lart se cdo arme e shkrepur, cdo viktime e trafikuar, cdo sasi droge e kultivuar apo tranzituar dhe e pakapur, cdo fytyre e pafajshme femije pas hekurave te ngujimit, cdo incident, cdo aksident rrugor, cdo lloj dhune e shfaqur kudo, jane dukuri negative qe prishin gjumin dhe enderrat e femijeve. Prandaj jemi te vendosur per te bere qe keta femije te mos jene me te frikesuar



# **ROLI I PUSHTETIT VENDOR NE MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE FEMIJEVE**

## **Olta DEMI**

Specialiste prane Bashkise se Tiranës

Mbrojtja e femijeve dhe sigurimi i te drejtave te tyre eshte nje nga çeshtjet baze qe duhet te perfshihen ne politikat dhe veprimet konkrete te çdo shteti. Perballja me efikase e çeshtjes se femijeve eshte ajo bazuar ne te drejtat e tyre dhe jo ne nevojat. Kjo per arsyen se trajtimi i femijeve si individe me nevoja, sjell premtime nga ana e organeve te shtetit, nderkohe qe trajtimi i tyre si individe me te drejta, sjell detyrime dhe pergjegjesi te drejtperdrejta. Kjo eshte dhe linja qe ndjek Bashkia e Tiranës ne lidhje me femijet, gje qe pasqyrohet konkretisht si ne strukturen e saj organizative ne mbrojte te te drejtave te femijeve, ashtu edhe ne programet dhe veprimet konkrete qe ndermerren ne interesin me te larte te tyre.

### **Baza ligjore**

Shteti Shqiptar ka ratifikuar Konventen Nderkombetare baze "Mbi te drejtat e femijeve", si dhe dy konventat e Organizates Nderkombetare te Punes ne lidhje me moshen minimale te punes se femijeve dhe format me te rrezikshme te punes se femijeve. Jane keto dy konventa qe perbejne instrumenta referimi jo vetem ne nivel qeveritar, por edhe ne menyren e funksionimit te Bashkise se Tiranës ne pergjithesi dhe te Sektorit per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne veçanti.

Ligji nr. 8652, date 31.7.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" percakton qarte pergjegjesite qe ka pushteti vendor lidhur me sherbimet sociale per qytetaret, ku natyrisht perfshihen e dhe femijet.

Po ashtu, ne Ligjin nr. 9355, date 10.3.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore" parashikohen konkretisht detyrimet e organeve te pushtetit vendor ne percaktimin dhe shperndarjen e ndihmes dhe sherbimeve shoqerore, ku femijet jane perseri nje kategori e konsiderueshme perfituesish.

Gjithashtu, Kodi i Familjes institucionalizon rendesine dhe kontributin konkret te organeve te pushtetit vendor ne proçedurat e kujdestarise per femijet, ku perseri Bashkia e Tiranës vjen me veprime konkrete ne zbatim te tij.

Strategjia Kombetare e Femijeve, hartuar nga Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, eshte gjithashtu nje dokument i rendesishem ne te cilin bazohet Bashkia e Tiranës ne mbrojtje te te drejtave te femijeve, pasi aty percaktohen qarte kategorite e femijeve ne nevoje, theksohet pjesemarrja e tyre si element shume i rendesishem ne mbrojtje te te drejtave te tyre dhe krijimi i departamenteve per mbrojtjen e te drejtave te femijeve. Ne zbatim te kesaj strategjie, permenden pak me poshte hapat konkrete te ndermarre nga Bashkia e Tiranës.

## **Veprimet konkrete**

### **1. Struktura Administrative**

Rregullorja per organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administrates se Bashkise se Tiranës. Ne kete rregullore percaktohen ne menyren me elokuate dhe te detajuar misionet dhe detyrat e Drejtorise se Pergjithshme se Sherbimeve dhe Burimeve Njerezore dhe Drejtorise se Sherbimeve Njerezore, pjese e se ciles eshte dhe Sektori per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve.

Ne vitin 2001 u krijua per here te pare ne Bashkine e Tiranës Departamenti i Sherbimeve Sociale. Menjehere pas krijimit, ky Departament realizoi Studimin e nevojave per informacion dhe sherbime sociale ne qytetin e Tiranës. Nga ky studim, perfundimi me i rendesishem ishte perparesia qe perbente çeshtja e femijeve ne Tirane. Ne zbatim te ketij perfundimi, u moren iniciativa konkrete per femijet, qe ne nivel administrativ pasqyrohen ne dy vendimet e Keshillit Bashkiak qe permenden me poshte.

- Vendimi i Keshillit Bashkiak nr. 87, date 22.11.2002, ku vendoset per krijimin e Sektorit per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve dhe
- Vendimi i Keshillit Bashkiak nr. 11, date 10.3.2004, ku vendoset per krijimin e Sektorit te Politikave Arsimore. Nepermjet ketij te fundit, nderhyrja ne lidhje me femijet behet ne menyre me te strukturuar dhe me efikase.

Vendimi i Keshillit Bashkiak nr. 14, date 10.03.2004 per krijimin Qendres Ekonomike te Zhvillimit dhe Edukimit se Femijeve. Kjo strukture, funksionon ne varesi te Bashkise se Tiranës dhe trajton femijet e çerdheve dhe ka ne strukturen e saj rreth 15 punonjes sociale dhe psikologe.

### **2. Sherbime Sociale**

Programet dhe projektet konkrete qe jane relizuar ne Bashkine e Tiranës ne mbrojtje te femijeve dhe te drejtave te tyre jane mese te shumta ne numer, si dhe shumedimensionale. Keto veprime konkrete ne mbrojtje te te drejtave te femijeve konsistojne ne themelimin dhe funksionimin e qendrave te perbashketa me OJF te ndryshme per ofrimin e sherbimeve sociale per kategorine e femijeve dhe jo vetem. Mund te permendim:

- Qendra e perbashket me shoqaten "Everychild", ku ofrohen sherbime sociale per femijen dhe familjen, kryesisht raste te parandalimit te largimit te femijes nga familja biologjike dhe institucionalizimit te tyre, si dhe ndihme ne sherbimin e kujdestarise dhe integrimin e femijeve me aftesi te kufizuara ne kopshte e shkolla. Ne lidhje me sherbimin e kujdestarise, siç eshte parashikuar edhe ne Kodin e familjes, prane Bashkise se Tiranës eshte ngritur me urdher te Kryetarit dhe Komisioni Keshillimor i Kujdestarise, me qellim ofrimin e asistences teknike ne organizimin e punes dhe dokumentacionit per sherbimin e kujdestarise, rekomandime, hartimin e rregulloreve te sherbimit etj, si dhe asistences ne shqyrtimin e rasteve te nderlikuara te kujdestarise.
- Po perfundojne procedurat per krijimin e dy qendrave te perbashketa komunitare multidisiplinare per femijet dhe familjen. Keto dy qendra

strehohen ne asete te Bashkise se Tiranes dhe mbeshteten financiarisht nga Banka Boterore. Bashkia e Tiranes mbulon nje pjese te konsiderueshme te shpenzimeve operative te funksionimit te tyre dhe dy vjet pas fillimit te funksionimit, do te kalojne plotesisht ne varesi te saj.

Gjithashtu, Sektori i Mbrojtjes se te Drejtave te Femijeve eshte angazhuar ne realizimin e shume projekteve sociale ne bashkepunim me OJF te ndryshme. Ketu permendim:

- Projekti "Masa imediate per Mbrojtjen e Femijeve ne Rruge" (viti 2003) realizuar ne bashkepunim me Sherbimin Social Nderkombetar per femijet ne rruge, ku pervec studimit te situates, u ofrua ndihme konkrete ne mbeshtetjen materiale te familjeve dhe te vete femijeve, nepermjet integritit te tyre ne sistemin arsimor.
- Projekti "Oborri i nenes dhe femijes" ne bashkepunim me shoqaten Christian Children Fund, nepermjet te cilit u ofruan sherbime sociale multidisiplinare per femijet dhe nenat ne zona periferike te qytetit te Tiranes, duke bere pjese aktive te kesaj nderhyrjeje edhe komunitetin e zonave.
- Projekti "Klasat e Integruara" ne bashkepunim me shoqaten Femijet e Botes - Shqiperi, nepermjet te cilit u ngriten klasa te integruara ne disa shkolla te zonave periferike te Tiranes duke bashkepunuar me drejtorite perkatese te shkollave per venien ne dispozicion te mjediseve te shkolles si dhe mjetet e mesimit, qe nevojiten per zhvillimin e oreve te mesimit. Qellimi i ketij projekti ishte qe te integrimi progresiv i femijeve ne klasat normale me fillimin e vitit te ri shkollor, ndersa per rastet me te veshtira ofrimi ndaj ketyre femijeve i nje minimumi njohurish arsimore.
- Projekti "Sherbime Sociale per Femijet ne Rruge ne qytetin e Tiranes", financuar nga UNICEF. Ky projekt konsiston ne perpjekjet per zbutjen dhe gradualisht eliminimin e fenomenit te femijeve qe lypin apo punojne ne rruget e qytetit. Kjo do te realizohet nepermjet bashkerendimit te sherbimeve qe shoqatat dhe institucionet e ndryshme ofrojne per kete kategori femijesh.
- Krijimi i Senatit te Femijeve ne Nivel Lokal, si nje stzrukture e qendrueshme mbeshtetese dhe konsultative. Qellimi i Senatit te Femijeve eshte aktivizimi i tyre ne procesin e vendimarrjes nepermjet nje zeri te diferencuar qe sjell drejtpersedrejt problematikate e ndryshme ne te gjitha fushat e zhvillimit te femijeve.
- Projekti i Fluorizimit, i cili po implementohet ne bashkepunim me Ministrine e Shendetesise dhe konsiston ne trajnimin e edukatoreve dhe prinderve te femijeve ne çerdhe ne lidhje me shendetin oral te femijeve, si dhe ne ofrimin e tabletave te fluorit per trajtimin e tyre.
- Projekti "Sistemi i moniroimit te punes se femijeve ne Shqiperi", i cili realizohet ne bashkepunim me Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te barabarta dhe financohet nga Organizata Nderkombetare e Punes dhe Programi kunder punes se femijeve (ILO / IPEC) dhe konsiston ne institucionalizimin e nje sistemi per monitorimin e punes se femijeve ne tre qytete pilot, si dhe ne trajtimin e rasteve femijesh qe punojne.

- Eshte miratuar me Vendim te Keshillit Bashkiak nr. 01, date 17.02.2005 perjashtimi i disa kategorive femijesh nga pagesa e çerdheve dhe kopshteve dhe aktualisht, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit te Femijeve po kryen nje studim te mbeshtetur nga UNICEF per perfshirjen e kategorive te tjera femijesh dhe familjesh ne nevoje e me probleme sociale ne kete perjashtim nga pagesa.
- Eshte miratuar gjithashtu me Vendim te Keshillit Bashkiak nr. 39, date 30.07.2004 dhenia e stimulit material per nxenesit e arsimit publik me nota te shkelqyera. Kjo eshte nje ndermarrje shume pozitive nga ana e Bashkise se Tiranes, si institucion qe mbeshtet jo vetem femijet me ne nevoje, por stimulon edhe ata qe kontribuojne pozitivisht ne zhvillimin e vendit.
- Po keshtu, me Vendim te Keshillit Bashkiak nr. 40, date 20.07.2005 eshte miratuar projekti “Te mesojme duke vepruar”, nepermjet te cilit Bashkai e Tiranes ka vene nje shume te konsiderueshme ne dispozicion te krijimit te 12 klubeve nxenesish ne tre shkolla periferike te Tiranes, ku organizohen aktivitete te ndryshme edukative dhe rikrijuese.
- Organizim i aktiviteteve te shumta te pervitshme ne ditet kombetare dhe nderkombetare te te drejtave te femijeve dhe te te drejtave te kategorive specifike te tyre. Ne keto aktivitete theksohet gjithmone mosdiskriminimi i femijeve, respektimi i te drejtave te tyre, degjimi i zerit te tyre, etj. Me raste festash organizohen gjithmone jo vetem aktivitete festive, por edhe shperndarje dhuratash per ta. Te institucionalizuara jane tashme aktivitetet per festen e 1 Qershorit, per festat e fundvitit, per ditet nderkombetare te femijeve me aftesi te kufizuara, etj.

## **FEMIJET E TRAFIKUAR. ASPEKTI KOMBETAR DHE NDERKOMBETAR**

**Lida LESKAJ**

Koalicioni Shqiptar “Bashke Kunder Trafikimit te Femijeve”

Tematika qe Konferenca e sotme diskuton tregon se institucionet shteterore shqiptare desherojne te marrin pergjegjesite qe i ngarkon shtetit ratifikimi prej tij i konventes se te drejtave te femijeve ne vitin 1992.

Ata qe nuk marrin ushqimin e pershtashem per rritje, veshje dhe banesa te pershtatshme, ata qe nuk i çojne ne shkolla, ata qe nuk i kurojne kur kane nevoje dhe nuk marrin dashurine e nevojshme per zhvillim, nuk kane mundesi t i kerkojne e ti plotesojne vete keto te drejta te domosdoshme, per aresyen e vetme se jane akoma te vegjel.

Shoqeria civile ka punuar e punon sh. mire per per plotesimin e nevojave baze te ketyre femijeve, duke marre persiper pergjegjesi qe prinderit e tyre shpesh nuk i njohin. Pas disa vitesh pune disa organizata qe punojne me femijet kane kuptuar se vetem duke koordinuar veprimet e tyre mund te jene te sukseshem ne menjanimit te formave te ndryshme te abuzimit te femijeve dhe zeri i tyre mund te degjohet nga institucionet shteterore dhe keto te fundit te nxiten per veprim.

Une perfaqesoj ne kete konference Koalicionin shqiptar “Bashke Kunder Trafikimit te Femijeve”, i cili ka filluar te funksionoj si i tille ne shtator te vitit 2002. Koalicioni perbehet nga 13 organizata jofitimprures, vendase dhe te huaja, qe kane aktivitete konkrete per te luftuar trafikimin e femijeve. Qellimi i Koalicionit eshte qe te bashkoje dhe kordinoje perpjekejet, mundesite dhe eksperiencen e te gjitha anetareve te saj per te mbrojtur femijet shqiptare prej trafikimit, shfrytezimit dhe abuzimit duke respektuar parimin e “interesit me te larte te femijes” si dhe parimet e tjera te Konventes te te Drejtave te Femijeve si dhe te gjitha legjislacionin kombetare e nderkombetare.

Fushat e aktivitetit te anetareve te BKTF jane Parandalimi i trafikimit te femijeve, duke nderhyre me programe te posacme per femijet ne nevoje apo ne rrezik trafikimi, Mbrojtja e femijeve viktima te trafikut apo te llojeve te tjera te abuzimit, Kthimi Vullnetar i Asistuar dhe Riintegrimi. Anetaret ne bashkepunim te ngushte me njeri-tjetrin, me institucionet shteterore si dhe me organizata te tjera qe sigurojne sherbime ne nje ose me shume nga fushat e siperpermendura.

Se bashku ata jane bere nje ze i vetem ne mbrojtje te femijeve ne dy nivele kryesore: ligjor dhe operativ.

Koalicioni BKTF u krijua dhe e perqendroi veprimtarine e tij ne luften kunder trafikimit, pasi trafikimi perben nje nga shkeljet me te renda te te drejtave te femijeve shqiptare.

### **Situata ne Shqiperi**

Eshte e veshtire te konkludohet me saktesi nese gjate ketyre viteve qe BKTF ka ushtruar aktivitetin e saj ka rene apo jo numri i femijeve shqiptare te

trafikuar, kjo per faktin se duke qene nje veprimtari ilegale qe kryhet ne fshehtesi, eshte e veshtire krijimi i nje sistem te plote te dhenash per femijet e trafikuar ne shkalle vendi e per vende te ndryshme. Edhe ne vendet ku keta femije ndodhen, shtetet perkatese nuk kane te shifra te femijeve te trafikuar por pranohet qe fenomeni i trafikut ka prekur rende femijet shqiptare, te cilet perdoren per qellime te shfrytezimit seksual, lypje, vjedhje, shperndarje droge, forma te tjera te puneve jo legale.

Nder faktoret qe kane ndikuar ne vazhdimesine e ekzistences se fenomenit mund te permendim situaten ekonomike. Varferia eshte shumedimensionale. Nuk eshte vetem papunesia por tani njerezit jane ndergjegjesuar per te drejtat e tyre themelore dhe kane pritshmeri per t'i gezuar keto te drejta, te kene nje pune, te shkojne ne shkolla afer banesave te tyre, te kene akses ne sherbimet shendetesore, te ndihen te mbrojtur.

Sistemi i edukimit eshte limituar ne dhenien e dijeve duke injoruar krizat personale te te rinjve duke harruar raportet humane e duke falimentuar ne permbushjen e qellimit i cili eshte zhvillimi i personalitet te femijes ne teresi.

Migirmin e brendshem, ka bere qe popullsia e zonave informale te krijuara prane qyteteve te medhenj, te konfrontohet me mungesen e plote te sherbimeve publike.

Mungesa e sigurise publike ben qe prindet te shohin te ardhmen e femijeve te tyre jashte vendit, duke mos marre parasysh rreziqet qe u kanosen femijeve te tyre ne keto vende Mungesen e aftesive te qendrueshme prinderore, te cilat vazhdojne te krijojne terren favorizues per trafikimin e qenieve njerezore, vecanerisht te femijeve.

Duke filluar nga viti 2003 e tutje, shteti shqiptar ka marre masa te ndryshme per te luftuar fenomenin. Keshtu mund te permendim ndryshimet ne Kodin Penal. Por mund te konfirmojme gjithashtu se prioriteti kryesor i shtetit ka qene kapja dhe penalizimi i trafikanteve, duke bere pak ose aspak per parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave e duke lene kete fushe te rendesishme te mbulohej vetem nga shoqeria civile.

Ndonese ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise jane parashikuar sanksione te renda per personat qe organizojne dhe kryejne trafikimin e femijeve, vihet re se gjate proceseve gjyqesore kjo nuk merret ne konsiderate. (Referoju nenit 128.b). Gjithashtu, ka boshlleqe ne legjislacionin per te miturit, i cili ndikon ne asistencen ndaj viktimave te trafikimit, mungesa e gjykatave per te miturit ka krijuar mundesine e gjykimit jo profesional e me pasoja per jeten e femijes.

Ajo qe shteti shqiptar nuk ka arritur te adresojte ende eshte varferia e familjeve te femijeve qe trafikohen, diskriminimi qe vuajne shumica prej ketyre familjeve si ne jeten sociale por ashtu edhe ne arsim dhe ne tregun e punes. Nga ana tjeter mungesa e nje sistemi te plote funksional per mbrojtjen e femijeve e ben te lehte abuzimin e ketyre te fundit kurdo e nga kushdo.

Ne se nje sistem i tille do te funksiononte strukturat publike te ngarkuara do te nderhynin menjehere, ne momentin qe femija kercenohet nga abuzimi, edhe kur ky kercenim vjen nga vete anetaret e familjes se femijes. Ndryshimet e koheve te fundit ne legjislacion(kodi i familjes) krijojne nje mundesi te tille, por fatkeqesisht kjo mundesi nuk eshte perdorur nga institucionet shteterore qe ju eshte caktuar kjo detyre si psh prokuroria, sherbimet sociale shteterore dhe gjykatat. Gjithashtu dhe koordinimi i nevojshem, ne vecanti ne nivel lokal, midis ketyre institucioneve per te realizuar detyrat e tyre ka munguar.

Cdo dite shohim femijet qe lypin ne rruget e Tiranes, Shkodres apo qyteteve te tjera. Dhe te gjithë e dime se ata jane preja me e pare dhe me e lehta per trafikantet. Shpesh prindet e tyre jane pjese e rrjetit te trafikut. Keta femije pesojne cdo dite abuzim shumedimensional, trafikohen brenda vendit dhe shume prej tyre perfundojne pertej kufijve, megjithate nderhyrjet nga institucionet publike per kete kategori deri tani kane munguar.

Nje deshire e vullnet me i madh i forcave te rendit per te zbuluar e vene para ligjit shfrytezuesit e ketyre femijeve, do te mbronte qindra femije te detyruar me force per te mospatur femijeri.

Nuk eshte shume e zoreshme te zbulosh kush eshte dhe si vepron rrjeti i personave qe shoqerojne emigrante ilegale femije, duke ditur se ne cdo fshat ka me dhjetra femije te larguar, per te cilet prinderit kane paguar udhetimin e tyre ilegal. Kjo do deshire per ta bere. Eshte shume e kollajshme te presesh ne zyre deshmime e nje viktime te trafikut per ta percjelle me pas dosjen ne gjykate.

### **Femijet e pashoqeruar jashte shtetit**

Nese flasim per trafikim pertej kufirit, nje grup mjaft vulnerabel femijesh jane dhe femijet e pashoqeruar 14 - 18 vjec, te cilet shume here largohen me miratimin e prinderve, sapo kane mbaruar 8 klase, per te punuar e per te ndihmuar familjet, duke marre keshtu pergjegjesi te parakoheshme per moshen e tyre. Nje pjese e tyre perfundojne ne rrjetet e trafikanteve per te paguar udhetimin e tyre duke kryer veprimtari ilegale si shperndarje droge, vjedhje, perdoren per prostitucion etj. Te tjeret mbeten gjithmone te rrezikuar.

Procesi i riintegrimit te femijeve viktime te trafikimit eshte vecanerisht i rendesishem sepse nepermjet tij femijes se trafikuar i krijohen mundesi per tu riintegruar ne jeten familjare dhe komunitare. Nese kjo nuk do te mund te arrihej, konteksti ne te cilin ndodh trafikimi do te vazhdonte te ekzistonte dhe femija do te rindodhej ne rrezik trafikimi. Ne situaten aktuale, mund te themi se ka boshlleqe te medha ne sherbimet riintegruese per femijet e trafikuar apo ne risk trafikimi. Si rezultat, femijet e trafikuar te cilet jane deportuar ose kthyer ne vendin e tyre shpesh ritrafikohen. Shkaqet kryesore te fenomenit te ritrafikimit mbetet deportimi i femijeve duke mos zbatuar te drejten e tyre per nje kthim te asistuar dhe te programuar ne vendin e origjines

Sipas standardeve dhe normave nderkombetare e drejta e cdo femije per te jetuar ne familje do te thote ne princip se eshte ne interesin me te mire te femijes per t'u kthyer prane familjes se tij. Sidoqofte, vendimi per riatdhesimin e minoreneve duhet te marre ne konsiderate nje numer faktoresh, perfshire ketu situaten familjare te femijes ne vendin ku jeton, deshiren e femijes, dhe te familjes dhe oportunitetet/mundesite qe i jepen femijes ne vendin ku jeton pas riatdhesimit. Duke marre ne konsiderate eksperiencat e anetareve te BKTF-se mund te pohojme se shume here ne rastet riatdhesimit te te miturve shqiptare, kryesisht nga Greqia, kjo te jete bere ne perputhje me standartat nderkombe-tare per riatdhesimin e te miturve e ne zbatim te parimit te interesit me te larte te femijes.

Duhet thene se sherbimet per femijet viktime te trafikimit nuk jane adekuate dhe nuk u pergjigjen nevojave te tyre per rehabilitim dhe ri-integrimin e femijeve ne te gjithë vendin. Ato afrohen vetem ne qendra rezidenciale ne disa qytete te rendesishme.

## **Bashkepunimi ndershteteror**

Per te luftuar trafikimin dhe mbrojtur femijet e trafikuar apo ne rrezik trafikimi jashte kufijve te Shqiperise, shteti shqiptar duhet te bashkepunoje ngushte me autoritet e shteteve perkatese.

Bashkepunimi midis shoqerise civile shqiptare dhe atyreve ne vendet e tranzit/destinacionit, me qellim mbrojtjen e ketyre femijeve ka kohe qe eshte nje realitet qe ka dhene rezultat e veta. Keshtu Koalicioni BKTF ka nje bashkepunim te mire me shoqerine civile greke dhe italiane, bashkepunim qe eshte facilituar nga shoqatat homologe ne keto vende. Eksperinca te tilla bashkepunimi ekzistojne dhe me Kosoven dhe Sllovenine e vende te tjera.

Persa i perket bashkepunimit midis autoriteteve shteterore shqiptare dhe atyre te huaja, ne mbrojtje te femijeve shqiptare, duhet theksuar qe ky bashkepunim ka filluar tashme. Koalicioni BKTF do te deshiron te pershendeste vendimin e Qeverise shqiptare per te nenshkruar nje marreveshje dypaleshe me Greqine lidhur me mbrojtjen e femijeve shqiptare te trafikuar apo ne rrezik trafikimi ne Greqi. Gjithashtu edhe prezenca e perfaqesuesve te autoriteteve te disa prej vendeve fqinje ne kete konference eshte nje prove e bashkepunimit qe tashme ekziston.

Ky bashkepunim duhet te synoje mbrojtjen pa diskriminim te te gjitha femijeve shqiptare qe ndodhen jashte kufirit te vendit, me fokus te vecante tek femijet e pashoqeruar pasi ata perbejne nje kategori majft vulnerabel. Kjo mbrojtje e ketyre femijeve do te ndihmonte ne identifikimin e viktimave te trafikut midis tyre, si dhe ne parandalimin e trafikimit te femijeve te tjere brenda ketij grupi. Shteti shqiptar duhet te bashkepunoje me autoritet e huaja ne menyre qe te marrin fund praktika te tilla si burgimi i femijeve dhe deportimi i tyre vetem sepse jane te pashoqeruar e pa dokumentet qe mundesojne qendrimin e tyre ne vend.

Menyra me efikase per te parandaluar trafikimin e femijeve si brenda vendit ashtu dhe jashte tij eshte dhenia e mundesive reale per zhvillim ketyre femijeve. Duke respektuar Konventen e te drejtave te femijeve duhet degjuar dhe respektuar vullneti i ketyre femijeve ne cdo vendim qe do te merret per ta. Disa praktika te mire ne kete drejtim, te cilat mund te shfrytezohen nga institucionet shteterore shqiptare jane bere te mundura si pasoje e punes se shume organizatave, disa prej tyre te pranishme ne kete takim.

### **Roli i medias:**

Duke qene nje mjet i fuqishem informimi, media duhej te kishte patur nje rol te rendesishem per parandalimin e fenomenit te trafikut te qenieve njerzore e te femijeve ne vecanti. Fatkeqsisht, per mungese profesionaliteti dhe etike, jo rralle ka ndodhur qe media te luaje nje roj negativ, duke keqperdorur nje informacion per qellime marketingu, duke te deformuar, etiketues dhe paragjykuar femijen viktime te trafikut.

Ne artikujt e gazetave fenomeni i trafikimit te qenieve njerezore, ku perfshihet edhe trafikimi i femijeve, trajtohet ne menyre standarte.

Femijet viktime te trafikimit shpesh penalizohen dhe ne shume prej tyre nuk ruhet anonimati, duke u shkelur ne menyre flagrante e drejta e femije - viktime e trafikimit e duke vene ne rrezik jeten e tij . Kjo e ka trembur shoqerine civile



qe punon ne kete fushe te bashkepunoje me median. E kunderta duhet te ndodhe/ te filloje nje bashkepunim me i madh me median, me qellim perdorimin e ketij mjeti te fuqishem, qe deperton ne cdo familje, per informimin dhe edukimin e popullates.

### **Rezultate te BKTF-se**

Si arritje kryesore te koalicionit te BKTF-se gjate ketyre viteve kunder trafikimit te femijeve, mund te permendim: kontributin qe dhane anetaret ne hartimin e Strategjise Kombetare Kunder Trafikimit te Femijeve, dokument i cili pret rinjohjen nga qeveria aktuale dhe zbatimin nepermjet nje plani veprimi per te mos mbetur vetem ne leter. Permiresimi i dokumentit te Mekanizmit Kombetar te Referimit; draft - marreveshjet dypaleshe midis qeverise se Shqiperise dhe asaj te Greqise; dhe qeverise se Mbreterise se Bashkuar mbi Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikimit, standartet e riadhesimit te te miturve te pashoqeruar; amendimi i ligjit per regjistrimin e femijeve, komente mbi dokumentin e Standardeve te Sherbimeve Sociale, komente mbi licensimin e siguruesve te sherbimeve shoqerore; komente mbi dokumentin e Standardeve te Femijeve ne Qendrat Rezidenciale, komente per strategjine e shperndarjes se sherbimeve sociale jane dokumenta te tjera per te cilat anetaret e BKTF-se kane dhene kontributin e tyre.

Ne kuadrin e perpjekjeve te te gjitha shoqerise civile te perfshire ne luften kunder trafikimit te femijeve, BKTF ka zhvilluar programe kerkimore dhe investigime mbi situatat qe lidhen me trafikimin e femijeve ne Shqiperi, fushata advokuese qe targetojne qeverine dhe politikeberesit, aktivitete parandaluese per femijet me te riskuar ndaj trafikimit, akomodim dhe mbrojtje per femijet e trafikuar; programe mbeshtetese riintegruese, te tilla si ndermjetesim me familjen, trajnime profesionale dhe mundesi punesimi.

Anetaret e BKTF-se mbulojne me aktivitetet e tyre pothuajse te gjitha territorin e e Shqiperise. Vetem gjate dy viteve te fundit ata kane asistuar 128 femije te trafikuar, nga te cilet 70% ndodheshin jashte Shqiperise dhe po aq jane me origjine rome ose egjiptian, pjesa me e madhe e tyre eshte perdorur per lypje. Ndersa numri i femijeve te asistuar me qellim parandalimin e trafikimit te tyre, mbrojtjen nga abuzimi, riadhesimi dhe reintegrmi arrin ne disa dhjetra mije. Analizimi i te dhenave te grumbulluara nga te gjitha anetaret e koalicionit orienton programet dhe aktivitetet e seicilit per te ardhmen.

### **Disa rekomandime**

Krijimi i sistemit per mbrojtjen e femijeve e shtrire ne te gjitha instancat e pushtetit lokal.

Pergatitja e politikave te detajuara per kthimin, mbrojtjen, trajtimin he riintegrimin psikosocial te viktimave te trafikut, te

# PERQASJA E LEGJISLACIONIT SHQIPTARE ME ATE TE KOMUNITETIT EVROPIAN NE FUSHEN E TE DREJTAVE TE NJERIUT

## Edvin DULE

Specialist prane Ministrise se Integritimit

Te nderuar pjesemarrres,

Ne emer te Ministrise se Integritimit kam nderin dhe kenaqesine per te falenderuar organizatoret e ketij seminari per ftesen e bere per te marre pjese ne kete tryeze te rendesishme si dhe per mundesine e dhene per te referuar per nje ceshtje shume sensitive, ne kuader te te drejtave te njeriut, sic eshte mbrojtja dhe respektimi i te drejtave te femijeve.

Se pari, do te theksoja qe respektimi i te drejtave te njeriut, konsiderohet si nje nga shtyllat mbi te cilat eshte themeluar dhe qendron Bashkimi Evropian, si dhe nje nga Kriteret kryesore te Kopenhagenit per anetaresimit e vendeve aspirante ne Bashkimin Evropian. Ky kriter politik ka qene dhe vazhdon te jete ne qender te diskutimeve ne nivele dhe formate te ndryshme takimesh te zhvilluara ndermjet Komisionit Evropian dhe Shqiperise ne kuader te procesit te Stabilizim-Asociimit.

Vlen te theksohet qe ceshtja e respektimit te te drejtave te njeriut, dhe femijeve ne vecanti, ne perputhje me standartet evropiane dhe instrumentat nderkombetare, ka qene pjese e rekomandime apo raporteve te ndryshme te hartuara nga Komisioni Evropian ne lidhje me situaten e pergjithshme ne Shqiperi.

Me konkretisht, Raporti i fundit i Komisionit Evropian (Nentor 2005) ne lidhje me fushen e respektimit te te drejtave te femijeve theksonte " *rendesine e treguar nga strukturat e shtetit shqiptar per permiresimin e sistemit te Drejtesise per te miturit, ratifikimin e Konventes Mbi te Drejtat e femijeve, krijimin dhe funksionimin e Komitetit Nder-ministror per te Drejtat e Femijeve, krijimin dhe funksionimin e Drejtorise per mbrojtjen e femijeve prane Zyres se Avokattit te Popullit etj.*

Gjithsesi, pamvareisht hapave pozitive te ndermarre ne kete drejtim dhe te njohura edhe nga partneret tane nderkombetare, nuk mund te lihen pa permendur problematikat e indentifikuara nga pala komunitare, shqetesimet e ngrituara si dhe nevojten e ndermarrjes se hapave konkrete per adresimin e tyre.

Ajo qe vazhdon te mbetet shqetesuese per Komisionin Evropian ne lidhje me respektimin e te drejtave te minoreneve fokusohet kryesisht me kushtet e qendrimit te tyre ne dhomat e paraburgimit se bashku me te rriturit, ne kundarshtim te plote me legjislacionin Shqiptar dhe me standartet nderkombetare, si dhe nevoja per forcimin e kapaciteteve administrative dhe njerezore te strukturave te perfshira ne mbrojtjen dhe respektimin e te drejtave te te miturve, ne problemin e femijeve te ngujuar nga gjakmarrja te cileve iu jane mohuar te drejtat qe iu takojne , perfshire ketu edhe te drejten per arsimim. Gjithashtu eshte e nevojshme rritja e kujdesit dhe perkrahjes

ndaj femijeve me nevoja te vecanta per te perfituar akses te barabarte ne te drejtat sociale dhe ekonomike.

Realizimi dhe plotesimi i rekomandimeve dhe standarteve te kerkuara shihet dhe konsiderohet nga qeveria Shqiptare si pjese e atij vullneti politik dhe shoqeror per te arritur standartet dhe vlerat me te larta humane, ne harmonizimin e politikave dhe te legjislacionit kombetar me ate europian, ne zhvillimin e forcimin e Shtetit te se Drejtes si dhe ne respektimin e plote te te drejtave te njeriut ne perputhje me standartet europiane dhe nderko-mbetare.

Nisur nga nevoja e perafimit te politikave dhe legjislacionit kombetar me legjislacionin komunitar, ne Prill te vitit 2005, me Vendim te Keshillit te Ministrave, u miratua Plani Kombetar per Perafrimin e Legjislacionit Shqiptar me ate te Bashkimit Evropian, i cili permban angazhimet e Institucioneve Shqiptare ne realizimin dhe perafimin gradual te legjislacionit Shqiptar. Ky plan eshte nje instrument qe percakton prioritetet sipas sektoreve dhe monitoron procesin e integritit europian.

Ne menyre te vecante Plani synon adresimin e rekomandimeve te Komisionit Evropian sipas te cilit *“gjate procesit te negociatave, Shqiperia duhet te ndermarre reformat e nevojshme per te garantuar qe, pas perfundimit te negociatave, ajo do te jete ne gjendje te zbatoje detyrimet qe rrjedhin nga Marreveshja e Stabilizim Asociimit”* si dhe identifikon kapacitetet administrative te Shqiperise per zbatimin e detyrimeve te MSA brenda afateve kohore te rena dakord gjate negociatave.

Ne kete aspekt, ndermjet te tjerash, nje rendesie te vecante i eshte kushtuar edhe realizimit te masave konkrete legjislative dhe zbatuese ne fushen e respektimit te te drejtave te femijeve duke e pare dhe konsideruar si nje pjese themelore te respektimit te te drejtave te njeriut ne pergjithesi.

Plani Kombetar parashikon ndermarrjen e masave afatshkurtra dhe afatmesme per permiresimin dhe perafimin e legjislacionit shqiptare me ate komunitar ne kete fushe, dhe me konkretisht nepermjet realizimit, brenda nje periudhe kohore 2005-2008, te ndryshimeve te legjislacionit te brendshem sidomos ne miratimin e paketes Ligjore „Mbi Drejtesine per te miturit”, ne te cilen jane parashikuar nderhyrje legjislative ne Kodin e Procedures Penale, Kodin Penal, ligjin “Per organizimin e pushtetit gjyqesor”, ligjin “Per ekzekutimin e vendimeve penale”, ligjin “Per te drejtat edhe trajtimin e te denuarve me burgim”, ligjin “Per organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise”, ligjin “Per organizimin dhe funksionimin e Policise Gjyqesore”.

Eshte parashikuar gjithashtu hartimi dhe miratimi i projekt ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit Shqiptar te Biresimit”, i cili parashikon dispozita te cilat do te percaktojne ne menyre te detajuar rolin, detyrat si dhe procedurat e ketij autoriteti per realizimin e biresimeve vendase dhe ndervendase, ngritja dhe funksionimi i Institutit te riedukimit per te miturit, ratifikimi i Konventes se Hages, (19 Tetor 1996), “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshem, njohjen, ekzekutimin dhe bashkepunimin ne lidhje me pergjegjesine prinderore dhe masat per mbrojtjen e femijve” dhe Konventes Europiane “Mbi aspektet civile te rrembimit nderkombetar te femijeve” nenshkruar ne Hage me 25 tetor 1980, ratifikimi i Konventes Europiane “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve ne lidhje me kujdestarine e femijeve dhe kthimin e te drejtes se kujdestarise se femijeve” (Luxemburg 20 Maj 1980), miratimi i ndryshimeve ne Kodin e Procedures Civile dhe Kodin e Procedures Penale per krijimin e gjykates per te miturit etj.

Te gjitha masat e parashikura synojne permiresimin e mbrojtjes se te drejtave te femijeve ne perputhje me standartet e Bashkimit Evropian dhe instrumentave te tjere nderkombetare ne kete fushe. Realizimi i ketyre masave, brenda afateve te percaktura, eshte nje detyre dhe pergjegjesi qe i takon se pari institucione dhe strukturave shteterore qe jane te ngarkuara me hartimin dhe zbatimin e ketyre masave.

Ministria e Integritimit, si nje institucion monitorues dhe koordinues per te gjitha reformat e ndermarra ne kuader te procesit te Integritimit Evropian, ka qene dhe do te jete e angazhuar per te ndjekur dhe per te influencuar fuqishem ne realizimin e angazhimeve

## **PJESEMARRJA E FEMIJEVE NE VENDIMARRJE**

### **Etleva SHESHI**

Specialiste prane Ministrise se Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve

Femijet dhe adoleshentet jane qytetare te dobishem dhe te afte per te kontribuar ne ndertimin e nje te ardhmeje me te mire per te gjithë.

Shteti e shoqeria duhet te respektoje te drejten e tyre per tu shprehur dhe per te marre pjese ne te gjitha çeshtjet qe lidhen me ta, ne perputhje me moshen dhe pjekurine e tyre.

#### **Neni 12 i Konventes Per Te drejtat e Femijes:**

1. Shtetet Pale i garantojne femijes, i cili eshte i afte te kete pikepamjet e tij, te drejten per te shprehur lirisht keto pikepamje, per çdo çeshtje qe ka te beje me te, duke i vleresuar ato ne perputhje me moshen dhe shkallen e pjekurise se tij.
2. Per kete qellim, femijes i jepet mundesia qe te degjohet ne çdo procedure gjyqesore ose administrative, qe ka te beje me te, qofte drejtperdrejt, qofte nepermjet nje perfaqesuesi ose te nje organi te pershtatshem, ne perputhje me rregullat e procedures se legjislacionit kombetar.

Sipas rekomandimeve te Komitetit te Konventes vleresohen perpjekjet e bera per te inkurajuar pjesemarrjen e femijeve brenda familjes dhe shkolles.

Sipas ketyre rekomandimeve u vleresua se ne perputhje me nenin 356 te Kodit te Procedures Civile, femijet mund te deshmojne para gjykates, pasi ata te kene mbushur moshen 16-vjeç dhe se mendimi I femijes kerkohet ne vendimet e kujdestarise, biresimet etj., pasi ata te kene mbushur moshen 10-vjeç, apo ne moshen 14-vjeçare ne lidhje me çeshtjet e shtetesise.

Megjithate Komiteti terhoqi vemendjen per faktin se vendimet e femijes nuk merren fare parasysh para moshes 10- vjeç.

Duke u bazuar ne keto rekomandime Qeveria Shqiptare dhe institucionet qe kane ne fokusin e tyre femijet, duhet te vazhdojne me nxitjen dhe lehtesimin e respektit per vendimet e femijeve dhe pjesemarrjes se tyre ne te gjitha çeshtjet qe kane lidhje me ta brenda familjes, shkolles dhe institucioneve te tjera, ashtu edhe ne procedurat juridike dhe administrative, ne perputhje me nenin 12 te Konventes.

Shteti dhe OJF-te e femijeve duhet te vazhdojne te punojne per te mundesuar informacion edukues per prinderit, mesuesit dhe drejtoret, zyrtaret e administrates shteterore, juristet, vete femijet dhe mbare shoqerine me qellimin e krijimit te nje atmosfere inkurajuese ne te cilen femijet, duke perfshire ata nen moshen 10-vjeçare, te mund te shprehin lirshem vendimet e tyre dhe ketyre mendimeve t'u jete dhene rendesia e duhur.

#### **a. Liria e shprehjes se femijeve**

Nje bote e pershtatshme e denje per femijet eshte ajo ku femijet e nisin jeten ne menyren me te mire te mundshme, kane mundesi te ndjekin arsimin tetevjeçar duke perfshire arsimin fillor te detyrueshem dhe I mundshem per te gjithë, dhe ku te gjithë femijet kane mundesi te shumta per zhvillimin e aftesive te tyre individuale ne nje ambient te shendetshem dhe inkurajues.

Femijet duhet të jenë të aftë të ushtrojnë të drejtën e tyre për shprehjen e mendimit të lirë sipas mundësisë dhe përkurisë së tyre, të krijojnë vetëbesimin, të fitojnë njohuri dhe aftësi p.sh. Në zgjidhjen e konflikteve, vendimmarrje dhe komunikim në mënyrë që të bëhen të aftë në përballimin e sfidave të jetës.

E drejta e fëmijëve për të shprehur lirisht duhet respektuar dhe nxitur, dhe pikepamjet e tyre për të gjitha çështjet që lidhen me ta, duke i konsideruar gjithmone këto se janë në përputhje me moshën dhe përkurinë e fëmijëve.

Energjia dhe krijimtaria e fëmijëve duhet ushqyer në mënyrë që ata të marrin pjesë aktivisht në krijimin e mjedisit dhe shoqërisë së tyre si dhe botes që do të trashëgojnë.

Femijet në pozita të disfavorshme si dhe ata të lënë menjëherë e sidomos adoleshentët, kanë nevojë për vëmendje dhe mbështetje të veçante që të mund të përfitojnë nga shërbimet me kryesore, të krijojnë vetëbesimin dhe të jenë të aftë për të përballuar jetën e tyre.

Për këto duhen hartuar dhe zbatuar programe për një pjesë-marrje sa më domethënëse të fëmijëve në procesin e vendimmarrjes si në familje dhe në shkollë ashtu edhe në nivel lokal dhe kombëtar.

#### **b. Përfshirja e fëmijëve në vendimarrje**

Synon të sigurojë pjesëmarrjen efektive dhe të përgjegjshme të fëmijëve në vendimarrje në përputhje me aftësitë e tyre, në të gjitha nivelet e arsimit në shkollë, në nivel lokal dhe qendror.

Plotesimi i aktëve normative të funksionimit të shkollës me nënë të veçanta që i njohin të drejtën e fëmijëve të jenë pjesëmarrës në vendimarrjet që lidhen me procesin mesimor, veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës si dhe të përcaktohen instrumentat dhe modalitetet që do të bëjnë efektive këto pjesëmarrje në:

- informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik
- të marrin përgjegjësi kundrejt vetvetes, shkollës, familjes dhe komunitetit
- të praktikojnë forma të delegimit dhe përfaqësimit
- të marrin pjesë në bordet drejtuese të shkollës

#### **c. Qeveritë e nxënësve**

-Duhet të mbështetet zhvillimi i programeve dhe projekteve në nivel shkollë, rajoni dhe me gjere që do të përgatisin femijet për t'u integruar në jetën e shoqërisë demokratike, t'i aftësojë të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit, t'i iniciojnë në jetën politike dhe ekonomike të vendit nëpërmjet konsolidimit të praktikave të funksionimit të Qeverisë së Nxënësve dhe Parlamentit Rinor.

- Qeveritë e nxënësve duhet të funksionojnë pranë shkollave, që do të thotë se shkollat duhet t'u krijojnë një mjedis të vacante atyre.

- Bashkitë dhe komunat duhet të krijojnë një zyrë të vacante për qeverinë qendrore në nivel rrethi.

#### **d. Parlamenti rinor**

Organizata mjaft e njohur për punën dhe propagandën e kryer nga ana e saj në të gjithë botën në lidhje me problematiken e fëmijëve dhe të rinjve.,

është duke mbështetur zhvillimet rinore në Shqipëri, përmes disa projekteve, të cilat tentojnë të rrisin pjesëmarrjen rinore në debatet publike.

Parlamenti rinor është njeri prej tyre, i cili ka filluar si një projekt pilot në vitin 2000 në prefekturën e Shkodrës dhe Gjirokastrës, tashmë është përhapur në të gjitha prefekturat e Shqipërisë. Të rinjtë mes periudhës 14-18 vjeç zgjidhen çdo dy vjet, ata zakonisht vijnë prej kontekstit të shkollave të mesme por gjithashtu edhe nga grupe minoritare dhe të rinj të papunë. Fushata elektorale dhe procesi i zgjedhjeve organizohen nga vetë të rinjtë. I gjithë procesi është disenjuar për të edukuar të rinjtë me praktikën demokratike, dhe të theksojë rëndësinë e pjesëmarrjes legjitime.

Parlamentet rinore në shkallë prefekturale ndërveprojnë me autoritetet lokale ku i adresohen dhe çështje që i takojnë edhe prefekturës. Çështjet kryesore që i adresohen parlamenteve rinore në disa prefektura kanë specifika në funksion rajoni.

Një herë në vit organizohet edhe aktiviteti i quajtur “*Ditet e parlamentit rinor*” për të shkëmbyer eksperiencat, dhe dialogun me vendimarrësit, ashtu si dhe të prezantojnë përfaqësuesit e tyre në shoqëri civile. Aktivitetet finalizohen në sesionin e organizuar në godinën e parlamentit, ku të rinjtë zyrtarisht në parlamentin kombëtar, në qeveri, sipas rekomandimeve dhe rezolutave të theksuar për veprim.

Përveç disa iniciativave lokale mbi edukimin, përdorimin e pijeve alkoolikeve, dhurimit të gjakut, trafikimit njerezor, lehtësirave rikrijuese, cilesisë së teksteve të librave, burimeve në lidhje me edukimin, dhe parlamenti rinor ka shprehur një pjesëmarrje të dukshme në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë, në kontributin e konsultimeve kombëtare mbi HIV/AIDS, fushatën kundër korrupsionit si dhe aksesin në edukimin e lartë.

#### **e. Qytetet miqësore për fëmijet**

Qeveritë lokale dhe autoritetet e tyre, nëpërmjet përfundimit të partneritetit në të gjitha nivelet, mund të duhet të garantojnë që fëmijet të jenë të parët në programet e tyre të zhvillimit. Nëpërmjet iniciativave të vazhdueshme si p.sh. komunitete miqësore dhe qytete pa lagje të varfëra, kryetaret e bashkive dhe komunave mund të përmirësojnë dukshëm jetën e fëmijëve.

Nga ana e pushtetareve lokale duhet të mbështeten OJF-të dhe organizatat me baze në komunitet dhe kur është e nevojshme duhen krijuar mekanizma për të lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështje që lidhen me fëmijet.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë një rol të veçantë në promovimin dhe mbështetjen e praktikave pozitive dhe për krijimin e një mjedisi të dobishëm për mirëqenien e fëmijëve.

Spektori privat dhe biznesi kanë një rol të veçantë. Ky rol ka të bëjë me adoptimin dhe devotshmerinë ndaj praktikave që demonstrojnë përgjegjësinë sociale në sigurimin e burimeve, që përfshijnë burimet e reja të financimit dhe skema për përmirësimin e komunitetit në mënyrë të tillë që të përfitojnë fëmijet.

## FEMIJET E ABUZUAR

### Altin HAZIZAJ

Perfaqesues i CRCA - Qendra Shqiptare per te Drejtat e Femijeve

Abuzimi i femijeve ne Shqiperi nuk eshte nje fenomen qe po perjetohet vetem vitet e fundit. Per vite me radhe askush nuk ka guxuar te ngrere shqetesimin per çeshtjen e femijeve te abuzuar dhe pasojat e abuzimit tek femija.

Studimi me i fundit kualitativ i CRCA '**Dhuna ndaj femijeve ne Familje**', rezultat i nje pune te gjate kerkimore dhe praktike per te identifikuar problemin, njohur shkaqet, per t'u perballur me realitetin, eshte nje perpjekje per t'ju ardhur ne ndihme viktimave te abuzimit, prinderve abuzues dhe te gjithë atyre institucioneve, organizatave dhe individeve qe jane te interesuar te parandalojne ose kurojne fenomenin e dhimbshem te abuzimit te femijeve.

Dhuna ndaj femijeve shfaqet ne forma te ndryshme si dhune fizike, emocionale, neglizhim dhe dhune seksuale. Fenomeni i dhunes kercenon te gjithë femijet pavaresisht moshes, vendbanimit, gjinise dhe nivelit social ekonomik te familjes.

Nje nga faktoret me te rendesishem jane qendrimet mbi abuzimin duke u ndalur tek shkalla e pranueshmerise se fenomenit nga ana e shoqerise, qendrimet e prinderve ndaj dhunes, shkalla e pranueshmerise se dhunes nga vete femijet dhe qendrimi i specialisteve per kete problem. Ende ne shoqerine shqiptare predominon mendimi se "druri ka dale nga xehneti", dhe kjo e ben te veshtire luften ndaj fenomenit.

Dhuna krijon pasoja fizike dhe emocionale, ndonjehere edhe te pariparueshme, tek femijet. Keto pasoja do te ndjekin femijen ne çdo hap te jetes se tij, edhe si i rritur, nese ato nuk trajtohen dhe nuk iu jepet ndihma e duhur. Ato mbartin rrezikun e krijimit te prinderve te dhunshem ne te ardhmen.

Dhuna shkakton demtime emocionale, mendore, te personalitetit, duke bere qe femijet e dhunuar te fitojne karakteristika te tjera nga ato te bashkemoshatareve te tyre. Keshtu, ata nuk kerkojne ndihme, nuk dine te ankohen, mbyllen ne vetvete, rriten para kohe, nuk kane besim tek njerezit qe i rrethojne, kane çrregullime te te ngrinit, kane probleme me urinimin dhe pergjithesisht kane çrregullime te te mesuarit dhe jo ralle karakterizohen nga nje fjalor i varfer dhe vulgar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal, Kodi Civil dhe Kodi i ri i Familjes ju garantojnë femijeve mbrojtje të drejtave themelore, por mbetet ende për të bere në funksion të perfeksionimit të kuadrit ligjor, si dhe të zbatimit të tij nga institucionet perkujdesese.

**Si konkluzion**, mund të themi se abuzimi i femijeve nuk njihet kufinj, por femijet që referohen për ndihmë janë kryesisht nga shtresat e varfëra dhe me të rrezikuara të shoqërisë. Gjate viteve të fundit janë shënuar rritje të rasteve të dhunes ekstreme ndaj femijeve në familje. Abuzimi ndaj femijeve behet nga persona brenda familjes ose të afert me të, ndonese nuk mungojne rastet e abuzimit nga të panjohurit. Rrenjet e ketij fenomeni qendrojnë në mentalitetin patriarkal që karakterizon familjen dhe gjithë shoqërinë shqiptare.



Ndonese ka nje nivel ndergjegjesimi te popullsise per abuzimin e femijeve, ende mbetet shume per te bere ne menyre qe te kapercehen stereotipe dhe modele te dhunshme te prinderimit. Per te arritur kete objektiv kerkohet nje bashkepunim me i mire i shoqerose civile, strukturave te shtetit, prinderve dhe specialisteve te fushes.

Ne kete kuader rekomandohet:

- \* Bashkepunim me Qeverine ne perpjekje per te persosur legjislacionin ne mbrojtje te femijeve, por edhe per te respektuar legjislacionin ekzistues. Ky bashkepunim duhet te shtrihet edhe ne fushen e hartimit te politikave mbeshtetese per familjet, femijet pa mbeshtetje etj;
- \* Fushata te vazhdueshme sensibilizimi ne bashkepunim me te gjitha aktoret e interesuar ne kete fushe per te siguruar rritjen e ndjeshmerise se publikut kunder çdo lloj dhune, por ne menyre te veçante dhunes ndaj femijeve;
- \* Trajnime per grupe te ndryshme specialistesh si mesues, mjeke, police, juriste, avokate, gazetare dhe prinder;
- \* institucioneve qe ofrojne sherbime ne ndihme te femijeve te abuzuar.
- \* Hapja e nje linje telefoni falas ne nivel kombetar te ndihmes per femijet.

# **SISTEMI I MBROJTJES SE FEMIJEVE - DOMOSDOSHMERI DHE STANDARD PER NJE SHTET DEMOKRATIK**

## **Holta KOTHERJA**

Klinika Ligjore per te Miturit

Do ta filloj kete fjale te shkurter me nje shembull te jetuar. Dikush nga nje institucion nderkombetar me telefonon nje dite para dy vjetesh dhe i shqetesuar me tregon se pasi kishte ecur pergjate ures kryesore ee bulevardit te Tiranës ishte perballur per disa dite rrjesht me nje bebe e cila lihej ne gjendje gjumi ne trotuar ne menyre qe njerezit te jepnin lemoshe. Personi i huaj me pyeste se ke duhet te njoftonte dhe cila ishte procedura per te hequr beben nga trotuari i vuajtjes dhe meshires njekoheisht. Mbeta! Rrotullohesha mes fjaleve boshe se duhej lajmeruar policia por edhe sherbimi social i bashkise, pastaj duhej ndoshta nisur nje procedure kunder prinderve, e me pas te pritej nje komision I sherbimit social per te pranuar foshnjen ne nje nga shtepite e foshnjes .

Nuk kisha nje pergjigje te sakte. Ne Shqiperi mungonte sistemi i mbrojtjes se femijeve.

### **Ç'eshte sistemi i mbrojtjes se femijeve?**

Sistemi i mbrojtjes se femijeve ne thelb eshte nje sistem referimi ku segmentet e tij funksionojne ne nje lidhje organike me njera tjetren duke mos synuar pjesen por te teren.

Te gjithë ne e dime se ajo qe ekziston sot ne Shqiperi eshte nje seri segmente institucionesh te ndara. Pervec kesaj ato vet jane te mbarsura me shume mangesi ne funksionim, aksesim dhe prodhim rezultatesh. Ne shume pak nga keto institucione gjen struktura te pershtatshme dhe te fokusuara per femijet.

### **Po cilat jane keto institucione ?**

Me konkretisht ne hartën e institucioneve perberes te sistemit te mbrojtjes se femijeve do te ishin, policia e shtetit, prokuroria, gjykatat, drejtorite aresimore /shkollat kopshtet, cerdhet, sherbimi mjekesor ambulator dhe spitalor, sherbimi social shteteror dhe lokal, organizatat (sherbimet ne komunitet, familje, shkolle strehezat) dhe pse jo nje sektor I posacem I Avokatit te Popullit.

Nje nga problemet e disa prej ketyre institucionve eshte mospasja e nje strukture te specializuar per femijet.

Keshtu ne drejtorite dhe komisaritet e policise nuk ka nje strukture per te miturit, ne prokurorite e te gjitha niveleve nuk ekzistojne drejtori per te miturit si kur krimet kryehen nga te miturit ashtu edhe kur ato jane kunder te miturve. Nuk kemi ende gjykata per te miturit apo seksione per te miturit prane gjykatave. Mospasja e ketyre strukturave te specializuara nuk eshte thjeshte nje moment politik i rendesishem ne menyren se si shteti e sheh dhe ne

c'pozicion e ve femijen, i cili eshte subjekt i mbrojtjes se vecante. Kjo gje eshte me shume se thjesht politike, eshte operacionale.

Nepunesit shteterore qe do te perbenin keto struktura do te pajiseshin me njohurite e duhura te posacme dhe dalengadale do te krijonin eksperiencen memoratike per trajtimin brenda mandatit funksional te ceshtjeve e te miturve. Por jo vetem kaq ata do te kishin fokusin dhe perkushtimin ti dedikoheshin kesaj kategorie shtetasish te cilet kane prioritet per tu mbrojtur sepse nuk mbrohen dot vet. Sistemi per ta duhet te jete lehtesisht i aksesueshem edhe kur ata nuk flasin dot, nuk ecin dot, nuk shkruajne dot si nje drejte kushtetuese jo vetem per t'u garantuar ne letra.

Nese do te analizonim institucionet e kujdesit parashkollor dhe shkollor, cerdhet kopshtet, shkollat, do te veme re ne praktike nje lloj indiferentizmi te legjitimuar per cdo problem qe nuk ka lidhje me oret qe femijet kalojne ne to, me oren e mesimit. Nderkohe, qe jane keta edukatore personat qe rrine me prane ketyre femijeve, te cilet mund te behen shume mire receptoret dhe transmetuesit e problemeve qe ata identifikojne tek ta. Por deri me sot as nuk jane marre masa qe roli i ketyre edukatoreve te zgjerohet ne kendveshtrimin e mbrojtjes se femijeve dhe as qe ata te aftesohen per te permbushur kete rol.

Per sa i perket sherbimit mjekesor eshte i vetmi sherbim qe ka detyrimin per kallezimin e dhunes dhe te cenimit te integritetit fizik dhe emocional te personave qe trajtohen nga mjeket. Se sa kjo zbatohet eshte per tu kontrolluar.

Megjithate detyre e ketyre profesionisteve nuk duhe te jete mbrojtja vetem nepermjet kallezimit por referimi i femijes ne menyre sa me imediate tek sherbimet sociale. E njehta gje vlen per edukatoren, mesuesit, punonjesit e policise, prokuroret dhe gjyqetaret. Misioni i policise sot eshte te mbroje shtetasit duke goditur krimin, kurse ai i prokurorise eshte te kryeje hetimin e veprave kriminale. Gjate ushtrimit te kesaj veprimtarie shteterore keta profesioniste ndeshen me femije viktime, femije ne veshtiresi, ne nevojte per tu trajtuar dhe asistuar. Duke e pare veten te limituar ne rolin e siperpermendur asnje nga ata nuk merr ne mbrojtje dhe referon kete kategori femijesh tek sherbimet sociale, se pari sepse nuk e ka te percaktuar me ligj si detyre dhe se dyti se nuk ka ku ta referoje pasi mungon sistemi.

Aktualisht ne Shqiperi per shak te decentralizimit, sherbimet sociale ne terren duhet te mbulohen nga organet e qeverisjes vendore. Shumica e keyre sherbimeve sociale ne nivel lokal ose nuk ekzistojne, ose jane ne fazen embrionale te tyre, ose edhe kur jane, nuk prodhojne sherbime ne komunitet. Edhe ligji me te cilin jane krijuar nuk e ka percaktuar qarte rolin e tyre. I gjith ky konfuzion ligjor dhe mungese burimesh njerezore ka krijuar situaten ku jane OJF-te, ato qe ne masen me te madhe ofrojne sherbimet sociale per target grupe te caktuara, ne zona te caktuara. Ne keto kushte do te duhej qe te gjitha keto OJF-te te detyroheshin te koordinon ne sherbimet sociale lokale dhe keto te fundit te pakten te kthehen ne koordinuese mes organeve te policise, prokurorise, gjykates, edukatoreve, mesuesve, mjekteve te cilet per shkak te detyres se tyre vijne ne dijeni per femije qe duhet te trajtohen dhe mbrohen nga sherbimet sociale, te cilat nga ana e tyre do ti referonin ne OJF-te sipas nevojave, apo tek shtepite e femijes qe jane nen kompetencen e sherbimit social shteteror.

Eshte per tu theksuar se koordinimi edhe mes vete organeve shteterore eshte problematike per shkak te procedurave burakratike duke mos

parashikuar zgjidhjen e rasteve te emergjences. Ne kushtet e mungeses se sistemit edhe OJF-te veprojne direkt me policine, me shkollat, me pak me sherbimet shendetesore, prokurorine dhe gjykatat duke realizuar nderhyrje te pjeshme dhe me kufizime te shumta gjeografike.

Nuk do te lija pa permendur ne kete tentative per te menduar per sistemin e mbrotjes se femijeve, rolin e rendesishem qe duhe te kete ne menyre natyrale institucioni i i Avokatit te Popullit. Eshte ky institucion, i cili duhet te behet garanti i implementimit te drejte te drejtave te femijeve dhe aksesimit te tyre nepermjet sistemit qe duhet te ngrihet. Avokati i Popullit duhet te kete mundesite, te drejttat dhe kapacitet e duhura per vepruar ne fushen e te drejtave te femijeve ashtu sic vepron ne fushat e tjera. Pasja e nje sektori te posacem apo pse jo e nje Ombudsmani per femijet do te krijonte premisa per me shume pergjegjshmeri tek organet shteterore dhe nje interlokutor kushtetues per femijet, mbrojtetit e tyre dhe OJF-te.

Keshtu pasi kemi folur sot ne kete konference per shume probleme te cilat karakterizojne ne nje aktualitet te zgjatur dhe konstant situaten e femijeve ne Shqiperi, kemi adresuar dhe riadresuar nevojen per nderhyrje me te medha dhe me cilesore nga ana e shtetit, pasi kemi ekspozuar ne kete vitrine problemet duke u rrekur te tregojme se cili eshte me i rendesishme, se cili eshte me urgjenti, se cili nuk kushton vetem para por do dhe angazhim, se cili l takon vetem nje pjese femijesh dhe se cili u takon te gjithëve, mendoj se ngritja e sistemit per mbrojtjen e femijes duke perfshire te gjitha institucionet e siperpermneduar do te ishte nje premise per te permiresuar situaten e femijeve, duke treguar si shtet marrjen persiper te pergjegjesise per jeten dhe kualitetin e jetes se femijeve, duke luftuar ne menyre institucionale dhe konkrete cdo forme dhune, keqtrajtimi dhe abuzimi ndaj tyre.

Bebe si ajo e trotuarit te ures vazhdojne te ekzistojne edhe sot. Ne te gjithë u kalojme perpara dhe jemi pa pergjigje. Ato vazhdojne te pyesin ne heshtjen e tyre : Kush do te na shpetoje?

## REKOMANDIMET E KONFERENCES

Sipas nenit 30 te Ligjit nr.8454, date 04.02.1999, "Per Avokatin e Popullit", Institucioni yne ne bashkepunim me organizatat joqeveritare duhet te organizoje, te pakten nje here ne vit, veprimtari kombetare per gjendjen e te drejtave dhe lirive te njeriut ne Republiken e Shqiperise. Ne zbatim te ketij detyrimi, me daten 15 Dhjetor 2005, u zhvillua Konferenca Kombetare "Te gjithë se bashku ne mbrojtje te te drejtave te femijeve".

Mbledhja e Komitetit te te Drejtave te Femijes prane Kombeve te Bashkuara, mbajtur ne Gjeneve ne Janar 2005 mori ne shqyrtim Raportin fillestar te paraqitur nga Shteti Shqiptar per zbatimin e Konventes te te Drejtave te Femijes dhe i dergoi Qeverise Shqiptare vezhgimet perfundimtare dhe rekomandimet perkatese. Vezhgimi dhe Rekomandimi 13 i referohen Zyres se Avokatit te Popullit dhe Seksionit per te Drejtat e Femijeve: *"Komiteti e mirepriti informacionin lidhur me krijimin e Institucionit te Avokatit te Popullit ne vitin 2000 dhe se fundi krijimin e Seksionit per te Drejtat e Femijeve, brenda institucionit te Avokatit te Popullit. Komiteti veren se ekzistojne disa plane per zgjerimin dhe njohjen e Seksionit te ri. Megjithate, Komiteti shqetesohet pasi niveli i ndergjegjesimit te femijeve ne sherbimet e Zyres se Avokatit te Popullit mund te jete i ulet.*

*Komiteti rekomandon qe Shteti Pale te mundesoje pajisjen e Seksionit te ri te Avokatit te Popullit me burimet e pershtatshme financiare dhe njerezore, per te siguruar funksionimin e tij te plote, duke perfshire ndergjegjesim me ane te fushatave dhe te lejoje marrjen e ankesave nga femijet dhe raportimin per zbatimin e te drejtave te femijeve".*

Duke pasur parasysh sa me siper, ne kuadrin e masave me karakter ndergjegjesues qe rekomandoi Komiteti, Avokati i Popullit ia kushtoi Konferencen vjetore situates se te drejtave te femijeve ne Shqiperi dhe rolit te Nenseksionit te mbrojtjes se te drejtave te femijeve ne kuadrin e masave me karakter institucional ne mbrojtje te ketyre te drejtave. Per pergatitjen e Konferences u punua gjate gjithë vitit 2005, duke shqyrtuar te gjitha ankesat qe lidhen me te drejtat e femijeve gjate viteve 2000-2005, problemet qe kane dale si ne drejtim te legjislacionit qe mbron te drejtat e femijeve, ashtu dhe te zbatimit konkret te tij nga ana e organeve te administrates publike shqiptare.

Ky aktivitet u organizua me inisiative te Institucionit te Avokatit te Popullit, ne bashkepunim me Organizatat UNICEF dhe Save the Children, Shqiperi. Konferenca trajtoi kryesisht politikat qeveritare ne drejtim te mbrojtjes se te drejtave te femijeve, problemet e punes se ndaluar te femijeve, te trafikimit te femijeve, te arsimit fillor te detyrueshem, roli i OJF-ve si dhe pervoja e Ombudmaneve te tjere ne mbrojtje te te drejtave te femijeve. Shqiperia ka marre persiper shume angazhime per mbrojtjen dhe respektimin e te drejtave te femijeve. Serioziteti i ketyre angazhimeve duket ne ratifikimin qe ne vitin 1992 te Konventes se OKB "Mbi te drejtat e femijes", e cila perben traktatin e pare universal qe rregullon te drejtat e njohura boterisht per femijet dhe i detyron shtetet per respektimin e tyre. Per te gjithë eshte me se e qarte se ratifikimi i Konventave nderkombetare nuk eshte nje qellim ne vetvete, por eshte shprehje zyrtare e angazhimit te shtetit dhe shoqerise per te garantuar zbatimin e te drejtave te parashikuara ne to.

1. Konferenca konstatoi se femijet i ndjejne me shume, si per mire, ashtu dhe per keq, pasojat e veprimeve ose mosveprimeve te qeverisjes. Pothuajse çdo ligj apo çdo vendim i qeverise, ne çdo fushe, ndikon tek femijet ne menyre direkte apo indirekte. Me siguri mund te themi se gjendja e femijeve, e edukimit dhe shendetit te tyre eshte nje barometer mates i sakte i ndryshimeve social ekonomike ne çdo shtet.

Si elemente mjaft pozitive u konsideruan edhe miratimi i Strategjive Kombetare si:

- Strategjia Kombetare per Luften kunder Trafikimit te Femijeve dhe per Mbrojtjen e Femijeve, Viktima te Trafikimit, miratuar me VKM nr.171 date 11.02.2005.

- Strategjia Kombetare per Personat me Aftesi te Kufizuara, miratuar me VKM nr.8 date 7.01.2005.

- Strategjia Kombetare per permiresimin e kushteve te jeteses se Minoritetit Rom, miratuar me VKM nr.633 date 18.09.2003.

- Strategjia Kombetare per Femijet 2005-2010, miratuar me VKM nr.368 date 31.5.2005 si dhe Plani i Veprimit te Strategjise Kombetare per Femijet 2005-201, miratuar me VKM nr.487 date 8.06.2005.

2. Ne perputhje me Planin Kombetar per Perafrimin e Legjislacionit Shqiptar me ate te Bashkimit Evropian, brenda nje periudhe kohore 2005-2008, do te behen ndryshime ne legjislacionin e brendshem per miratimin e paketes Ligjore "Mbi Drejtesine per te miturit". Realizimi i ketij procesi, konsiderohet nje hap i rendesishem drejt anetaresimit te Shqiperise ne Bashkimin Evropian. Ketij procesi i sherbejne dhe dy projektet lidhur me mbrojtjen e te drejtave te femijeve dhe perkatesisht nga Ministria e Drejtese dhe Avokati i Popullit ne bashkepunim me UNICEF-in , Save the Children, etj.

3. Qeveria ka bere perpjekje te vazhdueshme per parandalimin e trafikimit te qenieve njerezore ne pergjithesi dhe te femijeve ne veçanti. Por eshte varferia e familjeve te femijeve qe trafikohen, diskriminimi qe vuajne shumica prej ketyre familjeve ne jeten sociale, por edhe ne arsim dhe ne tregun e punes, si dhe mungesa e nje sistemi te plote funksional per mbrojtjen e femijeve qe e bejne te lehte abuzimin me keta femije. Femijet, kontigjent per trafikim jane kryesisht nga familje me probleme ekonomike e sociale. Menyra me efikase per te parandaluar trafikimin e femijeve si brenda vendit, ashtu dhe jashte tij eshte dhenia e mundesive reale per jetese dhe zhvillim ketyre familjeve.

4. Legjislacioni i punes ndalon shfrytezimin e punes se femijeve, por ende perdoren menyra te ndryshme per shfrytezimin e punes dhe diskriminimin ne trajtimin e tyre. Impakti i programeve, politikat dhe kontrolli per menjanimin e punesimit te femijeve jane ende te pamjaftueshme. Puna e femijeve mbetet veprimtari e fshehte nga subjektet private. Bashkepunimi me shkollen, familjen e komunitetin per rritjen e ndergjegjesimit te publikut per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve eshte i pamjaftueshem.

5. Permiresimi i kushteve te jeteses dhe mireqenies se nenave dhe femijeve nuk çon vetem ne nje shoqeri me te shendetshme, por edhe ne pakesimin e pabarazive dhe varferise. Semundjet e shpeshta dhe kequshqyerja ndikojne negativisht ne zhvillimin psikologjik, permasat trupore dhe forcen e femijeve. Ekzistojne mjaft probleme ne informimin, edukimin dhe komunikimin shendetesor, sidomos per femijet me zhvillim te vonuar mendor.

6. Reformimi i sistemit shkollor parauniversitar synon riorganizimin dhe modernizimin e sistemit të shkollimit në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, krijimin e hapësirave demokratike të respektimit të të drejtave të femijëve dhe hapjen e rrugës për integrimin e arsimit të nënës në Europë. Në këtë fokus, futja e mesimit të të drejtave të femijës në programet shkollorë synon të sigurojë njohjen dhe përvetësimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të femijëve, duke i përfshirë këto në të gjitha veprimtaritë e shkollës.

7. Sistemi aktual i drejtësisë penale për të mitur është me shumë i orientuar drejt ndeshkimit të personit të mitur sesa rehabilitimit të tij. Në praktiken e gjykatave shqiptare, zbatimi i masave shtetërore dhe të denimit me burgim nuk shihen gjithnjë si mjeti i fundit. Për shkak të mungesës së akteve nenligjore dhe strukturave perkatese, prokurorët dhe gjyqtarët vihen shpesh në pozite të veshire lidhur me trajtimin e të miturit. Për tyre shtrohen vetëm dy alternativa: ose të lenë të miturin të lirë dhe pa kontroll ose të marrin masën e arrestit ndaj tij. Ndihma ligjore jo vetëm ofrohet nga avokate të rinj dhe me përvojë të paket profesionale, por në të shumtën e rasteve ata nuk janë të specializuar në çështjet e drejtësisë për të mitur.

Përsa i përket ndihmës psikologjike, me përjashtim të gjykatës së krimeve të rënda dhe gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, ku ky shërbim ofrohet, në gjykatat e tjera, gjyqtarët hasin në vështirësi për të garantuar këtë shërbim ndaj të miturve. Deri më sot është shkelur rëndë kërkesa e ligjit për gjykimin e të miturve nga gjyqtarët e seksioneve të të miturve, pasi *seksionet e të miturve* nuk janë ngritur ende.

8. Ajo që vazhdon të mbetet shqetësuese në lidhje me respektimin e të drejtave të minoreneve fokusohet kryesisht me kushtet e qëndrimit të tyre në dhomat e paraburgimit në mjaft raste së bashku me të rriturit, në kundërshtim të plotë me legjislativën Shqiptare dhe me standartet ndërkombëtare. Ka nevojë për forcimin e kapaciteteve administrative dhe njerezore të strukturave të përfshira në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të miturve.

9. Monitorimi i respektimit të të drejtave të miturve në kontakt me sistemin e drejtësisë penale është një element mjaft i rëndësishëm. Krahas rolit të prokurorisë dhe të gjykatës, rëndësi kanë organet monitoruese të jashtme, ndër të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizatat jofitimprurëse monitoruese të të drejtave të njeriut. Të drejtat e femijëve janë parë me prioritet nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit që në fillimet e punës së tij, ka qenë tepër i ndjeshëm lidhur me respektimin e të drejtave të femijëve. Ankesat e trajtuara kanë qenë të ndryshme dhe të larmishme. Nderhyrja e Avokatit të Popullit ka qenë në dy drejtime:

Se pari, në drejtim të konstatimit të shkeljeve dhe të problemeve lidhur me legjislativën konkrete;

Se dyti, të nderhyrjes në organet shtetërore që kanë kompetencë zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e masave parandaluese për mospërsëritjen e shkeljeve në të ardhmen.

10. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja kanë bërë një punë të mirë në drejtim të ndihmës për femijet, duke realizuar vetë ose në bashkëpunim me institucionet shtetërore shqiptare projekte të veçanta. Por duhet punuar më tepër për të organizuar koordinimin për bashkërendimin e projekteve që ndermerren, me qëllim që të jenë më efektive dhe të mos ketë përplasje midis tyre.

Mbi bazen e perfundimeve dhe konstatimeve te mesiperme Konferenca doli me rekomandime, disa nga te cilat jane perfshire edhe ne Strategjite perkatese te miratuara:

**1. Per femijet jetime qe mbahen ne institucione** duhet bere:

- Modelimi i sherbimeve alternative te shtepive familje, te cilat po eksperimentohen.
- Nxitja e biresimeve te hershme te femijeve qe jane braktisur dhe veçanerisht femijeve me probleme shendetesore.
- Investime ne infrastrukturen e institucioneve rezidenciale, rritja e kapaciteteve te stafave per te rritur cilesine e sherbimeve.
- Implementimi i standardeve te pergjithshme dhe te femijeve per sherbimin ne institucione rezidenciale.

**2. Per femijet jetime pa prinder ose me nje prind qe nuk jetojne ne institucione** duhet bere:

- Ngritja e strukturave te nevojshme dhe krijimi i nje sistemi te identifikimit te nevojave te femijeve jetime, atyre me nje prind dhe me probleme sociale ne nivel vendor.
- Zbatim programesh per mbeshtetjen e familjeve me shume femije, me aftesi te kufizuar ose probleme sociale per punesim, trajnim profesional apo ndihme ekonomike.
- Te zbatohen masat shtrenguese ndaj prinderve qe braktisin femijet, i detyrojne te punojne, apo nuk i dergojne ata ne shkolle, etj.

**3. Per femijet e braktisur te rruges** duhet bere:

- Rritja e llojshmerise se sherbimeve, si: shtepite familje prane institucioneve rezidenciale publike dhe jopublike, qendrat ditore, komunitare etj. -Zgjerimi i sherbimit te kujdestarise.
- Sigurimi i biresimit te hershem.
- Mbeshtetje per familjen, qe femijet te ndjekin shkollen.
- Marrje masash mbrojtjeje nga strukturat ligjore ne rastet e neglizhences, abuzimit apo dhunes.
- Masa shtrenguese ndaj prinderve qe braktisin femijet, apo nuk i dergojne ata ne shkolle, i detyrojne te punojne etj.

**4. Per femijet e trafikuar** eshte e rendesishme:

- Implementimi i Planit Kombetar te Veprimit per Luften Kunder Trafikimit te femijeve. Hartim e zbatim politikash qe adre-sohen drejt parandalimit, mbrojtjes, kthimit vullnetar te asistuar, riatdhesimit dhe riintegrimit te femijeve te trafikuar.
- Bashkepunim dhe koordinim ndermjet institucioneve dhe partnereve qe punojne ne fushen e trafikimit te femijeve.
- Rikthimi ne shkolle i femijeve te trafikuar dhe ne rrezik trafikimi, qe nuk kane perfunduar arsimin e detyrueshem dhe ofrimin e alternativave per formim profesional per te rinjte ne moshe pune.
- Nje deshire e vullnet me i madh i forcave te rendit per te zbuluar e vene para ligjit shfrytezuesit e ketyre femijeve, do te mbronte qindra femije te detyruar me force per te mos patur femijeri.



- Pergatitja e politikave te detajuara per kthimin, mbrojtjen, trajtimin dhe riintegrimin psikosocial te viktimave te trafikut, te shoqeruara keto politika me akte te zbatimit te tyre nga institucionet publike dhe OJF.

- Krijimi i nje fondi te veçante per mbrojtjen e femijeve viktima te trafikimit si dhe per OJF-te qe punojne ne kete fushe per te siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre ne shoqeri.

- Te forcohet lufta kunder korrupsionit dhe perfshirjes se strukturave policore ne trafikimin e femijeve.

- Te realizohet rritja e kapaciteteve profesionale te strukturave policore qe punojne ne sektoret e antitrafikut, sidomos per femijet.

- Te sigurohet bashkepunim transnacional midis qeverise sone dhe atyre te vendeve fqinje per luften kunder trafikimit te femijeve, si dhe mbrojtjen e femijeve viktima te trafikimit, nepermjet nenshkrimet te marreveshjeve dy ose shumepaleshe.

#### **5. Per femijet rome duhet bere:**

- Permiresimi i kushteve ekonomike, te shendetit, te arsimimit, kultures etj, per mirerritjen dhe zhvillimin e femijes.

- Regjistrimi dhe sensibilizimi i komunitetit, per te perfituar nga legjislacioni ne fuqi. Regjistrimi i femijeve si mase per mbrojtjen e tyre nga abuzimi dhe krijimi i mundesive per zhvillim.

#### **6. Per femijet qe punojne duhet bere:**

- Evidentimi, vleresimi dhe adresimi i drejte i ketij problemi, kunder praktikave te rrezikshme dhe shfrytzezese te punes dhe trafikimit te femijeve per terheqjen nga puna dhe trafikimi, dhe referimin e rasteve.

- Forcimin i kapaciteteve ne nivel qendror dhe lokal, i cili do te arrihet nepermjet nje bashkepunimi te ngushte me te gjitha institucionet dhe strukturat qe lidhen me punen e femijeve si Bashkia, Zyra e Punes, Arsimi, Policia, Shendetesia si dhe partneret sociale.

- Forcimi i kapaciteteve te Inspektoriatit te Punes dhe partnereve te tjere mbi Sistemin e Monitorimit te Punes se Femijeve.

- Finalizimi i "Raportit Kombetar dhe Planit Strategjik mbi politikat kombetare lidhur me çeshtjen e punes se femijeve ne Shqiperi", qe do te lehtesoje procesin e implementimit te ketyre politikave nepermjet perfshirjes se nje rangu te gjere aktoresh dhe institucionesh aktive ne adresimin e ketyre problemeve, si ne nivel qendror edhe ate lokal.

#### **7. Per femijet me Aftesi te Kufizuara duhet bere:**

- Perpunimi i nje plani kombetar per femijerine e hershme, per pune te integruar per kete grupmoshe me ministrive te linjes.

- Krijimi i nje strukture te veçante per femijet, brenda se ciles te kete nje njesi per femijerine e hershme.

- Rritja e financimeve per femijet me Aftesi te Kufizuara brenda buxheteve te ministrive te linjes.

- Permiresime te metejshme te sherbimeve ditore dhe komunitare per femijet me Aftesi te Kufizuara, te cilat aktualisht jane ende te pamjaftueshme;

- Hartim programesh per trajnimin e tyre profesional, integrimin ne jeten komunitare;

-Eliminimi i te gjitha pengesave ne mjedis per levizje dhe komunikimin e kesaj kategorie femijesh;

- Mundesimi i perjashtimit nga te gjitha taksat per OJF qe punojne per femijet me aftesi te kufizuara, do te nxiste financimin e mjaft projekteve edhe nga donatore te huaj ne Shqiperi.

**8. Reformimi i Sistemit te Sherbimeve Shoqerore** si nje proces mjaft i rendesishem, nepermjet:

- Decentralizimit, pra transferimit te qendrave te sherbimeve rezidenciale ne varesi te njesive te qeverisjes vendore, brenda 3 viteve te ardhshme.

- Ngritjes se sherbimeve te reja shoqerore ne komunitet. Prioritet duhet te kene femijet jetime, te braktisur dhe te rruges, te trafikuar, qe punojne, me aftesi te kufizuara, femijet rome, qe braktisin shkollen, te dhunuar, te pashoqeruar ne emigracion, te abuzuar etj.

- Deinstitutionalizimi, nepermjet transformimit te sherbimeve rezidenciale ne sherbime te levizshme me baze komunitare. Ky proces do synoje:

- Parandalimin e pranimeve dhe qendrimeve te panevojshme ne institucione rezidenciale.

- Sigurimin e alternativave te tjera per strehimin, trajtimin, edukimin dhe rehabilitimin e individeve qe nuk e kane te nevojshme qendrimin ne institucione rezidenciale.

- Permiresimin e kushteve, perkujdesjes dhe trajtimit per individet qe kane nevojte per perkujdesje ne qendra rezidenciale.

- Mundesimi i sherbimeve alternative: sherbime ditore, sigurimi i familjeve kujdestare dhe biresuese.

- Te reduktohet kerkesa per te vendosur femijet ne qendrat rezidenciale, nepermjet edukimit per planifikimin familjar, parandalimin e braktisjes se femijes, prezantimin e sherbimeve etj.

- Zbatimi i standardeve te sherbimit te perkujdesit shoqeror per femijet ne institucionet rezidenciale.

- Duhet te zbatohen politika sociale bashkekohore ne mbrojtje te interesave te femijeve jashte kujdesit prinderor nepermjet zhvillimit te formave alternative te perkujdesit te cilat u ofrojne femijeve perkujdesje afatgjate ne nje familje apo ambjent te ngjashem me te.

- Rritja e pjesemarrjes se pushtetit vendor ne hartimin dhe zbatimin e politikave sociale te mbrojtjes se te drejtave te femijeve.

- Krijimi i sistemit per mbrojtjen e femijeve te shtrire ne te gjithe instancat e pushtetit vendor.

Si konkluzion garantimi i cilesise se Sherbimeve Shoqerore duhet te arrihet nepermjet hartimit dhe zbatimit te standarteve, licensimit te operatoreve publike e private qe ofrojne sherbime dhe inspektimit per zbatimin e standardeve.

**9. Per shendetin e femijeve ne pergjithesi** duhet bere:

- Permiresimi i sherbimeve te shendetit te nenes dhe femijes ne keto drejtime:

i. Permiresimi dhe integrimi i strukturave te sherbimit shendetesor te gruas dhe femijes ne te gjitha nivelet e kujdesit.

ii. Permiresimi i cilesise se sherbimeve te nenes dhe femijes ne te gjitha nivelet e kujdesit, nepermjet unifikimit te protokolleve standart per ndjekjen e shendetit te gruas dhe femijes.

iii. Ngritjes se nivelit teknik te personelit shendetesor, nepermjet trajnimit te vazhdueshem te gjithe stafit shendetesor qe punon ne keto sherbime.

- Permiresimi i legjislacionit ne mbrojtje te shendetit te femijeve. Vijimesia e procesit te perpunimit te Kartes se te drejtave te femijeve ne spital me qellim qe tu garantohen femijeve te shtruar ne spital te drejtat e tyre per te jetuar, per tu zhvilluar, per te qene te mbrojtur dhe per te qene pjese e procesit pa dallim dhe nenvleresim.

- Zbatimi me rigorozitet i sistemit te vaksinimit dhe rivaksinimit.

- Promovimi dhe edukimi i nje menyre ushqyerje dhe jetese te shendetshme ne familje dhe komunitet.

**10. Per arsimimin e femijeve** drejtimet kryesore ku do te perqendrohet veprimi i te gjitha institucioneve arsimore, ne te ardhmen, per te siguruar nje nivel te larte te edukimit, pervesimit dhe zbatimit te te drejtave te femijeve jane:

- Sistem arsimor cilesor, duke i kushtuar kujdes te vecante edhe arsimit jopublik, me qellim qe kontrolli i shtetit me ane te Ministrise se Arsimit dhe Shkences mbi programet, cilesine e mesimdhenies dhe kushtet e jeteses dhe te shkolles te jete me efektiv dhe me i shpeshte.

- Te futet sa me shpejt njohja e te drejtave te femijes ne kurrikulin shkollor.

- Sigurimi i informacionit te detajuar per arsimin, duke nxitur komunitetin qe te jete me i interesuar.

- Perfshirja e femijeve ne vendimarrje ne perputhje me zhvillimin ekonomik te vendit, krijimin e hapësirave demokratike te respektimit te te drejtave te femijeve dhe hapjen e rruges per integrimin e arsimit tone ne Europe.

- Plotesimi i Dispozitave Normative te Shkolles qe do te sanksionojne realizimin e te drejtes se femijeve per tu bere pjese e vendimarrjes per problemet qe lidhen me procesin mesimor, veprimtarite brenda dhe jashte shkolles si dhe percaktimi i instrumenteve dhe modaliteteve qe do te bejne efektive kete pjesemarrje.

- Sigurimi i informacionit te detajuar per arsimin. Mbi kete baze te dhenash do te orientohen nderhyrjet politike ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijeve per tu siguruar nje sherbim arsimor cilesor, pavaresisht perkatesise etnike, fetare, gjendjes shoqerore, shendetesore etj.

**11. Per Drejtesine per te miturit,** duhet bere:

- Miratimi i paketes ligjore "*Mbi Drejtesine e te Miturve*", si dhe ngritja e strukturave perkatese per zbatimin e tij.

- Realizimi i ndarjes se te miturve te denuar dhe atyre te paraburgosur krejtesisht ne ambjente te vecanta. Pjese e reformes duhet te jete edhe sistemi i paraburgimit dhe vuajtjes se denimit per te miturit. Ne institucionet ekzistuese duhet te merren masa per permiresimin e infrastruktures se tyre me qellim qe keto vende te ofrojne kushte per edukimin dhe riintegrimin e te miturve. -Perfshirja e punonjesit social ne çdo institucion te vuajtjes se denimit. -Krijimi dhe venia ne funksionim i nje Instituti Riedukimi per te Miturit.

-Ngritja e seksioneve per gjykimin e te miturve ne gjykata te rretheve gjyqesore. -Specializimi i gjyqtareve qe do te gjykojne çeshtjet e te miturve ne seksionet e posaçme. -Permiresimi i ligjit "Mbi organizimin dhe veprimtarine e Komitetit Shqiptar te Biresimit" dhe ligjit "Per statusin e jetimit". -Ne kete proces reformimi te sistemit te drejtesise penale, mbrojtja e te miturve duhet te shihet ne te dy kendveshtrimet: mbrojtja e te miturve si autore dhe si viktima te krimit.

**12. Konferenca insistoi** se te gjitha organet shteterore dhe organizatat jofitimpruese duhet te merren me shume me problemin e femijeve te ngujuar nga gjakmarrja, te cileve ju jane mohuar te drejtat qe iu takojne, perfshire ketu edhe te drejten per arsimim.

**Se fundmi, u rekomandua dhe:**

13- Krijimi i sistemit bashkekohor te grumbullimit te te dhenave, duke u mbeshtetur mbi treguesit e matjes se mireqenies shoqerore te femijeve, ne veçanti te atyre qe iu perkasin grupeve shoqerisht te perjashtuara.

14- Nga ana e pushtetareve lokale duhet te mbeshteten OJF-te dhe organizatat me baze ne komunitet dhe kur eshte e nevojshme duhen krijuar mekanizma per te lehtesuar pjesemarrjen e shoqerise civile ne çeshtje qe lidhen me femijet.

15- Ndermarrja e fushatave te vazhdueshme te sensibilizimit ne bashkepunim me te gjitha aktoret e interesuar ne kete fushe per te siguruar rritjen e ndjeshmerise se publikut kunder çdo lloj dhune, por ne menyre te veçante dhunes ndaj femijeve;

- Ne perfundim Konferenca konkludoi se, *ngritja e sistemit te avancuar dhe bashkekohor per mbrojtjen e femijeve do te jete nje premise per te permiresuar gjendjen e tyre, duke treguar se shteti shqiptar duke luftuar ne menyre institucionale dhe konkrete çdo forme dhune, keqtrajtimi dhe abuzimi ndaj tyre, merr persiper pergjegjesine per jeten dhe cilesine e jetes se femijeve.*

\* \* \*

Zhvillimi i kesaj Konference, pjesemarrja e drejtuesve te disa ministrive kryesore, e perfaqesuesve te organizatave jofitimpruese qe punojne per te drejtat e femijeve, si dhe fjalimet, problemet dhe sugjerimet e tyre per çeshtjet e trajtuara ne Konference, jane nje tregues qe premtojne per ndryshime pozitive ne drejtim te respektimit te te drejtave te femijeve ne te ardhmen.

Sipas mendimit te pergjithshem, Konferenca ia arriti qellimit te caktuar per sensibilizimin dhe angazhimin me te madh te te gjitha organeve dhe autoriteteve te administrates publike shqiptare per zbatimin e Kushtetutes, akteve te njohura nderkombetare, ligjeve perkatese si dhe rekomandimeve te kesaj Konference.

Te shpresojme se rekomandimet e kesaj Konference do te vleresohen me seriozitet dhe do fillojne te implementohen nga gjithe organet kompetente.